

Seritë e studimit biblik orthodhoks

# Letra drejtuar Hebrejve

Kryepriifti i madh i qiejve

**Lawrence L. Farley**

Përktheu: Ana (Germana) Bërbati

## Pasqyra e lëndës:

- Parathënie.....	4
- Formati i librit.....	5
- Dy fjalë për përkthimin.....	6
HYRJE: Enigma e kësaj letre.....	7
I. FJALË HYRËSE (1:1-4).....	7
II. MË I LARTË SE ENGJËJT (1:5 - 2:18).....	16
1. Biri qëndron më lart se engjëjt (1:5-14).....	16
2. Fjala e Birit është më e lartë se urdhri që u dha me anë të engjëjve (2:2-4).....	23
3. Krishti i bërë përgjigje më i ulët nga engjëjt, për të pësuar si Kryeprift i Madh (2:5-18).....	24
III. KRISHTI, KRYEPRIFTI YNË (3:1 - 10:18).....	30
1. Krishti qëndron më lart se Moisiu (3:1-6).....	30
2. Vigjilencë që të mos largohemi nga prehja e Krishtit (3:7 - 4:13).....	32
3. Krishti, Kryeprifti ynë (4:13 - 5:10).....	39
4. Ngulmoni për të arritur në pjekuri shpirtërore (5:11 - 6:20).....	46
5. Kryepriftëria e Krishtit si ajo e Melkisedekut (7:1-28).....	58
6. Priftëria e Krishtit është më e lartë se ajo e Aaronit (8:1 - 10:18).....	66
IV. TË NGJITEMI FORT PAS KRISHTIT (10:19 - 12:29).....	88
1. Mos u tërhiqni nga Adhurimi i Krishterë (10:19-39).....	88
2. Qëndroni të patundur në besim, sikurse etërit (11:1 - 12:2).....	95
3. Pranoni vuajtjet si bij të Perëndisë (12:3-29).....	108
V. KONKLuzionet (13:1-25)	
1. Këshillat e fundit (13:1-19).....	116
2. Bekimet përmbyllëse (13:20-21).....	116
3. Përshëndetjet e fundit (13:22-25).....	121
- SHITESA: DISKUTIMET	
1. Mbi përdorimin e Septuagintës .....	21
2. Mbi interpretimin e Psalmi 2:7.....	45
3. Mbi Tempullin dhe Shenjtëroren si antitipa .....	68

4. Mbi zëvendësimin e Dhiatës së Vjetër .....	72
5. Mbi kuptimin e objekteve të Shenjtërores .....	75
6. Mbi flijimin e Krishtit dhe Eukaristinë Hyjnore .....	86
7. Mbi zemërimin e Perëndisë .....	92

## **Parathënie:**

Ky libër është shkruar në mënyrë që të jetë i kuptueshëm nga të gjithë lexuesit me njohuri të përgjithshme rreth besimit të krishterë orthodhoks, të cilët duan të analizojnë më thellë fragmentet e Shkrimit të Shenjtë, ose hasin paqartësi në kuptimin e tyre.

Për këtë arsye, nuk ngjason me komentet e tjera të librave të Dhiatës së Re që qarkullojnë, të cilat i adresohen lexuesve më të formuar teologjikisht dhe përpjekjeve dialoguese ndërmjet tyre (të cilat padyshim janë të rëndësishme, por jo të përfshira në këtë format). Ky libër synon të analizojë fragmentet e Letrës së Hebrenjve, pa u munduar të argumentojë e të mbrojë argumentet që parashtron, duke i marrë ato si të mirëqena, në përputhje me Traditat e Etërve.

Për sa i takon përkthimit, një shprehje e famshme italiane thotë: “Përkthyesi është tradhtar” (në italisht përbën një lojë fjalësh: “il traduttore è traduttore”). Kjo shprehje nënkupton se asnjë përkthim nuk mund t’i transmetojë të gjitha nuancat dhe kuptimet e origjinalit, pasi asnjë gjuhë nuk është e barasvlershme me një tjetër. Përkthyesit i mbeten dy rrugë: përkthimi i lirë, pra të bëjë një përshtatje të parafrazuar të origjinalit, ose të mundohet ta përcjellë tekstin fjalë për fjalë, por duke rezultuar në një tekst që tingëllon i thatë dhe pa ngjyrim në gjuhën mbërritëse.

Këto dy lloje të ndryshme të përkthimit përputhen me dy nevoja të domosdoshme të Kishës: nga njëra anë, përkthimin sa më saktë e të sofistikuar të Shkrimit të Shenjtë, për përdorim liturgjikal, të shkruar në një gjuhë të pastër e të saktë, në përputhje me solemnitetin e Liturgjisë, ndërsa nga ana tjetër, përkthimin e Shkrimeve për grupet e vogla të studimit biblik (ku mund të përdoret një gjuhë më e lehtë, me synim më tepër në saktësinë e fjalëve se sa elegancën). Gjithashtu, në përkthimin e përshtatur për grupet e studimit biblik, nevojitet që studentët të mësojnë se si janë përkthyer terma të veçanta nga origjinali grek, dhe duhet që një term i caktuar të jetë përkthyer njësoj në të gjithë Shkrimin. Pikërisht këtë synon dhe ky libër: përkthimin literal (fjalë për fjalë) të origjinalit grek. Për çdo fjalë në greqisht, jam munduar të gjej (ose edhe krijoj!) një fjalë korresponduese.

Ky libër nuk synon të dalë nga kornizat e përdorimit për studim biblik, dhe aq më pak për përdorim liturgjikal. Kjo e fundit do të kërkonte përpjekje për të arritur një përkthim elegant dhe me muzikalitet, ku të përcillej çdo ngjyrim i origjinalit, të cilën me kënaqësi ua kam lënë personave më kompetentë se unë në këtë fushë.

## Formati i librit:

- Fragmenti i shkëputur nga Shkrimi i Shenjtë paraqitet me shkronja të theksuara të zeza (**bold**). Fjalët e shkruara me shkronja të pjerrëta (*italics*) janë fjalë të cilat nuk hasen në tekstin origjinal në gjuhën greke, por janë shtuar në shqip, për shkak të përshtatjes sintaksore.

**8 Po për Birin thotë: "Froni yt, o Perëndi, është në jetë të jetës; shkop drejtësie është shkopi i mbretërisë sate.**

- Gjatë komentit, citimet e marra nga fragmenti përkatës që analizohet, janë shënuar me të zezë të theksuar (**bold**).

Përshkrimi i Birit dallon shumë nga ai që i bëhet engjëjve në Shkrimet. **Për engjëjt thotë: "Ai që i bën engjëjt frymëra, edhe shërbyesit e tij flakë zjarri"**. Ky varg është marrë nga Psalmi 104:4, gjë që tregon rëndësinë e madhe që autori u kushton referencave të Dhiatës së Vjetër.

- Referencat e citimeve të huazuara nga pjesë të ndryshme të Shkrimit, janë shënuar përbri tyre, në kllapa. Ato pjesë të cilat nuk janë të shoqëruara nga referencat, i korrespondojnë fragmentit që trajtohet në atë pjesë.

Krishti na u zbulua në përmbushjen e kohërave, në mbarim të jetëve (1 Kor. 10:11).

- Gjatë komentit, shkrimi i pjerrët (*italics*) është përdorur si zakonisht, për fjalët e huaja.

Fjala "engjell" (heb. *malak*; gr. *aggelos*) në të dyja gjuhët ka kuptimin "lajmëtar".

## Dy fjalë për përkthimin në shqip:

Në këtë studim biblik të ungjillit të Letrës së Hebrenjve, autori i është referuar Ungjillit sipas versionit të Biblës së King James-it, por i është dashur t'i rikthehet disa herë tekstit origjinal të Dhiatës së Re në greqisht, për të sqaruar terma dhe fraza, një pjesë e kuptimit të të cilave ka humbur gjatë përkthimit (terma të tilla në greqisht, apo hebraisht janë shkruar në kllapa me shkrim të pjerrët). Stili i autorit është i thjeshtë, me synimin për të qenë i kuptueshëm për të gjithë lexuesit.

Përkthimi i është referuar tekstit të Dhiatës së Re të Kishës Orthodhokse, të postuar në web-in e Kishës. Për referencat nga Dhiata e Vjetër, është përdorur Bibla e botuar nga Shoqëria Biblike e Shqipërisë (të vitit 2016), në disa raste edhe versioni i Shtëpisë Botuese Drita (Ferizaj 1994), për ato libra të Dhiatës së Vjetër, të cilat nuk janë të përfshira në botimin e Shoqërisë Biblike.

Për t'iu referuar kohës historike dhe mësimëve të autorit, të cilat ua drejton të krishterëve me origjinë hebraike, për të cilët u shkrua letra, është përdorur koha e shkuar (kryesisht e pakryera dhe të kryera e thjeshtë). Ndërsa për mësimet dhe këshillimet e tij, të cilat i referohen një konteksti të caktuar në të shkuarën por gjejnë zbatim në çdo kohë, është përdorur koha e tashme, p.sh.: "Adhurimi i vërtetë gjen shprehje në përditshmërinë e gjithsecilit, nëse kjo zbukurohet me vepra të mira dhe zemërbutësi."

Frazat me ngjyrë të zezë të theksuar i korrespondojnë vargjeve biblike të fragmentit që trajtohet (që mund të ndryshojnë në përshtatjen në kohë, vetë dhe numër, por kurrsesi në formulim), sipas modelit të autorit, të përdorur në librin origjinal.

Ka qenë një dëshirë e hershme e imja dhe gjithashtu nevojë e domosdoshme e Kishës Orthodhokse në Shqipëri, për të pasur një libër studimi biblik ku të shpjegohej çdo fragment në mënyrë analitike. Përkthimi i këtij libri u realizua me nismën e nxitjen e atë Grigor Pelushit, përgjegjësit të Radios Ngjallja. Gjej rastin ta falënderoj për zemërsisht atë dhe të tjerë për nxitjen por edhe për mbështetjen në realizimin e këtij botimi. Është e qartë dhe e padiskutueshme se asnjë përkthim nuk mund të jetë ekuivalenti absolut i origjinalit, por megjithatë, në këtë përkthim është bërë përpjekje për të përcjellë çdo ide dhe koncept të autorit, duke e përshtatur në gjuhën shqipe.

Uroj që ky libër të ndihmojë studiuesit dhe interpretuesit e Shkrimit të Shenjtë, klerikë e laikë të Kishës sonë, dhe për Lavdi të Perëndisë.

**Shënim:** Ky përkthim u realizua me qëllim për t'iu përdorur nga Radio Ngjallja. Nuk mund të shumëfishohet ose të qarkullojë në persona ose institucione të tjera, pa lejen e përkthyesit dhe të autorit.

## HYRJE

### Enigma e kësaj letre

Të flasësh për një “Letër drejtuar Apostujve”, mbetet një lloj supozimi, pasi vepra që kemi në duar nuk ka formën e një letre të mirëfilltë, dhe askund nuk deklarohet se u drejtohet hebrenjve. Në fakt, nëse i referohemi me këtë emërtim, është e qartë se jemi duke u mbështetur në Traditën e Kishës.

Ishte zakon që të gjitha letrat të kishin një pjesë hyrëse në formë përshëndetjeje, ku të bëhej i njohur autori i tyre dhe marrësi të cilit u drejtohej. Një model është p.sh. : “Pavli, apostull i Jisu Krishtit me anë të vullnetit të Perëndisë, edhe vëllai Timothe, shenjtëve dhe vëllezërve besimtarë në Krishtin që janë në Kolosë; hir mbi ju dhe paqe prej Perëndisë, Atit tonë, edhe prej Zotit Jisu Krisht.” (Kol.1:1-2). Një tjetër formë e mundshme do të ishte edhe: “Apostujt dhe pleqtë e vëllezërit, vëllezërve prej kombeve nëpër Antioki e nëpër Siri e nëpër Kiliki, përshëndetje.” (Vep. Ap. 15:23).

Në këtë letër nuk figuron një hyrje e tillë, për pasojë nuk mund të jemi të qartë për autorësinë e saj, si dhe kohën, vendin apo arsyeën se përse u shkrua. Siç thoshte Origjeni, autorin e kësaj letre “e njeh vetëm Perëndia” (citim nga Eusevio, në veprën “Historia e Kishës” 6. 25).

Megjithatë, kjo mungesë njohurish nuk ka ndaluar asnjë studiues (përfshirë këtu dhe vetë Origjenin) që të ngrejë hipoteza.

Klementi i Aleksandrisë (i cili fjeti rreth vitit 215) mendonte se autori i kësaj letre është vetë apostull Pavli, por arsyeja se përse ky i fundit hezitoi ta shkruante emrin ishte se e dinte se nuk do të mirëpritej nga lexuesit hebrenj, të cilët dyshonin për të dhe e paragjykonin.

Klementi ishte drejtor i një shkolle të madhe katekitime në Aleksandri, dhe pohonte se të njëjtin mendim me të ndante edhe paraardhësi i tij, “ati i shenjtë” Pantenus-i (cituar nga Eusevio në veprën “Historia e Kishës” 6.14).

Origjeni (i cili fjeti në vitin 254) ishte i mendimit se ky libër u shkrua nga një nxënës i hershëm i apostullit Pavlit, që shfaq edhe mendimin e vet personal ndaj mësimin të apostullit (Historia e Kishës, 6.25). Pas fjetjes së Origjenit, Lindja e Krishterë e pranoi këtë letër si kanonike, dhe apostull Pavlin si autor të saj.

Një tjetër supozim ishte se Letra u shkrua nga shën Varnava. Tertuliani (i cili fjeti në vitin 240), në veprën e tij “Mbi modestinë” shkroi se ekzistonte një letër drejtuar

hebrenjve, e shkruar nga Varnava. Megjithëse Tertuliani e dëshmoi këtë si një fakt, për sa kohë nuk ekziston asnjë provë që ta vërtetojë, mbetet thjesht hipotezë.

Gjithashtu edhe kisha e Romës, në kohën e Eusevios (në fillimet e shek. IV ps.K.) deklaroi se kjo letër nuk ishte shkruar nga apostull Pavli. Kështu, letra u hoq nga Kanoni i hershëm Afrikan, sa që shën Qipriani i Kartagjenës nuk e përmend fare. Vetëm në fillim të shek. V ps.K. Perëndimi e pranoi letrën si kanonike, edhe kjo falë ndikimit të shenjtorëve Jeronim dhe Augustin.

Pra çfarë mund të thuhet me siguri për këtë vepër? Unë do të sugjeroja si më poshtë:

1. Është e qartë se autorësia nuk i takon apostull Pavlit. Ka një dallim të theksuar mes stilit të tij të shkrimit dhe gjuhës së përdorur në letrat e tjera. Përveç kësaj, vetë apostulli dëshmon se ka lënë nga një shenjë identifikuese në secilën nga letrat e tij, si shenjë origjinaliteti (2 Sel. 3:17). Me gjithë respektin për Klementin e Aleksandrisë, nuk mendoj se një njeri si Pavli do të kishte ngurruar ta shkruante emrin e tij për çfarëdo lloj arsyeje.

2. Mund të dallohet qartë se letra nuk është shkruar më shumë se dy breza pas Krishtit dhe apostujve të Tij, pra për afërsisht pas apostull Pavlit. Në vargun e tretë të kapitullit të dytë, shkruesi i referohet apostujve si persona të së kaluarës, “ata që dëgjuan” fjalën e Perëndisë dhe “na e vërtetuan”. Nuk do të kishte kuptim që ndonjëri nga dishepujt të fliste në një mënyrë të tillë, por padyshim ndonjë që i takon brezit pasardhës të tyre. Gjithashtu, nga mënyra se si autori u referohet dishepujve, duket se shkruan në një kohë ku ata nuk jetojnë më (gr. *ekvasin* - krahaso përdorimin e së njëjtës fjalë tek Fj. Urta 2:17), madje tingëllon sikur ka kaluar njëfarë kohe që nga vdekja e tyre. Kur kjo letër po shkruhej, Timotheun e kishin burgosur dhe më pas liruar (13:23), ngjarje këto të cilat vështirë se mund t’i arrinte ndonjëri nga brezi i apostujve. Mendohet se letra daton pas martirizimit të shën Pavlit, që ndodhi rreth vitit 60. Të gjitha këto dëshmojnë se autori i Letrës drejtuar Hebrenjve i takon brezit të dytë të të krishterëve.

3. Padyshim letra u shkrua para shkatërrimit të Tempullit, që ndodhi në vitin 70. Autori shkruan se Dhiata e Vjetër bashkë me ritet e Tempullit ishin vjetërsuar dhe madje afër prishjes. Ky fakt dëshmon se në kohën kur u shkrua letra, Tempulli ishte ende më këmbë.

4. Nuk ka dyshim se letra u drejtohet popullit hebre, pasi në të trajtohen tema dhe vështirësi që do të mund të haseshin vetëm nga këta të fundit. Bëhet fjalë për judenjtë e konvertuar në Krishterim.



Sa radhitëm më lart, janë të sigurta. Bazuar në to, mund të shtojmë edhe disa hamendësime:

**1. Mbi autorin:** Autorësia i takon ndonjë mësuesi të krishterë anonim. Kjo mungesë njohjeje dhe fame e vërteton edhe më tej faktin se nuk bëhet fjalë për ndonjë nga apostujt e njohur (Pavli, Barnaba, Sila apo Llukai), pasi nëse do të kishte qenë ndonjëherë prej këtyre, me siguri do të ishte bërë e njohur nga Tradita. Kur ne, në kohët e sotme, përpiqemi të hamendësojmë se kush mund ta ketë shkruar letrën, na vijnë ndër mend vetëm emrat më të njohur të atyre që kanë shkruar letrat e tjera. Megjithatë, kurrsesi nuk mund të përjashtohet mendimi se mund të bëhet fjalë për ndonjë person që ka mbetur plotësisht i panjohur. Dimë se letra u shkrua në Itali, gjë që duket tek 13:24, në përshëndetjet “e atyre që janë nga Italia”. Ka mundësi që shkruesi të ketë qenë në Romë, meqenëse është në dijeni për arrestimin e Timotheut (13:23). Sigurisht që lajmi për arrestimin e tij u përhap më vonë edhe në qytetet e tjera, por banorët e Romës ishin të parët që e morën vesh.

**2. Kujt i drejtohet:** Jam i mendimit se hebrenjtë e krishterë, të cilëve u drejtohet letra, janë ata të Kishës së Palestinës, pasi këta të fundit u persekutuan më tepër nga judenjtë e tjerë jo të krishterë (krahaso me 1 Sel. 2:14). Ky persekutim dëshmohet qartë tek 10:32-34. Ai që shkroi këtë letër nuk i qorton lexuesit për faktin se u ndanë nga vëllezërit me prejardhje pagane, të cilët u konvertuan në të krishterë. Nëse letra u drejtohet të krishterëve me origjinë hebraike nga Diaspora, pra jashtë kufijve të Palestinës, ata do të ishin të bashkuar me të krishterët me prejardhje pagane. Nëse hebrenjtë e krishterë do të qëndronin larg misterit të Falënderimit Hyjnor, kjo do të nënkuptonte edhe një ndarje të tyre nga të krishterët e tjerë. Autori i qorton ata për mendimin për të mos marrë pjesë në Mbledhjet Adhuruese (10:25), por nuk thotë se nëse do të bënin kështu, do të largonin veten edhe prej vëllezërve më Krishtin. Kishat të cilave u adresohet duken se përbëhen vetëm nga të krishterë me origjinë hebraike, gjë që tregon se bëhet fjalë për Palestinën.

Duket se letra i drejtohet vetëm njërit komunitet të krishterë ose një enorie, jo në mënyrë të përgjithshme. Hasen shumë referenca që i përkasin të kaluarës së atyre për të cilët u shkrua letra, gjë që tregon se shkrimtari i njihte vetë personalisht (shiko 5:11-14; 6:9-12; 10:32-35; 12:4; 13:19; 23.)

**3. Arsyeja se përse u shkrua letra:** Sipas mendimit tim, autori i letrës ishte një i krishterë me origjinë hebraike, i cili megjithëse ndodhej në Romë kishte lidhje të ngushta me të krishterët e Palestinës. Mesa duket ai kishte dëgjuar për vështirësitë që ata po hasnin, të cilat po i shtynin në një mohim të mundshëm të besimit.

Persekutimi ndaj tyre ishte rritur shumë, ia kishin marrë të gjitha gjërat që zotëronin dhe madje disa edhe i kishin burgosur (10:34), megjithëse martirizimet nuk kishin filluar akoma (12:4). Miqtë e tyre judenj (jo të krishterë), i shtynin vazhdimisht që të mohonin besimin në Krishtin dhe të ktheheshin përsëri në Judaizëm (12:3). Madje presioni ndaj tyre mund të kishte arritur deri aty sa t'i kërcënonin se do t'i dëbonin nga pjesëmarrja në adhurimin e Tempullit (13:10-15). Ndoshta, disa prej këtyre të krishterëve kishin filluar të besonin se edhe po ta mohonin besimin, do t'i bënin dobi theroret e Tempullit (10:26-31).

Përballë këtyre vështirësive, disa prej tyre po mendonin të braktisnin Mbledhjet Adhuruese që bënin në të parën ditë të javës, ashtu siç kishin bërë edhe të tjerë (10:25). I shqetësonte gjithashtu edhe gjendja e mjerueshme ekonomike në të cilën i kishte sjellë besimi i tyre i krishterë (13:5-6). Kishte edhe nga ata, të cilët kishin rënë në imoralitete (12:15-17; 13:4). Të tjerë grindeshin me vëllezërit (12:14) apo me udhëheqësit shpirtërorë (13:17,24).

Për këtë arsye, autori shkroi këtë letër për miqtë e tij në Palestinë, për t'i nxitur që të mos binin në apostazi. Duke qenë hebrenj, ata shkonin të shtunave në sinagoga, dhe pastaj ditën e diel mblidheshin të gjithë bashkë në kremtimin e Eukaristisë Hyjnore. Me të gjithë presionin e vazhdueshëm, po mendonin të mos shkonin më në Mbledhjet Adhuruese, e kësajsoj të mohonin edhe Krishtin.

Duke e parë këtë situatë nga këndvështrimi ynë i sotëm, ne e mendojmë Krishterimin dhe Judaizmin si dy fe të ndryshme, ndërmjet të cilave duhet zgjedhur. Mirëpo asokohe të krishterët e Palestinës nuk i shikonin dot në këtë mënyrë, por mendonin se besimi i etërve të tyre tashmë ishte përmbushur me ardhjen e Mesisë. E konsideronin veten akoma judenj dhe mendonin se pikërisht kjo gjë i bënte të ishin të pranuar nga Perëndia. Vazhdonin të zbatonin ritet judaike, si rrethprerjen, rregullat e privimit të ushqimit, studimin e Torah-ut dhe adhurimin në Tempull. Si ndjekës të udhës (Vep. Ap. 24:14), për ta, të qenit të krishterë ishte pjesë e Judaizmit. Fakti që po mendonin ta fshihnin besnikërinë e tyre ndaj Krishtit si Mesi, nuk do të thoshte për ta që po e braktisnin Krishterimin, por thjesht që nuk po e vinin në dukje. As nuk e konsideronin si një apostazi (mohim të besimit). Në mendimin e tyre, ata mbeteshin akoma besimtarë të mirë judenj.

Duke e njohur këtë rrezik, autori i letrës nuk ngurroi t'i shkruante për rëndësinë absolute që kishte besimi në Krishtin për shpëtimin e shpirtit, dhe se braktisja e Tij nënkuptonte largim nga udha e shpëtimit që ishte përgatitur për ta.

Nëse vërtet vendosnin të mos e shfaqnin besimin e tyre, duke iu larguar Misterit të Eukaristisë Hyjnore (10:25), kjo do të përbënte vulën e apostazisë. Asnjë flijim Tempulli nuk do të mund t'i shpëtonte dot më pas (10:26-31).

Kështu, autori përqendrohet tek personi i Krishtit: më i lartë se engjëjt, më i madh se Moisiu, vepra e të Cilit tejkalonte çdo therore të gjakshme që blatonin priftërinjtë e Tempullit. Nëse prej besimit të tyre në Krishtin do t'i dëbonin nga Tempulli dhe sinagogat, le të ndodhte kështu. Priftëria e Tij është më e lartë se çdo priftëri tokësore, dhe vetëm në Të gjendet shpëtimi.

Përveç qëndrimit në besën e krishterë (të shprehur përmes pjesëmarrjes në Eukaristinë Hyjnore) nevojitej edhe ta jetonin këtë besim duke qëndruar larg tundimeve të imoralitetit, duke jetuar në paqe dhe duke u mbështetur plotësisht në providencën e Perëndisë. Prandaj autori i nxit lexuesit ta vendosin Krishtin si themel dhe qëllim të jetës së tyre dhe t'i dedikohen Atij plotësisht.

**4. Vendi dhe koha e shkrimit:** Do të sugjeroja se kjo letër u shkrua në Romë, rreth vitit 67, pra pas vdekjes së apostull Pavlit dhe arrestimit e lirimit të Timotheut, por përpara se të shkatërrohej Tempulli (70 ps. K.). Nëse data e supozuar është e saktë, kjo do të shpjegonte vështirësitë dhe persekutimet që hasnin të krishterët hebrenj, nga hebrenjtë e tjerë jo të krishterë. Dimë se në ato vite konflikti mes Romës dhe judenjve të Palestinës ishte shumë i madh, dhe hebrenjve të krishterë u bënin presion që të shfaqnin patriotizmin e tyre. Fakti që ata besonin tashmë në Krishtin, i përçante nga judenjtë e tjerë, të cilët ndienin se duhet të qëndronin të bashkuar kundër Romës.

**5. Gjuha e shkruar dhe mungesa e hyrjes:** Duket se letra u shkrua origjinalisht në gjuhën greke (pra nuk u përkthye nga aramaishtja në greqisht). Kjo jo vetëm për nivelin e lartë të greqishtes së përdorur, por edhe për faktin se shumë herë autori citon Dhiatën e Vjetër sipas versionit të Septuagintës.

Mendoj se teksti origjinal përfshinte edhe një hyrje, e cila u hoq më pas kur teksti u kopjua dhe shumëfishua. Nëse vërtet teksti u shkrua nga një i krishterë i panjohur, përmendja e emrit të tij nuk do të kishte ndonjë kuptim për publikun, prandaj edhe mund të jetë hequr.

Për Letrën drejtuar Hebrenjve ka ende spekulime nga studiues të ndryshëm, por nuk duhet t'i lemë këto të na shpërqendrojnë nga thesari i madh që përmban kjo vepër. Cilido qoftë hartuesi i saj, apo marrësi, të cilit i drejtohet, ajo mbetet dëshmi e shumëçmuar e të krishterëve të parë, duke përcjellë brez pas brezi mësimet autentike të apostujve. Falë personit që e shkroi, ne sot kemi një kuptim më të thellë të priftërisë së lartë të Krishtit - Atij që qëndron lart në qiejt, që është i njëjti dje, sot dhe përjetë.

# I

## FJALË HYRËSE

(1:1-4)

Të krishterët të cilëve u drejtohet kjo letër, e dinin dhe e besonin se Jisui është Mesia, vetëm se nevojitej të kuptonin se çfarë do të thotë kjo gjë në të vërtetë. Disa prej tyre mund të mendonin se Mesia ishte thjesht një profet, i lartësuar mbi të gjithë profetët e tjerë, por përsëri njerëzor, ndërsa të tjerë mund ta identifikonin me ndonjë engjëll të mishëruar, meqë engjëjt ishin kategoria më e lartë e qenieve të krijuara që ata njihnin. Ky mendim i fundit mbështetej edhe në titullin që i ishte dhënë Mesisë në shkrimet e profetit Isaia (versioni grek - 9:6) “engjëll i Këshillit të lartë” .

Për këtë arsye, letra nis me një shpjegim lidhur me madhësitë e Jisuit, jo thjesht të një engjëlli të mishëruar, por njërit që qëndron shumë më lart sesa ata. Madhështia e Tij, është në fakt madhështia e vetë Perëndisë. Lexuesit e letrës po përballeshin asokohe me presionin për t’u tërhequr nga besimi në Krishtin, me mendimin se kjo nuk do ta dëmtonte shumë judaizmin e tyre. Autori e kundërshton fort këtë tezë, duke shpjeguar se Jisui nuk është thjesht një ndër profetët, por përmbushja dhe pika kulmore e të gjithë veprës shpëtimtare të Perëndisë që nga fillimi. Historia e popullit të zgjedhur të Zotit nuk ka asnjë kuptim pa Të.

Si mund ta mendonin izraelitët të largoheshin e ta braktisnin Atë që është kaq madhështor e i plotfuqishëm? Si mund të shpresonin të gjenin shpëtim pa Të?

**1 Perëndia, pasi u foli qëmoti etërve tanë me anë të profetëve shumë herë e me shumë mënyra,**

**2 në këto ditë të fundit na foli neve me anë të Birit, të cilin e bëri trashëgimtar të gjithave, me anë të të cilit bëri edhe jetët;**

**3 i cili, duke qenë ndriçimi i lavdisë dhe karakter i qenies së atij, edhe duke i mbajtur të gjitha me fjalën e fuqisë së tij, pasi me anë të vetes së tij pastroi mëkatet tona, ndenji në të djathtë të madhërisë në të lartat;**

**4 edhe u bë kaq më i mirë nga engjëjt, sa emër më të shquar se ata ka trashëguar.**

Autori e nis letrën e tij duke e vendosur Jisu Krishtin në qendër të të gjithë vetëzbulesës së Perëndisë. **Shumë herë e me shumë mënyra** (gr. *polimeros kai*

*politropos*) **Perëndia u foli qëmoti etërve tanë me anë të profetëve.** Kjo do të thotë se i Tërëfuqishmi e shfaqti veten e Tij **shumë herë**, qoftë me zbulesa të mëdha, si edhe të tjera më të vogla. Të shumta ishin dhe format në të cilat e shfaqti veten, duke përdorur orakuj, poezi, paravoli, vizione, fjalë të urta e ligjërata, të gjitha këto nëpërmjet gojëve të **profetëve** (pra të gjithë atyre që shkruan Dhiatën e Vjetër, përfshirë Moisiun, Davidin, Solomonin, Isaian e shumë të tjerë).

Deri në atë pikë, të gjitha zbulosat ishin padyshim të sakta, por jo të plota. Prandaj, **Perëndia na foli neve me anë të Birit** të Tij, plotësisë dhe përmbushjes së të gjithë zbulësës. Shprehja “**në këto ditë të fundit**”, që hasim në Shkrimin e Shenjtë, nuk nënkupton thjesht një kohë të afërt apo diçka që ka ndodhur së fundmi, por mbart kuptim eskatologjik. Krishti na u zbulua në përmbushjen e kohërave, në mbarim të jetëve (1 Kor. 10:11). Të gjitha ngjarjet e historisë njerëzore kulmuan në Të, Ai është përmbushja dhe themeli i gjithçkaje që parapriu ardhjen e Tij, si dhe atyre që e pasuan.

Fakti që Biri përmendet i fundit në listën e zbulësave të Perëndisë, rithekson rëndësinë ndryshimin e madh që kishte Ai nga të gjitha shfaqjet e mëparshme. Mishërimi i Perëndisë në personin e Jisuit nuk ishte vetëm një epifani (shfaqje prej së larti) e radhës, as dhe thjesht e fundit.

Jisui nuk është vetëm “i fundit i profetëve” (siç thonë myslimanët për Muhamedin), por në Të është e gjithë përmbushja e vetëzbulësës së Perëndisë. Ndërsa në rastet e tjera të mëparshme janë shfaqur vetëm copëza zbulëse, në Krishtin qëndron gjithë plotësia e Perëndisë.

Përmes vizioneve dhe fjalëve të profetëve na u tregua vullneti i Zotit (Gjen.12:1-3). Kur Perëndia iu shfaq Moisiut në formë zjarri dhe vetëtimash në Malin Sina, Ai i shfaqti vullnetin e Tij nëpërmjet Ligjit që i dha. Nëpërmjet gojëve të profetëve bëri të njohura atributet e Tij dhe i thirri të gjithë njerëzit në shenjtërim. Fjala e Perëndisë u dha edhe në shumë forma të tjera: përmes Psalmeve të Davidit, Fjalëve të Urta të Solomonit, vizioneve të profetëve Ezekiel dhe Isaia, të cilët panë lavdinë e Më të Lartit, apo vizioneve të Gjykimit të popujve, që iu shfaqën profetit Daniel.

Me anë të profetëve, njerëzimi u lajmërua për ardhjen e shumëpritur të Mbretërisë së Perëndisë dhe Mbretit - Mesisë, Birit të Davidit.

Ndërsa në të gjitha rastet që përmendëm më lart Zoti shfaqti vullnetin e Tij, në personin e Krishtit manifestohet vetë Perëndia i gjallë, Mishërimi i gjithë plotësisë së Tij, Biri i vërtetë i Atit. Nuk mund të ketë më asnjë profeci pas ardhjes së Krishtit, sepse Ai i përmbushi dhe i plotësoi të gjitha. Prandaj nuk mund të ketë as “shenjtore të ditëve të mëvonshme”, pasi gjithçka që ende nuk dihej për Perëndinë, u zbulua

nëpërmjet Birit të Tij. Për këtë arsye themi se Jisui është vula e të gjithë profetëve, dhe nuk mund të ketë më profetë pas Tij.

Në këtë letër paraqiten shumë veçori të Birit të Perëndisë, që për të krishterët e sotëm mund të duken të njohura dhe normale, pasi jemi familjarizuar me Krishtin si Personin e Dytë të Trinisë së Shenjtë dhe kemi zbulesën e përmbledhur në Simbolin e Besimit.

Megjithatë, mund të arrijmë të perceptojmë se sa shokuese apo edhe skandalizuese mund të tingëllonin në shoqërinë e njerëzve të shek. I. Ata ishin mësuar ta shikonin Jisuin si një marangoz të thjeshtë tridhjetë vjeçar, që për më tepër u rreshtua me keqbërësit dhe vdiq në kryq. Sa e befashme dhe e pakonceptueshme mund të ishte për ta se Ai ka pushtetin mbi të gjitha.

Prandaj të krishterët e parë nuk i merrnin këto fjalë për të mirëqena. E dinin se Jisui i Nazaretit ishte Mesia që prisnin, e njihnin dhe autoritetin e Tij hyjnor. Megjithatë, ishte shumë e vështirë për ta të kuptonin gjithë natyrën e Tij.

Gjëja e parë që na thuhet për Krishtin, është se Perëndia e bëri **trashëgimtar të të gjithave**. Marangozit nazaretas, Ati i dha pushtet mbi të gjitha, duke e bërë Zot dhe Mbret të Mbretërisë së Tij. Pra nuk bëhet fjalë për një mbret të Judenjve, i cili do të vendoste edhe lidhje me popujt paganë, por për një Mesi që do të “zotëronte mbarë dheun” (Ps. 2:8).

Përpara ardhjes në botë nga Virgjëresha Mari, qëndronte bashkë me Atin, si Fjala dhe Urtësia e përjetshme e Perëndisë, nëpërmjet të Cilit u krijuan të gjitha.

Autori i letrës, duke shkruar se Krishti, para Mishërimit të Tij, ishte bashkë me Atin në krijimin e botës, shpall gjithashtu Hyjninë e Birit. Sipas Tij, Biri është **ndriçimi i lavdisë së Perëndisë**. Fjala *ndriçim* (gr. *apavgasma*) përdoret edhe në formën pasive si reflektim, por dhe në atë aktive si rrëzëllimë. Edhe konteksti në fjalë i pranon të dyja kuptimet, pasi Krishti është njëkohësisht reflektimi dhe shprehja e Atit.

Në më të shumtën e rasteve, etërit e përshkruajnë lidhjen e Atit me Birin duke e lidhur me imazhin e diellit dhe të rrezeve të tij. E gjithë esenca e zjarrtë e diellit përhapet dhe shprehet nëpërmjet rrezeve, dhe vetëm këto të fundit janë të dukshme për syrin e njeriut, pasi askush nuk mund të shohë në brendësi të lëmshit të zjarrtë. Në të njëjtën mënyrë, Biri është shprehja e lavdisë së Perëndisë Transhendent. Esenca e Atit mbetet e pakuptueshme dhe Ai vetë i padukshëm për sytë e krijesave të Tij, por bëhet i dukshëm nëpërmjet shfaqjes së Tij tek Biri i mishëruar. Pikërisht këtë nënkuptoi edhe Krishti kur u tha dishepujve: “Ai që më sheh mua, ka parë Atin” (Jn. 14:9).

Më tej, thuhet se Jisui është **karakteri i qenies** së Atit (gr. *ipostasis*). Gjithçka që është Perëndia Atë, është dhe Biri. Në Të është e gjithë hyjnia, fuqia dhe autoriteti i Atit.

Gjithashtu, Biri i **mban të gjitha me fjalën e fuqisë së Tij**. Mbarë universi është nën pushtetin e fjalës së Tij. Duke qenë një me Atin dhe Ai me anë të së cilit u bënë të gjitha (shiko 1 Kor. 8:6), e gjithë krijesa ekziston vetëm falë fjalës së Tij. Universi nuk ka asnjë fuqi në vetvete, por mbahet në sajë të fuqisë së Perëndisë. Ato që shkencëtarët i konsiderojnë “ligje të natyrës” janë në fakt vepër e urtësisë së Perëndisë, për të mbajtur në harmoni të plotë gjithçka që ka krijuar. G.K. Chesterton shkruan: “Dielli lind çdo mëngjes sepse vetë Zoti e bën të lindë”. Autori i letrës sonë shton se është Biri i përjetshëm i Perëndisë Ai që e bën të lindë, pasi të gjitha me anë të Tij qëndrojnë (Kol. 1:17).

Kur themi se Biri dhe Ati janë një, nuk nënkuptohet vetëm në madhësinë e Tij si Krijues, por edhe si Shpëtimtar dhe Çlirues. **Pasi me anë të vdekjes së Tij** në kryq **pastroi mëkatet tona** dhe e çliroi botën nga prangat e mëkatit stërgjyshor, **ndenji në të djathtë të madhërisë** (hebrenjtë përdornin shpesh perifrime të tilla për t’iu referuar Atit) **në të lartat**. Folja “**ndenji**” nuk nënkupton një qëndrim fizik, por është pohim teologjik i sovranitetit të Tij. Duke qenë Mbret, Jisui qëndron në të njëjtin fron bashkë me Atin, ndan të njëjtin autoritet hyjnor. Judenjtë e shekullit I vërtet prisnin Mesian të merrte pushtetin e të qëndronte mbi fronin, por perceptonin një mbretëri tokësore e për pasojë, fron tokësor, siç ishte asokohe Perandoria Romake. Më vonë, ata që u kthyen në Krishterim e kuptuan se sa më i lartë është në të vërtetë autoriteti i Krishtit, aq sa qëndron në të njëjtin fron me Atin. Ai që mori natyrë njerëzore, ka pushtet mbi të gjithë dhenë. Një pohim i tillë tingëllonte skandalizues për judenjtë (dhe myslimanët në ditët e sotme).

Në këtë fragment të Letrës së Hebrenjve mund të kuptohet lehtë se Jisui qëndron më lart se çdo rresht engjëllor. Ai **u bë kaq më i mirë nga engjëjt, sa emër (ose rang) më të shquar se ata ka trashëguar**. Kur thuhet se “ka trashëguar emër”, nënkupton tërë lavdinë dhe autoritetin e Atit Qiellor. Ashtu si edhe çdo djalë trashëgon të gjithë pasurinë e të atit, edhe Jisui trashëgoi gjithë fuqinë dhe madhësinë e Perëndisë Atë kur u ul në të djathtë të fronit të Tij si Mesi. Ai që e përuli veten deri në vdekje me kryq, u lartësua në Fronin Qiellor. Kjo madhësi dëshmon se Ai qëndron shumë më lart se engjëjt.

## II

### MË I LARTË SE ENGJËJT

(1:5- 2:18)

#### 2.1. Biri qëndron më lart se engjëjt (1:5-14)

Pas fjalëve që shkruan për autoritetin e Birit të Perëndisë, që tejkalon atë të engjëjve, autori e përforcon pohimin e tij me një citim nga Shkrimi i Shenjtë, siç është zakoni judaik. Nevojitet të kujtojmë herë pas here atë që përmendëm dhe më parë, se megjithëse të krishterët e sotëm e dinë me siguri se Krishti është më i lartë se engjëjt, pasi kjo gjë dëshmohet në gjitha shërbesat dhe lutjet që ne bëjmë, ku edhe i kërkojmë engjëjve të ndërmetojnë për ne, kjo gjë nuk ishte aq e lehtë për të krishterët e parë, aq më tepër duke mos pasur ende as Simbolin e Besimit, ku shpallet qartë Hyjnia e plotë e Birit dhe të qenët e Tij një me Atin.

Në shekullin e parë, kur të krishterët ende vështirësoheshin në perceptimin e madhështisë së Birit, rangu më i lartë i fuqive qiellore që ata njihnin qenë engjëjt. Kësisoj, ishte e natyrshme për ta që ta konceptonin Krishtin si engjëll.

Në vargjet e profetit Isaia kjo gjë mund të pranohej deri diku, por në Kishën e shek. I, e cila kishte filluar të rrezikohet dhe nga përhapja e Gnosticizmit, një prezantim i saktë i personit të Krishtit ishte më se i domosdoshëm. Në të kundërt, nga padituria, njerëzit mund të krijojnë një ide të gabuar se Jisui ishte thjesht engjëll i lartësuar përmbi të tjerët, por përsëri krijesë. Prandaj edhe autori qëllimisht i paraprin një mendimi të tillë, duke e deklaruar që në hyrje Hyjninë absolute të Birit dhe natyrën e Tij krejt të ndryshme nga engjëjt.

Për t'i bindur dhe qartësuar lexuesit, ai paraqet fragmente të ndryshme të Shkrimeve, të cilat i referohen Mesisë apo engjëjve, duke i vënë përballë njëra-tjetrës në mënyrë kontrastive, që të dalin në pah më qartë ndryshimet.

Thelbi i argumentit të tij është se kur bëhet fjalë për Mesinë, theksohet pushteti dhe përjetësia e Tij, si dhe lidhja e ngushtë me Atin, ndërsa kur flitet për engjëjt, lavdërimi i tyre është i një shkalle më të ulët, dhe theksohet shërbimi i tyre karshi Perëndisë. Padyshim, Mesia nuk mund të ketë natyrë engjëjllore.

**5 Sepse cilit prej engjëjve i tha ndonjëherë: "Ti je Biri im; unë sot të kam lindur?"**



**6 Edhe përsëri: "Unë do t'i jem atij Atë, dhe ai do të më jetë Bir?". Edhe kur përsëri të shtjerë të parëlindurin në botë, thotë: "Edhe le t'i falen atij gjithë engjëjt e Perëndisë".**

Citimi i parë i autorit është shkëputur nga Psalmi 2:7, ku Perëndia i adresohet Mesisë duke thënë: **"Ti je biri im, unë sot të kam lindur"**. Fragmenti në fjalë lidhet me premtimin që Perëndia i bëri Davidit tek 2 Sam. 7:14: **"Unë do t'i jem atij Atë, dhe ai do të më jetë Bir"** (në tekstin në greqisht, përemrat vectorë vendosen në fillim për t'u theksuar). Të dyja vargjet e mësipërme i referohen Mesias.

Perëndia i premtoi Davidit gjëra të mëdha. Ai i tha se mbretëria e tij do të mbetej përjetë dhe se fronin e tij nuk do të mposhtej kurrë. I tha gjithashtu se ushtritë kundërshtarë nuk do ta shtypnin kurrë dhe se Perëndia do të asgjësonte armiqtë e tij dhe ata që e urrenin, mbretëria e tij do të shtrihej nga Mesdheu në lumin Euftrat dhe se do ta bënte Davidin të shkëlqyeshëm ndër mbretërit e dheut (Ps. 89:22, 23, 25, 27). Premtimi i Tij do të zgjaste përjetë, i qëndrueshëm ashtu si dielli dhe hëna (Ps. 89:36-37). Por ne e dimë se vetë Davidi nuk e përjetoi kurrë një lavdi të tillë, madje pushteti i tij u thye përfundimisht në robërinë e Babilonisë (586 p.K. ). Meqë fjala e Perëndisë nuk mund të jetë e gabuar, shohim përmbushjen e saj në pasardhësin e largët të Davidit, Mesian. Ky i fundit do të njihet afërsinë e një **Biri**, i Cili do të ishte përherë në mbrojtjen e Atit të Tij (Ps. 89:26), ashtu siç iu premtua Davidit.

Pyetja se **cilit prej engjëjve** iu drejtua ndonjëherë Perëndia në atë formë është retorike, pasi padyshim që asnjë engjëll nuk gëzonte një afërsi të tillë me Të. Por, siç shkruhet në vazhdim, **kur Perëndia të shtjerë të parëlindurin në botë, të gjithë engjëjt do t'i falen atij** (Ligj. Përt. 32:43; Ps. 97:7 LXX- sipas Septuagintës). Termi "i parëlindur" nënkupton pozitën e Mesisë në krahasim me mbretërit e tjerë të botës. Në Ps. 89:27 Mesia përshkruhet si "i parëlinduri, më i shkëlqyeri ndër mbretërit e dheut". Fjala "dheut" e përmendur në këtë Psalm, në greqisht është "*ikoumeni*", e cila është përdorur edhe tek Ungjilli i Llukait (2:1) për t'iu referuar Perandorisë Romake. Në këtë mënyrë, autori kërkon të tregojë epërsinë e Mesisë mbi të gjithë mbretërit e mbretërive tokësore. Kaq shumë e lartësoi Atë Perëndia, sa që **"edhe gjithë engjëjt i falen atij"**. Pra Mesia nuk mund të jetë një engjëll, pasi lavdërohet prej tyre.

## 7 Edhe për engjëjt thotë: "Ai që i bën engjëjt e tij frymëra, edhe shërbyesit e tij flakë zjarri".

Përshkrimi i Birit dallon shumë nga ai që i bëhet engjëjve në Shkrimet. **Për engjëjt thotë: "Ai që i bën engjëjt frymëra, edhe shërbyesit e tij flakë zjarri"**. Ky varg është marrë nga Psalmi 104:4, gjë që tregon rëndësinë e madhe që autori u kushton referencave të Dhiatës së Vjetër. Në hebraisht dhe greqisht, fjalët "engjëll" dhe "erë" kanë më tepër se një kuptim. Fjala "engjëll" (heb. *malak*; gr. *aggelos*) në të dyja gjuhët ka kuptimin "lajmëtar". Fjala "erë" (heb. *ruah*; gr. *pneuma*) mbartin kuptimet "erë", "shpirt" ose "frymë". Në psalmin 104:4, psalmisti flet për madhësinë e Jahveut mbi të gjitha krijesat dhe thotë se të gjitha janë vendosur në shërbim të Tij - I bën erërat (*ruah*) lajmëtarë (*malak*) të tij dhe flakët e zjarrit shërbëtorë të tij.

Në vitet që pasuan, krahas zhvillimit të një kuptimi më të thellë të elementeve frymore (jo materie) të krijimit, u zhvillua edhe të kuptuarit e elementeve të botës (materie). Shumë njerëz mendonin se engjëjt, këta rangje frymërash të padukshme që i shërbenin Zotit në qiell, ishin gjithashtu edhe fuqi të botës së dukshme (materies), të cilët i bindeshin vullnetit të Zotit. Kështu, në librin e Enokut (kapitulli 60) flitet për frymën e deteve, ngricave, të breshërit, dëborës etj. Njerëzit mendonin se pas secilës nga këto forca natyrore që përmendëm, qëndronte nga një engjëll i cili i komandonte.

Psalmisti mund të ketë pasur të njëjtin perceptim në Psalmin 104:4. Sipas versionit të Septuagintës, me *aggelos* nënkuptonte engjëjt jo thjesht si lajmëtarë, dhe me *pneuma* nënkuptonte erën. Duke e lidhur me fragmentin e Letrës së Hebrenjve, engjëjt, si **shërbyes** të Perëndisë, bëhen **frymëra** dhe **flakë zjarri** ndërsa bëjnë vullnetin e Tij. Kjo pohim përputhet gjithashtu edhe me Librin e dytë të Ezdras (2 Ezd. 8:22) ku thuhet: "Me urdhër të Zotit (engjëjt) u bënë erë dhe zjarr", pra morën formën e erës e të zjarrit, duke iu bindur Perëndisë si shërbyes dhe kujdestarë të krijimit të Tij.

Cili është kuptimi i këtij fragmenti? Autori e citon me qëllim që të theksojë natyrën e ndryshueshme të engjëjve. Ashtu si erërat dhe zjarri, që vijnë e largohen, ashtu veprojnë edhe ata në këtë botë, duke kryer shërbimet e tyre. Roli i engjëjve nuk është i qëndrueshëm si ai i Birit, që ka të njëjtin autoritet me Atin, por ata janë thjesht mbikëqyrës të krijimit.

## 8 Po për Birin thotë: "Froni yt, o Perëndi, është në jetë të jetës; shkop drejtësie është shkopi i mbretërisë sate.

**9 Deshe drejtësinë dhe urreve paudhësinë; prandaj të leu, o Perëndi, Perëndia yt, me vaj gëzimi më tepër se bashkëpjesëtarët e tu".**

**10 Edhe: "Ti në fillim, o Zot, themelove dhenë, edhe punë të duarve të tua janë qiejt.**

**11 Ata do të prishen, po ti mbetesh; edhe të gjithë si rrobë do të vjetërohen,**

**12 edhe si të veshur do t'i mbështjellësh ata, edhe do të ndërrohen; por ti je po ai, edhe vitet e tua nuk do të shterojnë".**

Në këtë paragraf del përsëri në pah kontrasti i thellë mes natyrës së engjëjve dhe të Birit. Në Psalmin 45:6-7 (LXX) shkruhet: "**Froni yt, o Perëndi, është në jetë të jetës; shkop drejtësie është shkopi i mbretërisë sate. Deshe drejtësinë dhe urreve paudhësinë; prandaj të leu, o Perëndi, Perëndia yt, me vaj gëzimi më tepër se bashkëpjesëtarët e tu**". Në kontekstin origjinal, paragrafi i mësipërm i drejtohet mbretit të fisit të Davidit dhe është pjesë e një Psalmi lavdërues për kremtimin e dasmës mbretërore. Mbreti lavdërohet hiperbolikisht dhe psalmisti i drejtohet si të ishte hyjnor, gjë që e hasim shpesh në Psalmet. Mbretit i thuhet Zot, sepse froni i tij u themelua në sajë të fuqisë së Perëndisë, që mbretëria tij të zgjasë në jetë të jetës. Për më tepër, vetë i Gjithëpushtetshmi e veshi atë me pushtet dhe autoritet, sepse duke qenë i drejtë, **deshi drejtësinë dhe urreu paudhësinë**. Si shpërblim, **Perëndia e leu me vaj gëzimi** duke e lartësuar përmbi të gjithë **bashkëpjesëtarët** e tij, pra mbretërit e tjerë të botës.

Siç përmendëm dhe më parë, asnjë nga këto premtime nuk u realizuan për Shtëpinë e Davidit, por u përmbushën për Mesinë. Gjithçka tjetër që shkruhet për Davidin në mënyrë hiperbolike, është në fakt profeci për Krishtin. Të gjitha mitet, poezitë dhe aspiratat bëhen realitet i prekshëm në personin e Tij. Në Psalmin që referuam, mbretit psalmisti i drejtohet si "**Zot**" thjesht në mënyrë poetike, por Zoti i vërtetë që qëndron në thelb të vargjeve është Jisui. Është **froni** i Tij që **do të mbetet në jetë të jetëve**, dhe Ai do të lartësohet **më tepër se bashkëpjesëtarët** e tij, përmbi të gjitha autoritetet dhe fuqitë - madje edhe engjëjt.

Një tjetër Psalm i cituar në këtë fragment, ku gjithashtu shfaqet përjetësia e Mesisë, është Psalmi 102:25-27: "**Ti në fillim, o Zot, themelove dhenë, edhe punë të duarve të tua janë qiejt. Ata do të prishen, po ti mbetesh**".

Në versionin hebraik, psalmisti i referohet Perëndisë Jahveh duke deklaruar përjetësinë e Tij, si dëshmi e fuqisë së pakufishme, për të treguar se për Të ishte kurdoherë e mundur të sillte Mbretërinë e Qiejve, që "bijtë e pasardhësve të tij të kishin një vendbanim të qëndrueshëm" (Ps. 102:28).

Në ndryshim nga psalmisti, autori i Letrës së Hebrenjve e përdor fragmentin për t'iu referuar Mesisë, me qëllim për të nxjerrë në pah natyrën e Tij hyjnore, krejt të ndryshme nga ajo e engjëjve. Edhe lexuesit e letrës e lidhin menjëherë fragmentin me Mesinë. Por si ka mundësi të ndodhë kështu? Si mundet autori ynë të marrë një varg që i referohet në fakt Jahvehut dhe ta përshtatë duke e lidhur me Krishtin?

Përgjigja gjendet në versionin grek të këtij psalmi tek Septuaginta, të njëjtin version që përdori dhe autori i letrës dhe që ndryshon pak nga ai hebraik. Tek ky i fundit është shkruar: "Rrugës ai ka pakësuar fuqinë time dhe ka shkurtuar ditët e mia. Kam thënë: 'O Perëndia im, mos më merr në mes të ditëve të mia. Vitet e tua zgjasin brez pas brezi. Së lashti ti ke vendosur tokën dhe qiejt janë vepër e duarve të tua'" (Ps. 102:23-25). Në versionin grek është shkruar: "M'u përgjigj me fuqinë e tij, 'Tregomë zgjatjen e ditëve të mia; mos më merr në mes të ditëve të mia. Vitet e tua janë brez pas brezi. Ti, në fillim, o Zot, themelove dhenë."

Në versionin hebraik kemi lutjen e një njeriu drejtuar Perëndisë, për zgjatjen e ditëve të tij dhe shpëtimin nga kthetrat e vdekjes. Vërejmë se i gjithë psalmi ka ton lutës. Përkundrazi, në versionin grek kemi një ndryshim. Toni lutës përfundon në vargun 22, dhe duke nisur nga vargu 23 e më tej, është vetë Perëndia që i përgjigjet lutjes. Pra, kur thuhet "M'u përgjigj", supozohet se lutësi mori përgjigje nga Perëndia.

Po cilat ishin fjalët e të Shumëlartit? "Tregomë zgjatjen e ditëve të mia; mos më merr në mes të ditëve të mia" (që nënkupton: "kupto ditët që kam caktuar për të vepruar e për të shpëtuar Sionin dhe mos më thirr në mes të kohës që caktova"). Dhe vijon përgjigja e Perëndisë: "Ti, në fillim, o Zot, themelove dhenë".

Kush mund të jetë Ai të cilin vetë Zoti e quan "**Zot**" dhe që **në fillim themeloi dhenë**? Për çdo lexues të Septuagintës, është e qartë se bëhet fjalë për Mesinë, me anën e së Cilit u bënë të gjitha. Për këtë arsye, fragmenti i psalmit, sipas Septuagintës konsiderohet Mesianik, pasi interpretohet si një dialog mes lutësit dhe Perëndisë, dhe jo thjesht thirrje përgjëruese drejtuar Atij, siç mund të kuptohet në versionin hebraik.

Autorit i intereson ky fragment edhe për të nxjerrë në pah përjetësinë e Mesisë, duke e vendosur në kontrast me përkohshmërinë e qiejve dhe të gjithë krijesave të tjera, madje dhe engjëjve. Si një njeri që rron edhe pasi rrobat e tij vjetërsohen e grisen, ashtu edhe Mesia do të vazhdojë të jetë edhe pasi bota të shkatërrohet. Këtu shfaqet qartë dhe inferioriteti i engjëjve ndaj Tij. Ndërsa ata krahasohen me erërat dhe vetëtimat, që sidoqoftë janë kalimtare, Mesia është i përjetshëm. Natyra e Tij është rrënjësisht e ndryshme nga ajo e engjëjve.

## DISKUTIM:

### Mbi përdorimin e Septuagintës

Septuaginta (versioni grek i Dhiatës së Vjetër, i përkthyer nga hebraishtja në mes të shek. III p.K.) është versioni më i përdorur në Kishën Orthodhokse. Në pjesë të veçanta hasen ndryshime në krahasim me tekstin hebraik. Disa shkrime të tij mendohen të jenë edhe më të vjetra se versioni hebraik, prej të cilit janë përkthyer dhe versionet e ndryshme në anglisht që qarkullojnë sot. (Përveç versionit bazë të hebraishtes kanë ekzistuar edhe të tjera, siç është p.sh. Pentateuku<sup>1</sup> Samaritan).

Ndër të gjitha përkthimet e tjera të Biblës, Septuaginta mbetet padyshim versioni bazë i Kishës së Hershme, madje për disa Etër ishte versioni i vetëm që ata njihnin. Sipas përmbajtjes së saj ishin të përcaktuara dhe librat që njiheshin nga Dhiata e Vjetër (p.sh. Kisha jonë pranon si pjesë të Shkrimit të Shenjtë të Perëndifrymëzuar librat e Sirakut, urtësinë e Solomonit etj.). Sipas shën Kirillit të Jerusalemit, përkthimi i Septuagintës qëndron më lart se çdo përkthim tjetër. Të njëjtin mendim me të ndajnë edhe shumë të tjerë. Ai shkruan se: “Procesi (i përkthimit të Septuagintës nga teksti origjinal hebraik), nuk u realizua si pasojë e urtësisë apo talentit njerëzor, por nëpërmjet Hirit të Shpirtit të Shenjtë, i Cili frymëzoi edhe fjalët e shkruara në të” (Marrë nga *Mësimet Katekitike*).

Disa nga Etërit ishin të vetëdijshëm se ky version kishte disa dallime në krahasim me origjinalin. Lidhur me këtë çështje, ata padyshim e pranuan origjinalin Hebraik si të Perëndifrymëzuar, ndërsa përkthimin grek si përkthim gjithashtu të frymëzuar që lartazi, madje edhe argumentues e shpjegues të origjinalit. (Mund të shtojmë se fakti që ata nuk hezituan të shpreheshin për saktësinë e Septuagintës, erdhi si pasojë e kundërshtimit të fortë që hasi kjo e fundit nga ithtarët e Krishterë hebrenj, të cilët e konsideronin atë të ndryshuar e të pasaktë.)

Mund të pohojmë padyshim se Septuaginta qëndron më lart se përkthimet e tjera, jo vetëm sepse shumica e citimeve nga Dhiata e Vjetër, të cilat referohen në Dhiatën e Re, janë të marra nga ky version, por dhe pasi disa nga interpretimet që i janë bërë versionit origjinal, kanë përcaktuar mësimet e Kishës. Ndër to përmendim përkthimin grek të librit të profetit Isaia (7:14): “Edhe ja, e virgjëra (gr. *parthenos*) do të mbarset dhe do të lindë një djalë”. Në versionin origjinal, i njëjti varg thuhet: “Edhe ja, gruaja e re (Heb. *almah*) do të mbarset.” Megjithëse nuk mund të themi se dy versionet kundërshtojnë njëri-tjetrin (një grua e re mund të jetë e virgjër), dimë se kur ky varg u citua tek Ungjilli i Mattheut (1:23), u shkrua sipas versionit grek.

---

<sup>1</sup> Pesë librat e parë të Moisiut në Dhiatën e Vjetër. (Shën. i përk.)

Po kështu, edhe kur në Letrën drejtuar Hebrenjve (1:10-12) citohet psalmi 102:25-27, përdoret versioni i Septuagintës.

Nga sa thamë më lart, mund të kuptohet qartazi se, nëse do të citohej versioni Hebraik, pasazheve të Dhiatës së Re do t'u venitej përqasja me kuptimin Mesianik. Nuk mohohen kurrsesi vlerat e pazëvendësueshme të versionit origjinal, i cili mund të shërbejë si bazë për çdo përkthim që i bëhet Shkrimit. Megjithatë, vendi i nderit i takon përkthimit dhe interpretimit të Septuagintës, që u citua nga apostujt dhe nga lexuesit më të hershëm të Dhiatës së Re.

**13 Edhe cilit prej engjëjve i tha ndonjëherë: "Rri në të djathtën time, deri sa të vë armiqtë e tu nënkëmbje të këmbëve të tua"?**

**14 A nuk janë të gjithë frymëra shërbyese, që dërgohen për shërbesë për ata që kanë për të trashëguar shpëtim?**

Në vargjet e lartpërmendura dëshmohet për të disatën herë lavdia dhe sovraniteti i Birit. Në Psalmin 110:1, Perëndia i referohet Mesisë, duke thënë: **"Rri në të djathtën time, deri sa të vë armiqtë e tu nënkëmbje të këmbëve të tua."** Pra, Mesia do të kishte të njëjtin pushtet si Ati dhe i Plotfuqishmi do t'i shkatërronte të gjithë armiqtë e Tij. Pushteti i Tij nuk do të ishte i një përmase më të kufizuar, por do t'i jepej të sundonte të gjithë dhenë. Vallë, **cilit prej engjëjve iu ishte thënë ndonjëherë ky premtim?** Asnjëherë nuk iu është drejtuar asnjërit prej tyre në këtë formë, përkundrazi, kanë pasur gjithnjë pozitë shërbimi.

Ky pohim, i formuluar në formë pyetëse, nuk kërkon në fakt një përgjigje apo referim biblik, por kërkon të nxjerrë në pah dallimet mes engjëjve dhe Birit.

Autori e mbyll fragmentin me një pyetje: **"A nuk janë të gjithë engjëjt frymëra shërbyese** (gr. *leitourgika pnevmata* - që fjalë për fjalë do të përkthehej *shpirtra që veprojnë*, pra që ndihmonin priftërinjtë lenitë gjatë ofrimit të tyre në Tempull)? Të gjitha rangjet engjëllore, madje edhe ata më të lartët, kanë përsëri funksion shërbyes, pra Perëndia i **dërgon për shërbesë** (gr. *diakonia*) jo vetëm tek Mesia, por edhe tek njerëz të ndryshëm shpresëtarë, **ata që kanë trashëguar shpëtim**. Prandaj ata nuk mund të krahasohen me madhështinë e Mesisë dhe as nuk mund të flitet për ta me një gjuhë aq të lartë. Kështu, Mesia nuk mund të jetë kurrsesi një prej tyre.

**2.2. Fjala e Birit është më e lartë se urdhri që u dha me anë të engjëjve (2:1-4)**

- 1 Prandaj duhet ne më tepër t'ua vëmë veshin atyre që dëgjuam, se mos shkasim ndonjëherë.
- 2 Sepse nëse doli e vërtetë fjala që u fol me anë të engjëjve, edhe çdo shkelje e mosdëgjim mori shpagim të drejtë,
- 3 atëherë si do të shpëtojmë ne, në e lëmë pas dore një shpëtim kaq të madh? i cili, pasi zuri të flitet prej Zotit, u vërtetua ndër ne prej atyre që e dëgjuan.
- 4 Edhe Perëndia dëshmonte me shenja e me çudira, e me çdo lloj fuqish, edhe me ndarje *dhuratash* të Frymës së Shenjtë, sipas vullnetit të tij.

Për shkak të epërsisë së pakrahasueshme të Krishtit ndaj engjëjve **duhet ne më tepër t'ua vëmë veshin atyre që dëgjuam, se mos shkasim.** Ky fragment i adresohet të krishterëve me origjinë hebraike, të cilët nuk vigjilonin për gjendjen e shpirtit të tyre, pasi mendonin se vetëm origjina i mjaftonte për të shpëtuar. Autori i letrës, duke i qortuar për qëndrimin e tyre dhe mpirjen shpirtërore, i paralajmëron se nëse shkisnin nga mësimi i Krishtit dhe largoheshin prej Tij, do të gjykoheshin si shkelës të besës.

Në vargun e dytë kemi një krahasim dhe pranëvënie të Dhiatës së Vjetër dhe të Re. Në Dhiatën e Vjetër, fjala e Perëndisë, që u fol me anë të engjëjve, doli e vërtetë dhe e pandryshueshme. Nëse dikush “kryen një mëkat me qëllim” (Num. 15:30), duke shkelur kështu besëlidhjen, “do të shfaroset në mes të popullit të tij”. Kështu, çdo shkelje e mosdëgjim mori shpagim të drejtë, dhe nuk kishte aspak mëshirë për të pabesët. Nëse në Dhiatë e Vjetër apostazia (mohimi i besimit) dënohej kaq rëndë, sa më shumë do duhet të dënohet në Dhiatën e Re të Shpëtimtarit? Si do të mund të shpëtojë kushdo që lexon Shkrimin dhe ka njohuri, nëse e lë pas dore një shpëtim kaq të madh, duke u larguar nga Krishti? Arsyeja e pranëvënies së dy Dhiatave ka për qëllim të tregojë epërsinë e Dhiatës së Re më Krishtin dhe për pasojë, të tregojë se sa më tepër gjykohet apostazia në këtë Dhiatë.

Siç përmendëm dhe më lart, Dhiata e Vjetër cilësohet si “**fjala që u fol me anë të engjëjve**”. Pra, Perëndia veproi nëpërmjet engjëjve, për t'i dhënë Besëlidhjen popullit të Tij të zgjedhur. Tek Ligji i Përtërirë (33:2; LXX) përshkruhet dhënia e Ligjit në malin Sinai: “Zoti erdhi nga Sinai...nga mesi i një morie shenjtorësh, nga e djathta qëndronin engjëjt e Tij”. Këtij vargu i referohen dhe shumë citime të Dhiatës së Re, ku Ligji përshkruhet si “i marrë prej porosive të engjëjve” (Vep. Ap. 7:53; Gal. 3:19). Asokohe nuk iu dha njerëzve të dëgjonin drejtpërsëdrejti zërin e Zotit, por iu fol nëpërmjet engjëjve. Ashtu si Moisiu arriti që të shihte Perëndinë e të mos vdiste, por mbajti vetëm shkëlqimin e lavdisë së Tij në fytyrë (Eks. 33:20-23), ashtu edhe njerëzit nuk mund ta dëgjonin zërin e Tij. Fakti se Perëndia veproi nëpërmjet

engjëjve, nuk nënkupton se Ai vetë nuk ishte i përfshirë në këtë vepër, apo se përdori engjëjt thjesht si përçues, përkundrazi, ishte prezent në Malin Sina por si Epifani (shfaqje që lartazi) dhe jo në plotësinë e pranisë së Tij. Edhe në kohën që jetojmë sot, Zoti vazhdon të mbetet "i fshehur" (Is. 45:15), sepse natyra jonë njerëzore nuk mund të qëndrojë dot në praninë e Tij të plotë e të zbuluar.

Dhiata e Vjetër është vërtet mahnitëse, por e Reja tejkalon çdo kufi. Në këtë të fundit, fjala **zuri të flitet prej vetë Zotit**, e jo më prej engjëjve, dhe **u vërtetua ndër ne**, në çdo të krishterë, që nga dita e Pentikostisë (Rrëshajëve), prej apostujve, **atyre që e dëgjuan** të flitet nga vetë Krishti. Për më tepër, edhe Perëndia dëshmonte për hyjnishmërinë e Fjalës së Krishtit, **me shenja e me çudira e me çdo lloj fuqish**, duke ndarë **dhuratat e Frymës së Shenjtë, sipas vullnetit të Tij**, qofshin këto profeci, gjuhë të huaja, apo njohuri. Të gjitha këto dëshmojnë për origjinën hyjnore të Shkrimeve. Ligji u dha nëpërmjet engjëjve, ndërsa Ungjilli - nga vetë Perëndia. Prandaj edhe çdo shkelje do të tërhiqte mbi shkelësit zemërimin e drejtë të Tij.

### **2.3. Krishti i bërë pakgjë më i ulët nga engjëjt, për të pësuar si Kryepriфт i madh (2:5-18)**

**5 Sepse nuk e vuri nën pushtetin e engjëjve botën që ka për të ardhur, për të cilën po flasim.**

**6 Edhe dikush dëshmoi diku, duke thënë: "Ç'është njeriu, që ta kujtosh? Apo i biri i njeriut që ta vështosh?"**

**7 E bërë pakgjë më të ulët nga engjëjt; me lavdi e me nder e kurorëzove atë, dhe e vure përmbi punët e duarve të tua.**

**8 Të gjitha i vure nën këmbët e tij", sepse pasi i vuri të gjitha nën pushtetin e tij, nuk la asgjë pa vënë nën pushtetin e tij. Po tani nuk i shohim ende të gjitha të jenë vënë nën pushtetin e tij.**

**9 Por e shohim Jisuin që qe bërë pakgjë më i ulët nga engjëjt, për shkak të pësimin të vdekjes, të kurorëzuar me lavdi e me nder, që me hirin e Perëndisë të provonte vdekjen për çdo njeri.**

Pasi është dëshmuar qartë për epërsinë e Krishtit ndaj engjëjve (dhe për pasojë, për epërsinë e Dhiatës së Tij krahasuar me Ligjin, që u dha nëpërmjet engjëjve), autori vijon duke shpjeguar se si ndodhi që Krishti të bëhej pak më i ulët se ata. Sepse si do



të mundej një që qëndronte më lart se ata, të poshtërohej e të vuante një vdekje të tillë?

Autori e nis fragmentin duke shkruar se bota që ka për të ardhur është nën pushtetin e Jisuit, pikërisht sepse denjësoi të merrte natyrë njerëzore - më të ulët se ajo e engjëjve. Në Shkrime thuhet se **bota** dhe gjithçka që ndodhet në të, është vënë jo në pushtetin e engjëjve, por të njeriut. Dikush dëshmoi për këtë diku (Ps. 8:4-6; LXX), duke iu referuar dinjitetit të natyrës njerëzore: **“Ç’është njeriu, që ta kujtosh? Apo i biri i njeriut që ta vështrosh me mëshirë? E bëre pakgjë më të ulët nga engjëjt; Me lavdi e me nder e kurorëzove atë; Të gjitha i vure nën këmbët e tij.”** (Autorësia e këtyre fjalëve është lënë anonim, prandaj edhe thuhet **“dikush diku”**, sepse rëndësi nuk ka personi që i foli, por Perëndia që vuri fjalët në gojë të tij). Në kontekstin e tij origjinal, Psalmi është një lloj meditimi mbi privilegjin e lartë që iu dha gjinisë njerëzore nga Perëndia, të cilët bashkëndanin me Të pushtetin mbi këtë botë, duke u bërë pak më të ulët se Ai vetë. Në tekstin hebraik thuhet “më të ulët se Elohim-i”, emri me të cilin ata i referoheshin zakonisht Perëndisë. Por fjala e përdorur është në fakt në numrin shumë “perënditë”, që në Septuagintë është përkthyer “engjëjt” (*gr. aggelous*). Nuk bëhet fjalë për ndonjë ndryshim rrënjësor, pasi thelbi mbetet i njëjtë: natyra njerëzore u lartësua dhe u bë **pakgjë më e ulët** se ajo hyjnore.

Megjithatë, autori i kësaj letre i kushton një rëndësi të veçantë këtij ndryshimi, pasi e nxit të pohojë se Jisui nuk e uli veten pak më poshtë se Perëndia, por edhe se engjëjt, duke marrë natyrën tonë. Jo vetëm kaq, por si një Adam i dytë, Ai u bë kreu i gjinisë njerëzore. Në librin e Gjenezës (1:28), Zoti premtoi se e gjithë bota e krijuar do t’i nënshtrohej njeriut, i cili do të sundonte mbi të. I njëjti premtim përsëritet dhe konfirmohet përsëri edhe në Psalmin 8, dhe përmbushet në personin e Jisu Krishtit. Vetëm në Krishtin mundet dikush të arrijë qëllimin e tij të vërtetë, dhe të gëzojë pushtet mbi dhé, atë që i ishte dhënë që prej fillimit.

Psalmi në fjalë nuk i referohet vetëm gjinisë njerëzore, por edhe Krishtit në veçanti. Ai është me të vërtetë Biri i Njeriut dhe në Të, natyra njerëzore gjen shprehjen e saj të vërtetë e të përsosur. Fjalët e psalmistit, sipas të cilave **njeriu u kurorëzua me lavdi e me nder**, gjejnë gjithashtu përmbushje në personin e Krishtit, në lavdinë dhe madhësitinë e Tij hyjnore. Ai mbretëron përjetë nga froni qiellor, edhe e gjithë bota është vënë në këmbët e Tij. Autori thekson autoritetin e plotë të Jisuit - duke i vënë **të gjitha nën këmbët e tij** (të njeriut - pra të Jisuit) , Perëndia **nuk la asgjë pa vënë në pushtetin e tij**, përfshirë këtu edhe engjëjt.

Megjithatë, autori shton se **tani nuk i shohim të gjitha të jenë vënë nën pushtetin e tij**. Kjo do të thotë se sovraniteti dhe lavdia e njeriut ende nuk është zbuluar plotësisht. Ka ende shumë gjëra të cilat e pengojnë, duke e mbajtur njeriun të

mbërthyer në frikëra dhe skllavëri, dhe nuk bëhet fjalë vetëm për kafshët e egra apo fenomenet natyrore, por mbi të gjitha për vdekjen. Në të njëjtën mënyrë, nuk arrijmë të dallojmë dot lavdinë, nderin dhe madhësinë e plotë të Birit, Kreut dhe Mbretit të gjinisë njerëzore. Kur Jisui erdhi në botë si njeri, ai u vesh me përulësinë dhe dobësinë e natyrës sonë, duke u ekspozuar edhe ndaj pësimit të vdekjes, ashtu si ne. Vërtet nuk arrijmë ta shohim Jisuin me të gjithë lavdinë e Tij, por **e shohim Jisuin që qe bërë pakgjë më i ulët nga engjëjt.**

Pra përulësia që Ai mori mbi vete nuk duhet të shihet si ndonjë pengesë. Lavdia e Mesisë do të shkëlqente dhe Ai do të lartësohej përmbi të gjithë engjëjt.

Padyshim, këtë status e gëzonte edhe Jisui si njeri, por Atij i duhej të ulej për pak kohë, që të mund të përjetonte pësimet e vdekjes për hatrin tonë, **që me hirin e Perëndisë të provonte vdekjen për çdo njeri.** Nuk do të mund t'i përjetonte dot vuajtjet njerëzore nëse do të vazhdonte të ruante vetëm natyrën e Tij Hyjnore. Mishërimi i Birit të Perëndisë ishte i domosdoshëm për shpëtimin tonë. Kjo përlujë e tejskajshme ishte e përkohshme, dhe do të pasohej nga madhësimi i Tij, ku do të **kurorëzohej me lavdi e me nder** për hir të përulësisë që tregoi, e do të ulej në të djathtë të Atit, duke përmbushur kështu profecinë e Psalmi 8 për Birin e Njeriut.

**10 Sepse i duhej atij, për të cilin janë të gjitha dhe me anë të të cilit janë të gjitha, duke prurë shumë bij në lavdi, të bëjë të përsosur me anë të pësimeve kryetarin e shpëtimit të tyre.**

I duhej Perëndisë Atë, **për të cilin janë të gjitha dhe me anë të të cilit janë të gjitha,** ta bënte Birin e Tij Hyjnor më të ulët se engjëjt. Ati ka pushtet mbi të gjithë krijesën e Tij dhe mund t'i bëjë të gjitha gjërat të ecin sipas vullnetit të Tij, madje edhe poshtërimin e Jisuit. Nuk ishte i paqëllimshëm fakti që e bëri Krishtin të përsosur me anë të pësimeve, megjithëse shumë judenj mendonin se nuk ishte aspak e përshtatshme që Mesia të vuante. Por përkundrazi, Ai është kryetari (*gr. arxigos*) i shpëtimit të njerëzve, ai që përgatiti udhën e shpëtimit. (Fjala greke *arxigos* nuk ka vetëm kuptimin e kryetarit, por edhe të atij që vjen i pari dhe që u jep shtysë të tjerëve.) Bijve të Tij të shumtë do t'u duhet gjithashtu të ndjekin rrugën e vuajtjes nëse do të duan të hyjnë në lavdi. Nuk ekziston asnjë mënyrë tjetër.

Nevojitet të themi diçka edhe për nocionin se Biri nevojitej të përsosej. Në shqip kjo frazë kuptohet sikur Ai është akoma i papërsosur, e për pasojë i paplotë dhe difektoz. Mirëpo fjala greke e përdorur në Shkrimin origjinal "*teleio*" nuk mbart të njëjtin konotacion. Nëse do të përkthehej fjalë për fjalë do të ishte "*fundit pikësynimi*",

që në këtë kontekst do të thotë se Jisui e përmbushi qëllimin e Tij final nëpërmjet vuajtjeve dhe pësimit.

**11 Meqenëse edhe ai që shenjtëron edhe ata që shenjtërohen janë të gjithë prej njërit, shkak për të cilin nuk turpërohet t'i quajë ata vëllezër,**

**12 duke thënë: "Do t'u rrëfej emrin tënd vëllezërve të mi, në mes të kishës do të të lavdëroj".**

**13 Edhe prapë: "Unë do të kem shpresën time në atë"; dhe përsëri: "Ja unë, dhe djemtë që më dha Perëndia".**

**Ai që shenjtëron (Krishti) dhe ata që shenjtërohen (të Krishterët) kanë të njëjtin burim, Atin.** Jisui e shikon Atin si të bashkëpërjetshëm me Të, ndërsa për ne njerëzit, Ati është Mbreti i të gjithave.

Si zakonisht, autori e mbështet pohimin e tij mbi një sërë citimesh nga Shkrimi i Shenjtë. Në Psalmin 22:22, psalmisti shkruan: **"Do t'u rrëfej emrin tënd vëllezërve të mi, në mes të kishës do të të lavdëroj."** Psalmi në fjalë është mesianik (që profetizon për Mesinë). Në të profetizohen jo vetëm vuajtjet e Krishtit (duke nisur nga ofshama e Tij mbi kryq: "Perëndia im, Perëndia im, pse më ke braktisur?", duke vijuar me shpimet e duarve dhe të këmbëve dhe shortin që hodhën për rrobat e Tij), por flitet gjithashtu edhe për një kohë, kur "të gjitha skajet e tokës do ta mbajnë mend Zotin dhe do të kthehen tek ai" (v. 27). Në vargun e cituar në këtë fragment, psalmisti flet për shpalljen e emrit të Perëndisë dhe të veprave të Tij ndër vëllezërit, bijtë e Izraelit. Shkruan se **do ta lavdërojë** me himne, bashkë me të gjithë shpresëtarët që do ta himnojmë **në mes të kishës** (*gr. eklisia*), vendit solemn të adhurimit. Kështu, Mesia portretizohet si pjesëtar i popullit shpresëtar të Izraelit, në solidaritet të plotë me bijtë e njerëzve. Kjo do të thotë se, duke marrë natyrë njerëzore në Mishërimin e Tij, Ai sikurse të gjithë njerëzit kanë të njëjtin burim - Atin, dhe ashtu si ne, u bë më i ulët se engjëjt.

Autori citon dhe dy pjesë të tjera nga Shkrimi i Shenjtë: **"Unë do të kem shpresën time në atë"** (Is. 8:17) dhe citimin që pason: **"Ja unë dhe djemtë që më dha Perëndia"**. Edhe në këtë rast dallohet njëfarë ndryshimi mes Septuagintës dhe versionit Hebraik. Në Septuagintë, përpara këtyre dy citimeve shkruhet: "Dhe ai do të thotë...", pra i paraqet dy citimet si të thëna nga një person i caktuar. Meqenëse ato janë pjesë e një profecie Mesianike (të paraprirë nga profecia për të virgjërën që do të mbarsej tek 7:14 dhe e ndjekur nga profecia për Foshnjën që do të lindte tek 9:6), kuptohet se "personi" i cili flet është vetë Mesia, "shenja dhe parashikuesi në Izrael" (8:18).

Sipas këtij interpretimi, është pikërisht Mesia që shprehet se do ta ketë shpresën tek Perëndia, duke pritur drejtësimin prej Tij. Duke theksuar këtë pjesë, autori i letrës kërkon të vërë në dukje natyrën njerëzore të Mesisë, i Cili, sikurse të gjithë ne, ngre sytë drejt Perëndisë dhe pret ndihmë prej Tij.

Kjo tregohet edhe më tepër në pjesën e fundit, të cituar nga Isaia. **Bijtë** që i janë dhënë Mesisë nga Perëndia janë pikërisht dishepujt e Tij. Mënyra e të shprehurit kërkon përsëri të dëshmojë natyrën e njëjtë të Jisuit dhe të dishepujve. Citimi nga Shkrimi i Shenjtë e përforcon edhe më tepër këtë pohim.

**14 Edhe meqenëse djemtë kanë marrë pjesë prej mishi e gjaku, edhe ai gjithashtu u bë pjesëtar në po ato gjëra, që të prishë me anë të vdekjes atë që ka pushtetin e vdekjes, domethënë djallin,**

**15 edhe të shpëtojë të gjithë ata, të cilët nga frika e vdekjes ishin gjithë jetën e tyre mbajtur në skllavëri.**

**16 Sepse me të vërtetë nuk u ndihmon engjëjve, po farës së Abrahamit i ndihmon.**

**17 Prandaj duhej t'u ngjante në gjithçka vëllezërve, që të bëhej kryepriift i dhembshur dhe besnik në punët që kanë të bëjnë me Perëndinë, për shlyerjen e mëkateve të popullit.**

**18 Sepse me atë që pësoi vetë kur u nga, mund t'u ndihmojë atyre që ngiten.**

Edhe në këtë fragment, autori vazhdon të tregojë se përse duhej Mesia të bëhej më i ulët se engjëjt. Dishepujt ose **djemtë** e Tij **kanë marrë pjesë prej mishi e gjaku**, si të gjithë ne, që jetojmë një jetë në dobësi dhe vdekshmëri. Kështu, për të triumfuar mbi vdekjen, Atij i duhej gjithashtu të bëhej pjesëtar në po ato gjëra, duke marrë mbi vete natyrën tonë.

Nuk kishte asnjë mënyrë tjetër. Vetëm me anë të vdekjes, Krishti do të prishte **atë që ka pushtetin e vdekjes, domethënë djallin**. Ashtu si Kisha Orthodhokse psal në Troparin e Ngjalljes, Krishti “shkeli vdekjen me vdekje”, shfuqizoi plotësisht armikun dhe na shpëtoi të gjithë ne, të cilët nga frika e vdekjes ishim të gjithë jetën të mbajtur në skllavëri. Përpara ardhjes së Shpëtimtarit, vdekja kishte pushtet të plotë mbi të gjithë gjininë njerëzore, dhe të gjithë i trembeshin faktit se nuk do të mund të shpëtonin dot prej saj. Por tani jo më. Krishti na çliroi nga kthetrat e vdekjes ne që ishim skllavër të saj, e na bëri bij të Tij të lirë.

Kjo është arsyeja se përse Atij i duhej të ulte veten e të vuante e të vdiste me vdekje poshtëruese. Sepse me të vërtetë Jisui **nuk u ndihmon engjëjve**, duke i kapur prej

dore e duke i tërhequr nga humnera, por **u ndihmon farës së Abrahamit**, gjinisë njerëzore. Nëse qëllimi i Tij do të kishte qenë të shpëtonte engjëjt, nuk do të ishte dashur të mishërohej e të bëhej më i ulët se ata për nga natyra. Por meqë nuk erdhi për këtë, mori natyrën tonë njerëzore që **t'u ngjante në gjithçka vëllezërve**.

Kjo ishte edhe esenca e Kryepriфтërisë së Tij.

Ashtu sikurse kryepriфтërinjtë e Tempullit ishin në solidaritet me ata për të cilët ofronin therore, edhe Jisui **do të bëhej kryepriфт i dhembshur dhe besnik në punët që kanë të bëjnë me Perëndinë** (që do të thotë, për të bërë shlyerjen e mëkateve të popullit), pra duke u njësuar me ne, me natyrën dhe jetën tonë.

I përjetoi të gjitha aspektet e jetës njerëzore, qoftë vuajtjen, përlësinë, dobësinë etj., **sepse me atë që pësoi vetë kur u nga, mund t'u ndihmojë atyre që ngiten**. Ai e di shumë mirë se ç' do të thotë të vuash, prandaj mund të udhëheqë e të fuqizojë edhe të tjerët që mundohen. Etërit thonë se vetëm ajo çka është marrë përsipër, mund të shpëtohet, prandaj Krishti mori mbi vete natyrën tonë njerëzore, që i gjithë njerëzimi të mund të shpëtohej prej Tij.

**III**  
**KRISHTI, KRYEPRIFTI YNË**  
**(3:1 - 10:18)**

Duke nisur që nga ky paragraf e duke vazhduar deri tek 10:18 shohim të shpaloset thelbi i mendimit dhe mësimit të autorit. Ai dëshmon se Krishti është Kryepriifti ynë i lartë i qiejve, dhe do të vliente çdo sakrificë e lexuesve të kësaj letre, për t'i besuar Atij. Besnikëria ndaj Krishtit mund të kishte një çmim shumë të lartë për të krishterët hebrej që vazhdonin të jetonin në komunitete judaike, madje mund të arrinte deri aty sa të mos i lejonin të sakrifikonin më në Tempull. Megjithatë, nuk duhej të hiqnin dorë prej Tij çfarëdo që të ndodhte, pasi Ai kishte një Kryepriiftëri të lartë, shumë më të lartë sesa ajo e Tempullit. Sakrifika më sublime e Krishtit, që iu ofrohet të krishterëve në çdo kremtim të Falënderimit Hyjnor i tejkalon të gjitha theroret e Tempullit. Prandaj autori i bën thirrje të vazhdueshme popullit shpresëtar, që të mos e braktisin Kryepriiftin e tyre të përjetshëm dhe Hyjnor për priiftërinjtë e vdekshëm dhe njerëzorë, dhe as të humbnin të Vërtetën e gjallë duke rendur pas profecive të mjegullta.

**3.1. Krishti qëndron më lart se Moisiu (3:1-6)**

- 1 Prandaj, vëllezër shenjtorë, pjesëtarë të thirrjes qiellore, vështroni apostullin dhe kryepriiftin e rrëfimit tonë, Jisu Krishtin;**
- 2 i cili është besnik tek ai që e bëri, sikurse dhe Moisiu *qe besnik në gjithë shtëpinë e tij.***
- 3 Sepse ky u denjësu me më tepër lavdi se Moisiu, meqenëse ka më shumë nder ai që ndërton shtëpinë se sa shtëpia.**
- 4 Sepse çdo shtëpi ndërtohet prej dikujt; por ai që i ndërtoi të gjitha *është Perëndia.***
- 5 Edhe Moisiu *qe besnik në gjithë shtëpinë e atij si shërbëtor, për dëshmi të atyre gjërave që do të fliteshin,***
- 6 por Krishti, si bir mbi shtëpinë e tij, shtëpia e të cilit jemi ne, nëse mbajmë fort guximin dhe mburrjen e shpresës deri në fund.**

Meqenëse e përuli veten duke u bërë i ngjashëm me ne në të gjitha (2:17), autori i bën thirrje të gjithëve të **vështrojnë Jisu Krishtin**, të Cilin Ati e dërgoi si **apostull** dhe ambasador për t'u sjellë njerëzve fjalën e Perëndisë, e për t'u bërë **Kryepriifti** i Tij. Nëpërmjet kësaj thirrjeje, autori i fton të gjithë të përqendrohen në Krishtin, Atë që **rrëfyen** dhe njohën gjatë Pagëzimit, pasi në kohën kur u shkrua letra njerëzit po e zhvendosnin themelin e tyre të besës duke harruar se sa i rëndësishëm është Ai për shpëtimin tonë.

Vërejmë se autori i adresohet lexuesve të letrës duke i quajtur **vëllezër shenjtorë**. Përmes Mishërimit, ata ishin bërë të shenjtë dhe **vëllezër** të vetë Krishtit (krahaso me 2:17) dhe përmes Pagëzimit ishin bërë **pjesëtarë të thirrjes qiellore**.

Në Pagëzim të gjithë kishin marrë birërinë dhe kishin hyrë në familjen e madhe të Perëndisë në qiejt.

Ndërsa presionet e judenjve përballë të krishterëve sa vinin e rriteshin, aq më i lartë ishte rreziku që këta të fundit të harronin se sa thelbësor është Krishti për shpëtimin hyjnor. Për të shmangur këtë, autori i kujton lexuesve epërsinë e Jisuit ndaj Moisiut, dhe për pasojë, epërsinë e Krishterimit ndaj besimit judaik të trashëguar nga paraardhësit e tyre.

Nuk mund të mohohet kurrsesi e as të ulet rëndësia e **Moisiut**. Ai **qe besnik** ndaj Zotit **në të gjithë shtëpinë e tij**, duke iu bindur në gjithçka që e urdhëroi. Megjithatë, ai **qe besnik si një shërbëtor**. (Fjala greke e përdorur për *shërbëtor* është *therapon*, që fjalë për fjalë do të thotë "*dikush që pret dikë tjetër*" - krahaso të njëjtën fjalë të përdorur si kallëzues tek Vep. Ap. 17:25.)

Shërbimi i Moisiut nuk ishte i përmbushur në vetvete, por një **dëshmi e atyre gjërave që do të fliteshin**, pra si një lloj profecie apo ungjillëzimi paraprak për Krishtin.

Kjo e bën Moisiun të jetë inferior ndaj Jisuit. Nëse ai ishte thjesht në rolin e shërbyesit, Jisui mban statusin e Birit dhe të trashëgimitarit të shtëpisë së Perëndisë. Nëse vërejmë me kujdes, në ndryshim nga Moisiu, për Jisuin nuk thuhet se u vendos **në shtëpinë e Zotit**, por **mbi** atë, si dikush që ka autoritet. Të dy qenë besnikë ndaj Perëndisë dhe përmbushën gjithçka për të cilën ishin thirrur, por Jisui qëndron shumë më lart se Moisiu dhe lavdërohet përmbi të. Epërsia e Tij ndaj Moisiut mund të krahasohet me zotin ndaj skllavit.

Besimtarët judenj mund të pandehnin se Moisiu ishte themeluesi i fesë së tyre (krahaso me farisenjtë që e quanin veten nxënës të tij tek Joani 9:28), prandaj autori rithekson se ishte Perëndia Ai që e themeloi dhe ndërtoi mbi të. Statusi i Moisiut mbetet gjithnjë ai i shërbyesit, kësisoj lavdia nuk i përket atij por Zotit që **i ndërtoi të gjitha**.

Jisui, duke qenë karakter i qenies së Atit (1:3) dhe shkëlqimi i lavdisë së Tij, **u denjësua me më tepër lavdi se Moisiu, meqenëse ka më shumë nder ai që ndërton shtëpinë se sa shtëpia** vetë.

Po çfarë statusi kishin lexuesit, të cilëve u drejtohet letra? Ata, si nxënës të Krishtit (në tekstin grek theksohet përemri vetor “ne”) përbënin shtëpinë që drejtohej nga Jisui dhe ku Moisiu shërbente, ata vetë ishin **shtëpia** dhe familja e Perëndisë.

Mirëpo kjo presupozonte dhe qëndresën e tyre në besim (pikërisht këtu kërkon të përqendrohet autori). E vetmja mënyrë për të ndenjur në shtëpinë e Perëndisë ishte **të mbanin fort guximin** më Zotin si bij të Tij të bindur dhe të krishterë të palëkundur, duke u mburrur si trashëgimtarë të Mbretërisë së Perëndisë, me shpresën në Krishtin Jisu. Nuk mjaftonte thjesht të ishin judenj të mirë. Nevojitej të themeloheshin më Krishtin, si nxënës të Tij të denjë.

Autori i kushton një rëndësi të veçantë epërsisë së Krishtit ndaj Moisiut, që për ne të krishterët sot tingëllon krejt e natyrshme, pasi njohim Traditën Apostolike të Kishës, ndryshe nga judenjtë e shek. I. Asokohe Moisiu konsiderohej më i lartë se njerëzit e tjerë, deri diku si një mbinjeri. Ai njihnte matematikën, gjeometrinë, astronominë, mjekësinë dhe muzikën e Egjiptit, gjithashtu dinte si të ndërtonte varka dhe makineri për ndërtim apo për luftë. Mendohej se kishte mësuar Orfeun e Greqisë dhe Hermesin e Egjiptit. Disa mendonin se luftoi me armiqtë e Egjiptit dhe qyteti i Hermopolit u themelua në shenjë përkujtimi të fitores së tij. Vetëm me një fjalë arriti të heqë qafe egjiptasin që sulmoi një izraelit. Duke e konsideruar veten nxënës të Moisiut (Jn. 9:28), Judenjtë besonin se po udhëhiqeshin nga njeriu më i madh që kishte ekzistuar ndonjëherë. Prandaj nuk ishte e lehtë për ta të kuptonin se lavdia e Krishtit e tejkalonte pafundësisht atë të Moisiut. Për ta, Ligji ishte zbulesa më e madhe e Perëndisë mbi dhé, prandaj kishin një ide kaq të lartë për Moisiun, dhënësin e Ligjit. Prandaj autori thekson se Krishti qëndronte më lart se çdokush dhe çdo gjë që kishin njohur deri në atë kohë, dhe autoriteti i Tij tejkalon edhe autoritetet më të larta të kësaj bote.

### 3.2. Vigjilencë që të mos largoheni nga prehja e Krishtit (3:7 - 4:13)

**7 Prandaj, siç thotë Fryma e Shenjtë: "Sot në dëgjofsh zërin e atij,**

**8 mos i ngurtësoni zemrat tuaja si në hidhërimin, në ditën e ngasjes në shkretëtirë,**



9 ku etërit tuaj më nganë dhe më vunë në provë, edhe panë punët e mia dyzet vjet.

10 Prandaj u zemërova me atë brez, edhe thashë: Përherë gënjehen në zemrën e tyre; edhe ata nuk i njohën udhët e mia.

11 Prandaj u betova në zemërimin tim: S'kanë për të hyrë në prehjen time".

12 Vështroni, vëllezër, që të mos ketë asnjë prej jush zemër të ligë pabesie, që të ngrejë krye kundër Perëndisë së gjallë.

13 Po nxitni njëri-tjetrin përditë, deri sa quhet "Sot"; që të mos ngurtësohet ndonjë prej jush me gënjeshtren e mëkatit.

Meqë shpërblimi është fryt i qëndrueshmërisë, autori i këshillon lexuesit të vigjilojnë mbi shpirtrat e tyre, që të mos largohen nga shpresa e **të ngrenë krye kundër Perëndisë së gjallë** (v.12). Një tundim që ata hasnin asokohe ishte mendimi se mund të besonin në Perëndinë e gjallë por duke mbetur ende në judaizëm. Prandaj shkruesi i letrës i kujton se largimi nga Jisu Krishti është braktisje e Perëndisë. Nuk duhet ta lejonin që kjo **zemër e ligë dhe pabesie** të hidhte rrënjë brenda tyre. Disa prej tyre kishin filluar ta lejonin një mendim të tillë negativ, duke braktisur edhe mbledhjen adhuruese të përbashkët të Dielave (10:25). Nevojitej të largoheshin të gjithë menjëherë nga ky mendim.

Për t'i dhënë zemër, autori i fton të **nxitin** njëri-tjetrin **përditë, derisa quhet "Sot"**. Nuk shkonte që të jetonin të izoluar nga vëllazëria e tyre e krishterë, duke u mbyllur në ndarje të vogla dhe duke u treguar indiferentë ndaj vështirësive të vëllezërve. Përkundrazi, ata duhet të përkujdeseshin për njëri-tjetrin, për të **mos u ngurtësuar nga gënjeshttra e mëkatit**. Mëkati mund t'i ngacmonte me mendime se largimi nga Jisui nuk do të kishte pasoja fatale, por ky ishte veçse një mashtrim. Prandaj duhet të ishin përherë vigjilentë ndaj gënjeshtrave të tilla e të mos praninin as t'i dëgjonin.

Ku mund të gjenin mbështetje dhe inkurajim? Duke marrë pjesë në kremtimin e Eukaristisë (Falënderimit) Hyjnore të Dielave. Kështu, jo vetëm do të merrnin zemër duke dëgjuar histori të ndryshme të Jisuit (të cilat fillimisht tregoheshin gojarisht dhe më pas u mblodhën dhe u shkruan në Ungjijtë), por edhe do të mund të merrnin porosi nga mësues dhe etër të krishterë, të cilat do t'i ndihmonin në përbashkëtimin e vështirësive të tyre. Për më tepër, vetëm ideja e mbledhjeve të përbashkëta përbente një mbështetje të paçmueshme për vëllazërinë. Mjaftonte prezenca e njërit për t'u bërë mësim për të tjerët.

Ndërkohë që i nxit vëllezërit me fjalë në qëndrueshmëri, autori citon edhe pjesë të ndryshme nga Shkrimet, duke mbajtur kështu Traditën Judaikë. Pjesa e cituar është

marrë këtë herë nga psalmi 95:7-11 (LXX). Duke qenë pjesë e Shkrimit, vargu në fjalë konsiderohet i frymëzuar prej **Frymës së Shenjtë**. Fjalët e psalmisti lidhen në mënyrë profetike me situatën e mundimshme që po kalonin të krishterët asokohe.

Në kontekstin origjinal, psalmi u shkrua për të nxitur popullin e Izraelit që t'i bindej Perëndisë e të dëgjonte **zërin e Tij** (të gjendur në urdhëresat e Ligjit), duke **mos i ngurtësuar zemrat**, siç bënë dikur etërit e tyre. Koha të cilës i referohet psalmisti është periudha e quajtur "**hidhërimi**" (gr. *parapikrasmos*, e formuar nga fjala *pikros* - e hidhur), gjatë kohës së profetit Moisi.

Gjatë kohës që populli i Izraelit endej në shkretëtirë, përpara se të hynin në **prehje** në Tokën e Premtuar, ngritën krye kundër Zotit, duke e **ngarë** e duke e **vënë** Atë në **provë**. Nuk i besuan Perëndisë, por e tunduan duke i kërkuar t'i siguronte ujë në shkretëtirë, madje ishin gati të qëllonin Moisiun me gurë e të ktheheshin në robërinë e Egjiptit (Eks. 17:1-7). Ç'është më e keqja, ky nuk qe i vetmi rast që ata u rebeluan. Në vazhdim të udhëtimit në shkretëtirë ishin gati ta mohonin shpëtimin e tyre e të ktheheshin në Egjipt, përsëri për shkak të mungesës së ujit (Num. 20:1-13). Prandaj Perëndia **u zemërua me këtë brez** dhe u hidhërua fort me ta. Për **dyzet vjet** me radhë kishin parë **punët** e Tij të mrekullueshme dhe nuk u kishte munguar kurrë përkujdesja, dhe përsëri ngritën krye kundër dashurisë së Perëndisë. Duke folur me zërin e Zotit, psalmisti deklaroi se ata nuk do të kishin vend në prehjen e Tij, nuk do të mund të shijonin ëmbëlsinë e Tokës së Premtuar, por do të jepnin shpirt në shkretëtirë.

**14 Sepse jemi bërë pjesëtarë të Krishtit, nëse mbajmë fort deri në fund besimin e fillimit,**

**15 kur thuhet: "Sot, në dëgjofsh zërin e tij, mos i ashpëroni zemrat tuaja si në hidhërimin".**

**16 Sepse, cilët, pasi dëgjuan, ngritën krye? A nuk ishin të gjithë ata që dolën prej Egjiptit me anë të Moisiut?**

**17 Edhe me cilët u zemërua dyzet vjet? Vallë jo me ata që mëkatuan, të cilëve u ranë eshtrat në shkretëtirë?**

**18 Edhe për cilët u betua se nuk do të hynin në prehjen e atij, veç se për ata që s'bindeshin?**

**19 Edhe shohim se për pabesinë nuk mundën të hyjnë.**

Autori i referohet kësaj pjese nga Shkrimet, pasi përputhet edhe me situatën aktuale të lexuesve të tij. Ata ishin shpëtuar nëpërmjet Pagëzimit, duke u bërë **pjesëtarë të Krishtit**. Mirëpo u nevojitej patjetër të mbanin fort deri në fund

besimin e fillimit, pa të cilin nuk do të kishin asnjë apologji në Ditën e Gjyqit të Madh. Nuk mund t'ia lejonin vetes kurrresi të largoheshin nga Krishti, duke u zhytur përsëri në Judaizëm. Zëri i psalmisti, i cili jehon pareshtur në veshët e gjithsecilit, u kujton të qëndrojnë të palëkundur në besë: **"Sot, në dëgjofsh zërin e tij, mos i ashpërsoni zemrat tuaja si në hidhërimin"**.

Situata e hebrenjve të krishterë, të cilëve u drejtohet letra, është e ngjashme me izraelitët e çliruar nga skllavëria, e përshkruar në Psalmin 95. Ndër të gjithë judenjtë e tjerë, ata ishin me të vërtetë populli i zgjedhur i Perëndisë, sikurse edhe paraardhësit e tyre, të cilët u çliruan nga robëria e Faraonit. Njësoj si këta të fundit, edhe hebrenjtë e krishterë ishin thirrur të qëndronin deri në fund në besëlidhjen e tyre me Zotin, gjë që nuk e realizuan.

**Sepse cilët, pasi dëgjuan zërin e Zotit në malin Sina, ngritën krye duke shkaktuar hidhërimin e Tij? Ishin pikërisht të gjithë ata që dolën prej Egjiptit me anë të Moisiut dhe që panë shpëtimin,** një shpëtim kaq madhështor saqë do të mbahej mend përjetë. Kjo gjë dëshmon se nuk mjafton thjesht të shpëtosh, nevojitet edhe të qenët i qëndrueshëm në besim. **Sepse me cilët u zemërua Perëndia për dyzet vjet? Vallë jo me ata që mëkatuan** e që ngritën krye kundër Tij, duke e braktisur? Prandaj qëndrueshmëria është kusht i domosdoshëm, sepse mëkati i rëndë i apostazisë sjell zemërimin e drejtë të Perëndisë. Nëse do të mëkatonim ndaj Zotit duke e braktisur Krishtin, nuk do të shpëtonim dot nga i njëjti zemërim sikurse edhe brezat e mëparshëm, **eshtrat e të cilëve ranë në shkretëtirë,** sikurse thuhet: **"Edhe për cilët u betua se nuk do të hynin në prehjen e atij, veç se për ata që s'bindeshin?"** Pra shohim se ishte **pabesia** ajo që i largoi nga prehja e Perëndisë. Nëse hebrenjtë e krishterë do të vepronin si paraardhësit e tyre, duke u larguar nga Krishti, zemërimi i Tij nuk do të ngurronte të binte edhe mbi ta, dhe nuk do të arrinin të hynin në prehjen e përjetshme.

**1 Prandaj, deri sa mbetet ndër ne një premtim për të hyrë në prehjen e atij, le të kemi pra frikë se mos ndonjë prej jush duket se mbeti jashtë.**

**2 Sepse edhe ne jemi ungjillëzuar, sikurse dhe ata; por atyre nuk u bëri dobi fjala që dëgjuan, sepse s'që bashkuar me anë të besimit me ata që e dëgjuan.**

**3 Sepse hymë në prehje ne që besuam, siç ka thënë: "Prandaj u betova në zemërimin tim: S'kanë për të hyrë në prehjen time", ndonëse punët e tij u mbaruan qëkurse u themelua bota.**

**4 Sepse ka thënë në një vend për të shtatën ditë kështu: "Edhe u preh Perëndia në të shtatën ditë nga gjithë punët e tij".**

**5 Edhe në këtë vend përsëri: "S'kanë për të hyrë në prehjen time".**

Në këtë fragment, shkruesi vijon duke cituar vargje nga Psalmi 95. Në të thuhet se ndër ne **mbetet një premtim për të hyrë në prehjen e atij**. Perëndia i foli popullit të tij nëpërmjet zërit të Davidit, duke i ftuar për të hyrë në prehje përmes bindjes. Duke lexuar vargjet e këtij psalmi, lexuesit duhet të vigjilojnë e të qëndrojnë në bindje, për të mos **mbetur jashtë** kësaj prehjeje. Nuk kishte asnjë arsye për t'ia privuar vetes një mundësi të tillë, sepse premtimi i Perëndisë mbetet dhe dera qëndronte e hapur.

Edhe ata ishin ungjillëzuar, sikurse paraardhësit e tyre izraelitë. Megjithatë, këtyre të fundit **nuk u bëri dobi fjala që dëgjuan, sepse s'që bashkuar me anë të besimit**. Vërtet e dëgjuan zërin e Zotit në malin Sina, por nuk e bashkuan me besimin e tyre, në mënyrë që Fjala e Tij t'u gdhendej në zemër. Edhe lexuesit e kësaj letre nuk mbetën pa u ungjillëzuar (folja "*ungjillëzoi*" në greqisht thuhet *evangelizo*, ndërsa emri *Evangelio*, që do të thotë "*Ungjill*").

Në rastin e popullit të hershëm të Izraelit, lajmi i mirë për ta ishte thirrja e Jahvehut për të qenë populli i zgjedhur i Tij, një mbretëri priftërinjsh dhe komb i shenjtë (Eks. 19:6). Për izraelitët të cilëve iu referohet letra, lajmi i mirë ishte thirrja për të ndjekur pas Krishtin, e për të trashëguar Mbretërinë e Tij. Pavarësisht këtij ndryshimi në përmbajtjen e lajmit, të dy ishin të thirrur për të bërë një Besëlidhje me Perëndinë dhe për të hyrë në shpëtim. Lexuesit e krishterë hebrej duhet të kishin kujdes që t'i përgjigjeshin kësaj thirrjeje me besim, që t'u bënte dobi e t'u hapte derën për në prehjen e përjetshme.

Vetëm duke besuar dhe duke qëndruar fort në besë do të mund të hynin në këtë prehje.

Për të përshkruar se si do të ishte në të vërtetë kjo prehje, autori përdor mënyrën klasike interpretimit judaik, duke analizuar vargje të ndryshme nga Shkrimi i Shenjtë. Në Psalmin 95, që trajtuam edhe në fragmentin paraardhës, shkruhet për judenjtë e pabesë që e përjashtuan veten nga prehja e Zotit. Duke mbetur tek fjala *prehje*, autori shpjegon kuptimin e vërtetë që ajo mbart, që është pikërisht prehja apo pushimi i Perëndisë në Ditën e Shtatë, pas gjashtë ditëve të krijimit të botës. Sepse **ka thënë në një vend në Shkrimet** (Gjen. 2:2) se **Perëndia u preh në të shtatën ditë nga gjithë punët e tij**.

Në përfundim të fragmentit, autori shpjegon se kuptimi i citimit të Psalmi 95:11 ("**S'kanë për të hyrë në prehjen time**") ishte pjesëmarrja e njeriut (ende pa rënë në mëkat dhe pa pësuar vdekjen) në prehjen e përjetshme me Zotin, ku Ai pushoi nga punët e Tij dhe e ftoi krijesën e vet në një shoqëri të pandërprerë me Të. Nuk do të kishte asnjë justifikim për judenjtë e pabesë që të mos hynin në këtë prehje, pasi ishin

thirruar në të **qëkurse u themelua bota**, mjaftonte të besonin në Zotin e t'i shërbenin Atij në bindje.

**6 Pasi ka mbetur pra të hyjnë disa veta në atë, edhe ata që u ungjillëzuan më përpara nuk hynë prej mosbindjes së tyre,**

**7 përsëri cakton një ditë: "Sot", duke thënë me anë të Davidit, pas kaq kohe, siç është thënë: "Sot në dëgjofshi zërin e atij, mos i ashpëroni zemrat tuaja".**

**8 Sepse po t'i kishte prehur ata Jisui i Naviut, nuk do të kishte folur pastaj për një tjetër ditë.**

**9 Mbetet pra, prehje për popullin e Perëndisë.**

**10 Sepse ai që hyri në prehjen e tij, edhe ai u preh nga punët e tij, sikurse Perëndia nga të tija.**

Autori vijon përsëri me analizën e Psalmi 95. Perëndia deshi që populli i Izraelit të hyjë në prehjen e përjetshme bashkë me të, dhe ia dha këtë mundësi kujtdo që të dëshironte, për dobinë e tyre. Hebrejtë që jetuan në kohën e Moisiut dhe Jozueut, ata që u ungjillëzuan më përpara se të gjithë të tjerët, **nuk hynë për shkak të mosbindjes**, por mbetën në shkretëtirë pa e prekur dot Tokën e Premtuar (Ligj. Përt. 1:34-35). Megjithatë, përsëri Zoti nuk ngurroi ta ftonte përsëri popullin e Izraelit në shoqërinë e Tij të përjetshme, kështu pra, në kohën e mbretit **David** (të cilit i takon dhe autorësia e Psalmi 95<sup>2</sup>), shumë kohë pas Moisiut dhe Jisuit të Naviut, **caktoi përsëri një ditë** për të hyrë në prehjen e Tij. Kjo ditë është "**sot**", siç është thënë nga mbreti David (dhe përmendur edhe në kapitullin e mëparshëm): "**Sot, në dëgjofshi zërin e tij, mos i ashpëroni zemrat tuaja.**" Zëri i Zotit vazhdonte të thërriste me gojën e Davidit e të ftonte popullin e Tij në prehje.

Sipas disa interpretimeve, "prehja" për të cilën flitet në Psalmin 95 nuk i referohet prehjes së përjetshme më Zotin (atë që i pret të krishterët besëmirë në fund të kohërave, kur të hynë në Mbretërinë e Perëndisë), por thjesht prehjes së përkohshme të izraelitëve në Kanaan. Faktikisht, në kontekstin e Psalmi, kur Perëndia betohet se të pabesët nuk do të kishin vend në prehjen e Tij, nënkupton se nuk do të hynin në Tokën e Premtuar, por do të vdisnin në shkretëtirë. Pavarësisht kontekstit historik, autori i letrës që po analizojmë mbron mendimin se këto fjalë fshehin një interpretim më të thellë. Sipas tij, Perëndia nuk u kufizua vetëm në kuptimin e hyrjes në Kanaan kur foli për prehjen e Tij, as psalmisti kur citoi fjalën e Perëndisë nuk nënkuptoi vetëm Tokën e Premtuar. Fundja, populli arriti të hynte në Tokën e Shenjtë në

---

<sup>2</sup> Kështu dëshmohet në përkthimin e të Shtatëdhjetëve (Septuaginta), ndërsa në versionin hebraik ky fakt nuk përmendet.

udhëheqjen e **Jisuit të Naviut**, dhe nëse psalmisti po i referohej kësaj ngjarjeje historike, **nuk do të kishte folur pastaj për një tjetër ditë**. Përkundrazi, fakti që ai i nxiste judenjtë të hynin në këtë prehje, do të thotë se një gjë e tillë nuk ishte realizuar ende. Për këto arsye, autori e interpreton hyrjen në “prehjen e Perëndisë” si të qenët në përjetësi në shoqërinë e Tij, për të cilën jemi thirrur qëkurse u themelua bota. Gjithashtu edhe hyrja në Kanaan mbart një kuptim më të thellë sesa ai historik, duke iu referuar një gjendje prehjeje dhe paqeje më Zotin jashtë çdo kufizimi kohor.

Autori e mbyll duke shkruar se **mbetet një prehje**, një Shabat shpirtëror **për popullin e Perëndisë** (gr. *savatismos*, që vjen nga folja *savatiso* - mbaj Shabatin). Duke mbajtur të gjallë besimin e tyre më Krishtin deri në fund të jetës, i pret prehja e përjetshme, ku do të pushojnë nga gjithë punët e tyre, **sikurse Perëndia pushoi nga të tijat**, pas gjashtë ditëve të krijimit.

Për judenjtë, Shabati përbënte zemrën e besimit të tyre, një kohë gëzimi dhe afrimi me Perëndinë. Prandaj këtu përmbledhet esenca e kuptimit të Shabatit, një prehje dhe shoqëri e përjetshme me Të, si shpërblim për veprat e mira. Pra, populli i Tij le të ngjitet fort pas besimit, duke fituar kështu prehjen dhe gëzimin e përjetshëm, për të cilin u thirr.

(Vërejmë se autori i referohet mbajtjes së Shabatit shpirtëror deri në përjetësi, dhe jo ndonjë Shabati liturgjik të mbajtur në të shtatën ditë të javës. Që në shekullin e parë, të krishterët hebrenj kishin krijuar traditë e mbledhjeve adhuruese dhe Falënderimit Hyjnor në të parën ditë të javës.)

**11 Le të përpiqemi pra të hyjmë në atë prehje, që të mos bjerë ndonjë në atë shembull të mosbindjes.**

**12 Sepse fjala e Perëndisë është e gjallë dhe vepruese, edhe më e mprehtë se çdo thikë me dy tehe, edhe depërton deri në ndarjen e frymës dhe të shpirtit, të nyjeve e të palcave, edhe gjykon mendimet dhe synimet e zemrës.**

**13 Edhe përpara tij s'ka asnjë krijesë të padukshme, por të gjitha janë lakuriq dhe të zbuluara në sytë e atij, të cilit ne kemi për t'i dhënë llogari.**

Nxitja e autorit përfundon me ton kërcënues. Duhet shumë përpjekje për të hyrë në prehjen e Perëndisë. Fjala “përpiqemi” në greqisht është shkruar *spoudazo*, që ka edhe kuptimin serioz, zelltar apo i dhënë pas diçkaje. Nuk mjafton vetëm të endet dikush drejt shpëtimit pa ndonjë kujdes të madh, përkundrazi, nevojitet përpjekje me mish e me shpirt për ta mbajtur të ndezur zjarrin e besimit. Nëse hebrenjtë e krishterë do ta largonin veten nga Krishti dhe Perëndia i gjallë (3:12), do të binin pa

dyshim, ashtu si dhe paraardhësit e tyre (3:17), duke ndjekur të njëjtin **shembull të mosbindjes**.

Ata duhet ta merrnin seriozisht Perëndinë. Ungjilli të cilit i bindeshin, nuk është ndonjë mësim i parëndësishëm, por **fjala e Perëndisë e gjallë dhe vepruese**, metri i gjykimit të të gjithë atyre që largohen prej tij dhe që e kundërshtojnë. Kjo fjalë është **më e mprehtë se çdo thikë me dy tehe**. Ashtu sikurse një thikë kaq e mprehtë e çan tejprtej trupin e njeriut, edhe Fjala e Ungjillit **depërton deri në ndarjen e frymës dhe të shpirtit, të nyjeve e të palcave**, dhe mund të **gjykojë mendimet dhe synimet e zemrës**.

Do të vijë dita kur Perëndia të gjykojë gjithsecilin që nga thellësitë e shpirtit, duke shqyrtuar jo vetëm veprimet, por edhe qëllimet e zemrave tona. Çdo skutë dhe plasë i shpirtit, çdo arsyetim i nënndërgjegjshëm i veprimeve do të përballet me gjykimin e Perëndisë. Me të vërtetë, **asnjë krijesë** nuk do të jetë **e padukshme** përpara Tij, por **të gjitha** gjërat do të jenë **lakuriq e të zbuluara në sytë e atij, të cilit ne kemi për t'i dhënë llogari** për çdo mëkat të fshehur. Kështu, nëse dikush largohet nga besnikëria ndaj Krishtit, duke marrë udhën e **mosbindjes**, do të bjerë me siguri. Fjala e Ungjillit do t'i gjykojë të gjithë ata që e braktisën me vullnetin e tyre.

### 3.3. Krishti, Kryepriifti ynë (4:14-5:10)

**14 Duke pasur pra një kryepriift të madh që ka përshkuar qiejt, Jisuin, të Birin e Perëndisë, le të mbajmë rrëfimin tonë.**

**15 Se s'kemi kryepriift që të mos mund t'i vijë keq për dobësitë tona, po një që u nga në të gjitha si ne, por pa mëkatuar.**

**16 Le t'i afrohem pra me guxim fronit të hirit, që të marrim përdëllim dhe të gjejmë hir për ndihmë në kohë nevoje.**

Pasi autori ka trajtuar epërsinë e Krishtit ndaj Moisiut dhe rëndësinë e madhe të të qëndruarit besnik ndaj Tij, për të hyrë në prehjen e përjetshme, vijon duke u shpjeguar lexuesve thellësinë dhe lartësinë e pasosur të Kryepriiftërisë së Tij. Kryepriiftëria e Jisuit ka rëndësi thelbësore. Ai është në fakt i vetmi që nevojitet për shpëtimin e shpirtit tanë, dhe përpara Tij shfuqizohet çdo therore apo priiftëri tjetër.

Fragmenti nis me një nxitje për të mbajtur rrëfimin e besës së Krishterë, duke e njohur Jisuin si Mesi. Fjala “mbajtur”, në origjinalin grek është shkruar *kratao*, që mbart edhe kuptimin *mbërthej*. Pra lexuesve iu kërkohet të kapeshin fort pas besimit të tyre tepër të çmuar. Jisui nuk ishte thjesht kryepriifti i tyre, por **kryepriifti i madh që ka përshkuar qiejt** dhe që rri në të djathtë të Atit. Ky fakt dëshmon edhe më tepër për Transhendencën dhe pushtetin e Tij universal. Tashmë ai qëndron larg kësaj bote të vdekshme, mëkatare dhe të dobët (krahaso me 7:26). Megjithatë, ky fakt nuk do të thotë aspak se nuk mund t’i vijë keq për dobësitë tona dhe të mos preokupohet për to. Përkundrazi, pasi edhe Ai vetë kaloi plot vuajtje dhe persekutime, duke u **ngarë në të gjitha gjërat si ne, por pa mëkatuar**. Krishti doli fitimtar ndaj të gjitha vuajtjeve, pa iu dhënë asnjëherë tundimit për të devijuar nga qëllimi i Tij.

Fjala “ngasje” në greqisht është *peirazo*, që ka kuptimin “*tundoj/ testoj/ sprovuj*”. Nuk përdoret vetëm për mëkatën por për të gjitha llojet e sprovave dhe testeve. Në Librin e Urtësisë së Solomonit 3:5 është përdorur për të përshkruar vuajtjet e të drejtëve. Në këtë rast, ka kuptimin e të sprovuarit nëpërmjet vështirësive - megjithëse përfshihet deri diku dhe kuptimi i tundimit për të mëkatuar, si mënyrë për të shmangur vuajtjet.

Meqenëse vetë Krishti provoi shumë vuajtje, mund t’i vijë në ndihmë dhe shërbëtorëve të Tij që vuajnë, prandaj ftohemi të gjithë **t’i afrohemi me guxim fronit të hirit**. Në rastin konkret, të gjithë të krishterët duhet të mblidheshin çdo javë në Mbledhjet Adhuruese, e të kërkonin ndihmën e Perëndisë si një trup i vetëm. (Kjo nënkupton se nuk ishte e udhës të luteshin secili në mënyrë individuale, jashtë Kishës.) Froni i Krishtit është fron hiri, Ai është gjithnjë i gatshëm të ndihmojë të tijtë, t’u japë **përdëllim dhe hir për ndihmë në kohë nevojë**. Ndihma hyjnore vjen gjithmonë, pasi kjo është ajo çka bën një kryepriift, ai u siguron të sprovuarve ndihmën në kohën e volitshme (5:1).

Teksa përshkruan domosdoshmërinë e **afritit me guxim në fronin e hirit**, autori nxjerr në pah një tipar thelbësor të adhurimit të Krishterë - përjasjen me guxim (gr. *paresia*, që nënkupton lirinë në të folur, sigurinë e të qenit i pranuar).

Në ditët e sotme, tingëllon krejt e zakonshme që çdokush të mundet t’u afrohet e të bjerë në kontakt me udhëheqësit e vendit, por kjo as mund të mendohej në kohët e hershme. P.sh. në Persi askush nuk lejohej t’i afrohej fronit pa marrë leje më parë, pasi një gjë e tillë mund të çonte në dënim me vdekje (shiko tek Esteri 4:11). Në të njëjtën mënyrë, as mëkatarët nuk mund të qëndronin përpara Perëndisë apo t’i drejtoheshin Atij aq lehtë dhe familjarisht. Profeti Isaia, i cili u denjësuua të shikonte



Perëndinë nëpërmjet një vegimi, e dinte se ishte i humbur pasi ishte një njeri me buzë të papastra që banonte në mes të një populli me buzë të papastra, megjithëse sytë e tij kishin parë Mbretin, Zotin e ushtrive (Is. 6). E njëjta gjë edhe për ne. Vetë ne, si qenie njerëzore, nuk mund t'i afrohem dot Perëndisë së Përmbishenjtë. Vetëm nëpërmjet Krishtit, Kryepriiftit tonë të madh, gjejmë guximin për t'iu afruar fronit të Tij.

Shërbesat dhe Mbledhjet tona Adhuruese, të cilat kryhen falë guximit të dhënë që lartazi na japin mundësinë për t'iu afruar fronit të Tij, duke marrë kështu **përdëllim** dhe **hir**. Përmes adhurimit tonë - himneve, uratave, leximeve nga Shkrimi i Shenjtë dhe sidomos misterit të Falënderimit Hyjnor - mbushemi me hirin dhe mëshirën e Perëndisë. Kështu, Adhurimi i Krishterë bëhet takim me Perëndinë e Gjallë, nëpërmjet të cilit transformohet e gjithë qenia jonë. Vijnë të zbrazur e dalim të plotësuar, vijnë të etur për mëshirë dhe dalim të përdëllyer, vijnë të dëshpëruar dhe dalim të mbushur me fuqinë dhe hirin e Zotit. Të krishterëve hebrenj të shek. I iu duhej me bollëk fuqia e Tij, në mënyrë që të mund t'i bënë ballë sprovave të hebrenjve të tjerë jo të krishterë. Po kështu edhe neve që jetojmë sot, për t'u përballur me sfidat e epokës sonë.

- 1 Sepse çdo kryepriift që merret prej njerëzve, vihet për njerëzit në gjërat që kanë të bëjnë me Perëndinë, për të blatur dhurata dhe flijime për mëkatet;
- 2 të cilit mund t'i vijë keq për ata që janë të paditur e të gënjer; sepse edhe ai vetë është veshur me dobësi.
- 3 Edhe prandaj ka detyrë, si për popullin, kështu dhe për veten e tij, të blatojë *theror* për mëkatet.
- 4 Edhe asnjë nuk e merr këtë nder prej vetes së tij, po ai që thirret nga Perëndia si Aaroni.

Autori vazhdon të dëshmojë se Krishti është Kryepriifti ynë i vërtetë, duke marrë në shqyrtim tiparet e kryepriiftërinjve hebrenj dhe duke treguar se të gjitha ato janë të pranishme tek Ai.

Së pari, **çdo kryepriift merret prej njerëzve** (si edhe në Judaizëm) dhe **vihet për njerëzit** (nga Perëndia) **në gjërat që kanë të bëjnë me Perëndinë**. Pra, qëllimi kryesor i tij është të shërbejë si urë lidhëze për të afruar njerëzit tek Zoti. Këtë e realizon duke **blatur dhurata** (si shprehje të mirënjohjes) **dhe flijime për mëkatet**. Gjithashtu, Kryepriiftit i vjen keq për **ata që janë të paditur e të gënjer**, pra ata njerëz të cilët mëkatuan në padije, duke iu dhënë dobësive të tyre por pa dashur të

dalin kundër Ligjit të Zotit (siko Num. 15:28-31). Kjo ndodh sepse **edhe ai vetë është veshur me dobësi** edhe e di se sa e lehtë është për njerëzit të bien në paudhësi e të mos jenë plotësisht të pastër përpara Krijuesit të tyre (Job. 4:17; 15:16). Kryepriifti i ndjen dhe mbështet ata që vijnë tek ai për të ofruar flijime, **prandaj ka detyrë, si për popullin, ashtu edhe për veten e tij** (meqë edhe ai vetë është mëkatar), **të blatojë thëror për mëkatet** (krahaso me Lev. 16:6). Kryepriifti nuk mund t'i refuzojë ata që vijnë tek ai, për shkak të paudhësive, përkundrazi, i vjen keq për ta (gr. *metriopatho*), e zbut zemrën dhe i drejton tek Perëndia.

Përveç kësaj, **asnjë nuk e merr këtë nder prej vetes së tij, por thirret nga Perëndia, si Aaroni**. Ky i fundit nuk e vendosi vetë të bëhej kryepriift, dhe nuk pati asnjë grindje me kandidatët e tjerë, përkundrazi, u thirr nga vetë Zoti. Kjo vazhdoi edhe tek paraardhësit e tij, të cilët gjithashtu ishin thirrur për këtë detyrë që në lindje, pasi dimë se kryepriiftërinjtë mund të dilnin vetëm nga fisi i Aaronit. Nëse ndokush që nuk ishte pasardhës i tij e dëshironte këtë detyrë dhe mundohej ta blinte me pará, nuk i bënte aspak dobi. Vetëm Perëndia mund t'i caktonte personat e volitshëm për këtë detyrë, nuk mund të caktoheshin ata vetë.

Për të kuptuar sa më mirë rolin e Kryepriiftit dhe për të analizuar më mirë ngjashmërinë e tyre me Krishtin, nevojitet të thellohemi në shkrimet e Dhiatës së Vjetër, duke i parë në kontekstin e kohës kur u shkruan.

Detyra e kryepriiftit të judenjve u venit dhe u zhduk gradualisht pas shkatërrimit të Tempullit në vitin 70 ps.K., prandaj perceptimi më i qartë që mund të kemi për ta vjen nga Kajafa, të cilit i ishte dhënë kjo detyrë në kohën kur Krishti ishte ende në botë. Disa të krishterë dinë edhe pak më tepër për Aaronin dhe rregullat levitike për kryepriiftërinjtë. Megjithatë, Aaroni mbetet një figurë disi e mjegullt. Ndërsa figura e Kajafës haset më e detajuar në faqet e Dhiatës së Re, Aaroni fatkeqësisht trajtohet me më pak detaje në Dhiatën e Vjetër. Themi fatkeqësisht, pasi Kajafa nuk ishte i denjë për atë detyrë që i ishte dhënë dhe mëkati i tij personal mund ta zbehë disi madhështinë e vërtetë të Kryepriiftërisë.

Për të krijuar një imazh të saktë të Kryepriiftërisë, duhet të kthehemi tek Urtësia e Sirakut 50, ku flitet për Simonin, të birin e Onisë, i cili përshkruhet si: "I hijshëm në mes të popullit të tij, kur dilte nga tenda. Porsi ylli i mëngjesit në re, porsi hëna e plotë ditën e festës, porsi dielli ndriçues përmbi Tempullin e të Shumëlartit. Kur merrte pjesë prej dorës së priiftërinjve dhe qëndronte më këmbë përballë Altarit, ngjante porsi degët e cedrit të Libanit... Zbriste dhe i lartësonte duart përmbi mbarë bashkësinë e Izraelitëve, për t'ua dhënë me buzët e veta bekimin e Zotit" (Urt. Sir. 50:5-7; 12, 20-21).

Shkruesi i Urtësisë së Sirakut paraqet një ikonë lavdie e madhështie të një personi që, nëpërmjet virtytit dhe drejtësisë së tij tërhiqte tek vetja Hirin Hyjnor dhe bekimin prej së larti. Këtij konteksti iu referua dhe apostull Pavli, kur shkroi për: “lavdinë dhe dhiatat dhe ligjësimin edhe adhurimin e premtimet” (Rom. 9:4). Për shpresëtarët judenj, kryepriifti reflektonte imazhin e vetë Perëndisë, prandaj edhe veshja e tij e ndritshme priiftërore ishin simbol i lavdisë së Tij, prezenca e të Cilit manifestohej nëpërmjet shërbesave të ndryshme Kryepriiftërore. Madje edhe në Ungjillin e Joanit, pavarësisht padenjësisë dhe mëkateve personale të Kajafës, ungjillori pranon se profecia që ai foli për vdekjen e Krishtit nuk u tha prej vetes së tij, po sepse ishte kryepriift i atij viti (Jn. 11:51). Pra megjithëse Kajafa nuk gëzonte admirimin e ungjillorit, ky i fundit përsëri e respektonte për hir të detyrës që kishte. Figura e Kryepriiftit është një lloj paraprijë e Shpëtimtarit që pritej.

**5 Kështu edhe Krishti nuk e lavdëroi veten e tij që të bëhet kryepriift, po ai që i foli: "Ti je Biri im, unë sot të kam lindur".**

**6 Sikurse edhe në tjetër vend thotë: "Ti je priift për gjithë jetën sipas urdhrit të Melkisedekut".**

**7 I cili në ditët e mishit të tij, pasi iu fal e iu lut me klithmë të fortë e me lot atij që mundej ta shpëtonte atë nga vdekja, edhe u dëgjua për shpresëtarinë e tij,**

**8 ndonëse ishte bir, mësoi të jetë i bindur nga ato që pësoi.**

**9 Edhe si u bë i përsosur, u bë shkak për shpëtim të përjetshëm për të gjithë ata që e dëgjojnë atë,**

**10 duke qenë i quajtur nga Perëndia kryepriift sipas urdhrit të Melkisedekut.**

Pas renditjes së karakteristikave që duhet të ketë një kryepriift, që përmendëm në fragmentin e mëparshëm, autori vijon duke treguar se si Krishti i përmbushi të gjitha ato. Ai **nuk e lavdëroi veten e tij që të bëhet kryepriift**, por u caktua nga Perëndia. As nuk u mundua të shpallej kryepriift i Tempullit të Jerusalemit, por priti derisa Zoti e bëri Kryepriiftin e Lartë të Qiejve, pas ngjalljes së Tij.

Kjo tregohet qartë në Shkrimet, pasi Ati nuk tha vetëm: **"Ti je biri im, unë sot të kam lindur"** (nga Ps.2:7); por në një vend tjetër thotë: **"Ti je priift për gjithë jetën, sipas urdhrit të Melkisedekut"** (Ps. 110:4). Pra vetë Shkrimi dëshmon për Kryepriiftërinë e përjetshme të Tij.

Jisui as nuk kërkoi që ta merrte një rol të tillë e as nuk doli vullnetar për këtë gjë, ky ishte vullneti i Zotit , i cili e fronëzoi Mesinë e Tij në qiell dhe e bëri Kryepriift të lartë. Së dyti, ashtu siç kryepriiftërinjtë e tjerë i ndienin dhe mbështetnin cilindo që vinte

tek ata për të ofruar therore, ashtu edhe Jisui i ndiente dhe bashkohej me të gjithë ata që vuanin. Këtu autori nuk i referohet mëkatit stërgjyshor të njerëzve, por më tepër vuajtjeve dhe dobësive të tyre (sigurisht, pa mohuar gjendjen e tyre të rënë). Ata që ofrojnë therore dhe po ashtu edhe kryepriiftërinjtë quhen kryesisht të dobët (v.2) dhe nuk mëkatojnë nga rebelimi, por prej dobësisë së tyre. Krishti, si Kryepriift, u bë si ne duke marrë edhe Ai mbi vete dobësinë tonë.

Në jetën tokësore të Krishtit, pra **në ditët e mishit të Tij** ka mjaft shembuj që dëshmojnë për këtë fakt. Në kopshtin e Gjethsemanisë **iu lut me lot atij që mundej ta shpëtonte atë nga vdekja**. Pushteti i takonte Atit, ndërsa Jisui, duke qenë në botë, ishte lënë në mëshirën e njerëzve, sikurse të gjithë ne. Pra vetëm Ati mund ta shpëtonte nga vdekja. Thirrjet e Krishtit ushtonin **me klithma të forta e me lotë**. Fjala "*klithmë*" i korrespondon fjalës greke *kravgi*, që haset tek Mt. 25:6 për të përshkruar thirrjen e gëzueshme për ardhjen e dhëndrit dhe gjithashtu tek Vep. Ap. 23:9 duke iu referuar britmave të farisenjve e të saducenjve, që gati sa nuk përfunduan në përplasje të dhunshme. Kështu kuptojmë se lutja e Krishtit nuk ishte thjesht ndonjë kërkesë e qetë, por thirrje e zjarrtë e një shpirti në agoni, tregues i qartë i faktit se vërtet mori mbi vete dobësinë e natyrës tonë.

Sipas autorit, Perëndia e dëgjoji Jisuin për shpresëtarinë e tij (gr. *evlavia*), frikën e shenjtë dhe përlësinë e tejskajshme. Të gjitha këto tipare theksojnë natyrën e Tij njerëzore. Ashtu siç dhe ne jemi thirrur t'i afrohemi Perëndisë me shpresëtarin dhe frikë, kështu veproi edhe Jisui. **Ndonëse ishte Bir** dhe ndante shenjtëri të plotë me Atin, përsëri **mësoi të jetë i bindur në ato që pësoi**. Mësoi bindjen në kufijtë e durimit njerëzor, duke mësuar **nga ato që pësoi**. Kjo nuk do të thotë se Ai kishte treguar mosbindje dhe tani po mësonte se si të bindej, por, nëpërmjet të gjithë përjetimeve që pati si njeri, mësoi se çfarë do të thotë t'i bindesh Perëndisë, megjithëse kjo bindje i kushtoi jetën. **Mësoi** duke mos e kundërshtuar kurrë vullnetin e Atit, pavarësisht të gjithave. Edhe kështu u bë i përsosur (gr. *teleio*).

Pas kësaj, Ai mund t'i drejtojë të gjithë ndjekësit e Tij drejt lavdisë, në të njëjtën rrugë siç eci edhe vetë. Sigurisht, kjo do të arrihet vetëm nëpërmjet bindjes ndaj Tij, duke qëndruar të patundur në besën e krishterë. Tani që është në qiej, është **shkak i shpëtimit të përjetshëm, i quajtur nga Perëndia kryepriift i lartë, sipas urdhrit të Melkisedekut**.

Mënyra se si paraqitet Jisui në këto vargje tingëllon disi e huaj për ne, deri diku edhe e habitshme. Nuk jemi mësuar me imazhin e një Jisui që i drejtohet Atit me klithma të forta e me lot, megjithëse skena e agonisë së Gjethsemanisë na përgatit deri diku për këtë. Ndërsa jemi mësuar të dëgjojmë për "Krishtin Perëndi", na duket

disi e kontradiktore e vërteta se ai është njëkohësisht edhe “njeriu Jisu Krisht” (1 Tim. 2:5).

Megjithatë, Kisha Orthodhokse mëson se ai është njëkohësisht Perëndi i përsosur dhe njeri i përsosur, i bashkëqenshëm me Atin në hyjninë e Tij dhe me njerëzit në njerishmërinë e Tij. Pjesë e kësaj të fundit ishin dhe përgjërimet e vuajtjet.

Ne të krishterët duhet të ngjitem monopatin e vështirë të bindjes dhe të përballemi edhe me dhimbjen, kundërshtimet, frikërat dhe vdekjen. Prandaj dhe Shpëtimtari e bëri gati rrugën për ne. Që ne të mund të gjenim rrugën e shpëtimit, duhej që Shpëtimtari të pinte të njëjtën kupë që është bërë për ne. Perëndia e veshi Atë me natyrë të dobët (shiko 2 Kor. 13:4) për të na ndihmuar edhe ne në dobësinë tonë. E shpuri në errësirën e vuajtjeve që të shpëtojë të tjerët që vuajnë. Falë **klithmave** të tij ne kemi paqe në shpirt, dhe falë **lotëve** të Tij na u lanë të gjitha shenjat e vuajtjeve.

## DISKUTIM

### Mbi interpretimin e Psalmi 2:7

Sipas interpretimit të krishterë, fragmenti i Psalmi 2:7 : “Ti je biri im, unë sot të kam lindur” i referohet faktit që Jisui u caktua prej Atit të jetë Mesia i premtuar. Në kontekstin origjinal, Psalmi flet për madhësitinë e shtëpisë së Davidit. Në kohërat e lashta, mbreti mendohej se ishte biri i adoptuar i zotit të tij dhe dita e fronëzimit cilësohej dhe si dita e adoptimit. Kështu edhe në këtë psalm kremtohet “adoptimi” i mbretit nga Perëndia dhe vendosja nën mbrojtjen e Tij. Kombet kundërshtarë të shtëpisë së Davidit mund ta kundërshtonin këtë fakt sa të donin, por vetë Perëndia e bëri atë si bir të Tijin dhe prandaj do të gëzojë mbrojtjen e Tij kurdoherë.

Sipas doktrinës së Krishterë, Psalmi 2 i referohet Jisuit të Nazaretit, sepse Ai është Mesia, pasardhësi i Davidit që trashëgon gjithë lavdinë e shtëpisë së Tij. Pra, ky varg i Psalmi 2 gjen përmbushje në personin e Krishtit. Por çfarë kuptimi ka kjo?

Për ne që kemi trashëguar dhe përhapur mësimet e Sinodeve Ekumenike, është e vështirë të mos i shikojmë tekstet e lashta në dritën e mësimëve të tyre. Për kaç shumë kohë e kemi përdorur termin “Biri i vetëmlindur” për t’iu referuar Zotit sa që të gjitha shkrimet profetike të Dhiatës së Vjetër i kuptojmë sikur kanë lidhje me të. Vërtet Krishti lindi prej Atit përpara gjithë shekujve, siç na thuhet edhe tek Simboli i

Besimit. Megjithatë, interpretimi i Psalmi 2:7 i referohet një të vërtete tjetër, pasi i përket një terminologjie më të vjetër.

Më saktë, i referohet kohës kur Jisui i Nazaretit u caktua nga Ati për të qenë Mesia, i Vajosuri, pasi sipas botëkuptimit judaik, Mesia duhet të caktohet. (Kjo mënyrë e perceptimit të tyre për Mesian reflektohet edhe tek fjalimi i Petros tek Vep. Ap. 2:36.: Megjithëse është përjetësisht hyjnor, në një kohë të caktuar “Perëndia e bëri Zot dhe Krisht”.) Kjo kohë ishte pikërisht gjatë Pagëzimit të Krishtit, ku Perëndia e vajosi Atë me Frymë të Shenjtë e me fuqi për të përmbushur veprën Shpëtimtare (Vep. Ap. 10:38). Megjithatë, duhet të mbetet gjithnjë të qartë se Jisui ishte dhe është gjithmonë Krishti, që nga dita e lindjes së Tij (Llk. 2:11), dhe që para Mishërimit ishte Fjala e Përjetshme e Perëndisë. Ky perceptim i judenjve nuk lidhet me herezinë e mëvonshme të “birësimit”. Fjala e Përjetshme e Perëndisë i lindur prej Virgjëreshës, në Pagëzimin e Tij filloi veprën Shpëtimtare, dhe vetëm në këtë këndvështrim mund të thuhet se “u caktua si Mesi”. Perëndia e lartësoi Atë si Krisht, përpara popullit të Izraelit (siç lartësoi edhe më parë Davidin dhe e bëri mbret - shiko Vep. Ap. 13:22-33). Ky këndvështrim judaik pasqyrohet edhe tek Psalmi 2:7. Pas Ngjitjes së Tij në Qiejt Ai u shpall Kryepriфт dhe qëndron në të djathtë të Atit.

### **3.4. Ngulmoni për të arritur pjekuri shpirtërore (5:11-6:20)**

**11 për të cilin kemi shumë gjëra për të thënë, edhe të vështira për t’u shpjeguar, meqenëse jeni bërë të plogësht në dëgjim.**

**12 Sepse, ndonëse pas kaq kohësh duhej të ishit mësues, përsëri keni nevojë që ndonjë t’ju mësojë juve parimet elementare të thënieve të Perëndisë; edhe keni arritur të keni nevojë për qumësht e jo për ushqim të fortë.**

**13 Sepse kushdo që ushqehet me qumësht, është i papërvojë në fjalët e drejtësisë, sepse është një foshnje.**

**14 Po ushqimi i fortë është për të rritur, të cilët meqenëse janë mësuar kështu, i kanë ndjenjat e tyre të stërvitura për të dalluar të mirën e të ligën.**

Dëshmia se Krishti është “Kryepriфт përjetë, sipas urdhrit të Melkisedekut” (5:10), përbën vështirësi dhe njëfarë pengese për lexuesit. Qëllimi i autorit ishte të

shkruante për kryepriftërinë e Jisuit, duke bërë analogji me Melkisedekun, dhe kishte **shumë gjëra për të thënë** për këtë. Megjithatë, ishte shumë e vështirë për lexuesit e tij ta kuptonin, duke qenë ende foshnja në besim. Duke pasur mendësi judaike dhe të kufizuar vetëm në preokupimet e botës, duke u mjaftuar me një Tempull tokësor dhe besimin e paraardhësve të tyre, nuk ishin të hapur për të vlerësuar e pranuar mësimin e ri. Duhet të dilnin jashtë rehatisë së fesë së tyre, pasi ishin bërë **të plogësht në dëgjim** (gr. *nothroi tis akoais*), të ngathët e dembelë. Derisa të dilnin nga kjo gjendje e të hapnin mendjet e tyre ndaj së vërtetës, do të ishte e **vështirë për t'u shpjeguar** hyjnoret.

Dëgjuesit nuk ishin të porsakthyer në besim, përkundrazi, **pas kaq kohësh duhet të ishin bërë mësues** të besimit, duke ua shpërndarë dijet edhe të tjerëve. Por përderisa ende kishin nevojë t'u mësonin **parimet elementare të thënieve të Perëndisë**, do të thotë se nuk ishin themeluar në besim. U nevojitej dikush që t'i strukturonte përsëri bazat e tyre të besimit.

Duke qenë në një gjendje të tillë foshnjore për nga ana shpirtërore, kishin arritur të **kishin nevojë për qumësht e jo për ushqim të fortë**, në pamundësi për ta përballuar dot. Nuk ishin në gjendje të kuptonin Shkrimet ku thuhej se priftëria e Jisuit i ngjasonte asaj të Melkisedekut, madje me zor arrinin të kuptonin mësimet themelore se si të qëndronin larg imoralitetit dhe shthurjes (shiko 12:14; 13:14). Këto mësimet që i përkisnin një niveli më të lartë shpirtëror autori i quan **fjalët e drejtësisë**, sepse mund të kuptoheshin vetëm nga ata të drejtë që ishin të pjekur në besim.

Tashmë mësimet etike duhet të ishin bërë pjesë e pandarë e tyre, dhe ata duhet të ishin **rritur** dhe pjekur, me **ndjenjat e stërvitura për të dalluar të mirën nga e keqja**, duke qëndruar larg të ligës. Fjala "sprovuar" në greqisht është shkruar *gymnazo* (nga vjen dhe fjala *gjimnastikë*) dhe nënkupton se pjekuria shpirtërore, ashtu si dhe stërvitja trupore, ka nevojë për disiplinë dhe ushtrim të fortë për të arritur përsosmërinë.

**1 Prandaj si të lëmë mësimin fillestar të Krishtit, le t'i drejtohem përsosmërisë, pa vënë përsëri themel pendimi nga punë të vdekura dhe të besimit tek Perëndia,**

**2 të mësimin për pagëzime, e për vënien e duarve, e ngjalljen e të vdekurve, e për gjyqin e përjetshëm.**

**3 Edhe këtë do ta bëjmë, në lejoftë Perëndia.**

Meqenëse lexuesit kësaj letre duhet të ishin bërë tashmë mësues të besimit (5:12), autori i nxit **t'i drejtohen përsosmërisë** dhe pjekurisë shpirtërore (gr. *teliothes*). Ata kishin mbetur në fillimet e udhëtimit shpirtëror. **Mësimi fillestar i Krishtit** dhe bazat e besës së Krishterë nuk kishin gjetur terren të përshtatshëm për t'u themeluar në zemrat e tyre, prandaj mësuesve u nevojitej **të ndërtonin** përsëri një **themel** të tillë, i cili konsistonte në **pendimin nga punët e vdekura dhe besimin tek Perëndia**. **Punët** e vdekura ishin vepra që të çonin në humbje. Në një nga librat e Kishës së hershme të quajtur *Didakia* (që daton nga viti 100 ps.K.) vepra të tilla quheshin "vepra të vdekjes". Këtu përfshiheshin vrasja, imoraliteti, aborti, vjedhja, magjitë, dëshmitë e rreme, mallkimet, astrologjia, hipokrizitë, zemërimi etj. Lista e dhënë tek *Didakia* nuk është e plotë dhe as përfshihet në letërën që po analizojmë. Kjo sepse autori pret që lexuesit e tij të jenë të njohur me veprat që çojnë në vdekje shpirtërore.

Duhet të kemi të qartë se vepra të "**vdekura**" nuk quhen veprat e mira, prej të cilave nuk arrijmë do shpëtimin, pa pasur besim. Përkundrazi, quhen mëkatet, prandaj thuhet se për to nevojitet **pendim** i thellë. Edhe sipas botëkuptimit protestant, nuk do të kishte kuptim pendimi për vepra të mira por për mbështetjen e plotë në to. Meqë këtu autori nxit për pendesë për veprat në vetvete, dëshmon se nuk bëhet fjalë për vepra të mira, por për mëkatet, të cilat çojnë në vdekje.

Qëllimi i tij është t'i drejtojë ata në një jetë të ndërtuar mbi **themel pendimi**, dhe me **besim** të patundur **tek Perëndia**. Kjo e fundit nënkupton një jetë të orientuar drejt Zotit, në besnikëri të thellë ndaj Tij (gr. *pistis*, që ka kuptimin "*besë*" dhe "*besnikëri*"). Të besojmë se do të shpëtohem prej dashurisë së Perëndisë dhe jo duke u bazuar në arritjet personale, gjithashtu të tregohemi besnikë, duke ecur sipas vullnetit të Tij, si dishepuj të denjë të Krishtit Jisu.

Ky themel konsiston në një **mësim** të caktuar. (Në disa dorëshkrime, fjala *mësim* është në rasën kallëzore *didaken*, ashtu si edhe *themelion* - themeli, që nënkupton se mësimi është vetë themeli.) Ky mësim konsiston në udhëzimet katekitike për **pagëzim, për vënien e duarve, për ngjalljen e të vdekurve e për gjyqin e përjetshëm**, në mënyrë që të krishterët hebrenj të kuptonin elementet e botëkuptimit të Krishterë. Për këtë arsye autori edhe i liston, që ata t'i pranojnë njëherë e përgjithmonë, duke mos u lëkundur asnjëherë më. Mësimet janë këto:

1. **Mbi pagëzimin** (zhytjen), - Në greqisht fjala korresponduese është *baptismos*, dhe nuk i referohet thjesht Pagëzimit (sepse për të zakonisht përdoret fjala *baptisma*) por për ritualin e pastrimit hebraik të larjeve të kupave e brokeve (Mk. 7:4). Të njëjtin term e hasim edhe më vonë në këtë letër, ku përdoret për të përshkruar pastrimin në



rast papastërtish morale (9:10, që i referohet pastrimeve të përshkruara tek Lev. 11:25; 13:6; 14:8).

“Pagëzimi” i judenjve të konvertuar ishte i bazuar pikërisht në këtë ritual të zhytjes. Si simbol të larjesh nga papastërtitë morale, paganët që donin të ktheheshin në judaizëm, zhyteshin në ujë (pas rrethprerjes, në rast se i konvertuari ishte mashkull) për t’u pastruar nga njollat e jetës së dikurshme pagane.

Pagëzimi i Joan Pararendësit ishte i bazuar pikërisht në këtë ritual, vetëm se në rastin e tij, ai vetë mori guximin t’i pagëzonte.

Kështu, autori e vendos Pagëzimin e krishterë (gr. *baptisma*) në një kontekst më të gjerë, duke përfshirë edhe atë judaik. Nëpërmjet kësaj pranëvënije kërkon të tregojë për vlerën e lartë dhe vërtetësinë e besës së krishterë, krahasuar me të tjerët. Ku qëndron kjo vërtetësi? Së pari, në dhuratën e paçmuar të rilindjes. Krishti mësoi se për të hyrë dikush në Mbretërinë e Perëndisë, duhej të rilindte prej uji dhe prej fryme (Jn. 3:3-5), dhe Kisha e ka interpretuar këtë pjesë të lidhur me Pagëzimin. Gjithashtu dhe apostull Pavli foli për “larjen e rilindjes” (gr. *paligenisia*) si mjet të shpëtimit të shpirtit (Tito 3:5).

Nuk do të arrijmë ta kuptojmë dot rilindjen në mënyrën e duhur, nëse kufizohemi duke e parë vetëm individualisht. Me këtë term Krishti nënkuptonte edhe jetën e re që do të vijë (Mt. 19:28), ku i gjithë kozmosi do të marrë pjesë në lavdinë e Perëndisë dhe do të rilindet prej saj. Të krishterët mund ta përjetojnë këtë jetë të re që në këtë botë, prandaj “rilindje” do të thotë të jetosh që tani realitetin e jetës së përjetshme.

Pagëzimi lidhet gjithashtu me faljen e mëkateve. Në ditën e Pendikostisë, apostull Petro i nxiti të gjithë të “pagëzohen në emër të Jisu Krishtit, për ndjesën e mëkateve” (Vep. Ap. 2:38), madje edhe vetë shën Pavlit iu tha të “pagëzohet e të lahet nga mëkatet, duke thirrur emrin e Zotit” (Vep. Ap. 22:16).

Uji i kolimvithrës pastron të gjitha mëkatet e mëparshme, duke hapur dyert drejt një jete të re, me falje dhe pendim. Madje edhe foshnjat, të cilat janë pa mëkate personale, gjatë Pagëzimit marrin “ndjesën e mëkateve”, duke ndërtuar kështu një marrëdhënie të re më Krishtin.

Së fundmi, nëpërmjet Pagëzimit marrim birërinë. Të gjithë, burra, gra e fëmijë bëhemi trashëgimtarë dhe bij të Perëndisë dhe bashkëtrashëgimtarë me Krishtin (Rom. 8:17). Përpara këtij Misteri, të gjithë kemi qenë bij të mosbindjes, dhe nuk kishim një lidhje kaq të ngushtë me Zotin, sa ta thërrisnim Atë. Vetëm nëpërmjet Krishtit, u bëmë bij të Perëndisë (Jn. 1:12-13), duke u rilindur në Zotin. Këtë birëri e

marrim pikërisht në Pagëzim, ku mund të thërresim “Aba, o Atë!” (Gal. 4:5; Efes. 1:5).

Të gjitha këto që përmendëm nuk arrihen kurrësi me anë të ritualit të zhytjes sipas Dhiatës së Vjetër. Kjo e fundit vlente për të pastruar ndotjet e jashtme (Heb. 9:10), ndërkohë që vetëm Pagëzimi mund t’i pastrojë thellësitë e zemrës.

**2. Mbi vënien e duarve:** Nisur nga fakti se vënia e duarve përmendet menjëherë pas ritualit të pagëzimit (*baptismos*), me siguri bëhet fjalë për procesin e vënies së duarve mbi të sapokonvertuarin gjatë Pagëzimit të Krishterë. Procedura ishte e tillë: fillimisht katikumeni zhytej në ujë tri herë, në emër të Atit, Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë (Mt. 28:19), më pas merrte vënien e duarve (ndoshta e shoqëruar edhe me vajosjen) për të ardhur mbi të Shpirti i Shenjtë (Vep. Ap. 8:17; 19:6). Gjatë kësaj kohe, personit i shpjegohej domethënia e këtyre veprimeve: marrja e dhuratave të Shpirtit të Shenjtë dhe thirrja e gjithsecilit për t’i përdorur këto dhurata në dobi të trupit të Krishtit - Kishës.

Vënia e duarve përdorej edhe për bekime apo dorëzime, ashtu siç dhe Krishti vuri duart e Tij mbi fëmijët që t’i bekonte (Mark. 10:16). Kështu edhe apostujt, nëpërmjet vënies së duarve dorëzuan shumë priftërinj dhe dhiakonë, duke u lutur që të vinte mbi ta Hiri i Shpirtit të Shenjtë (Vep. Ap. 6:6; 14:23; 1 Tim 4:14). Këta priftërinj vunë gjithashtu duart e tyre mbi të sëmuret për t’i shëruar (Vep. Ap. 28:8; Jak. 5:14). Fuqia e paepur e Krishtit, e pranishme brenda në Kishën e Tij, përçohet gjithnjë nëpërmjet vënies së duarve dhe lutjes.

Si një ishull i ndritshëm në mes të errësirës së thellë të detit, Kisha e Shenjtë shëron, fal, rikthen në gjendjen e mëparshme dhe jep forcë, pasi në të qëndron e gjithë plotësia e Krishtit. Përmes thirrjes së emrit të Tij dhe duke ruajtur besimin të patundur, të gjithë mund të shërohen.

**3. Mbi ngjalljen e të vdekurve:** Padyshim që judenjtë e shekullit të parë nuk mund ta kuptonin dot ngjalljen e të vdekurve. Saducenjtë nuk e pranonin fare, ndërsa Farisenjtë po, për aq sa mund të kuptonin (krahaso me mënyrën se si e kuptoi Marta mësimin e Tij tek Jn. 22:24). Megjithatë, kuptimi i ngjalljes në Krishterim nuk kufizohet vetëm në atë që një ditë do të ngjallen të gjithë, duke marrë trupat tanë të perlëvduar. Thelbi i këtij mësimi qëndron në Krishtin dhe ngjalljen e Tij prej së vdekurish.

Shumica e judenjve besonin se me të ardhur Mesia, do të ngjallte të vdekurit dhe do të sillte Mbretërinë e Perëndisë. Kisha mëson se Jisui është Mesia i shumëpritur dhe se ngjallja e Tij në të tretën ditë shënoi fillimin e ngjalljes së përgjithshme që do të ndodhë në fund të kohërave.

Jo të gjithë të fjeturit u ngjallën bashkë me Jisuin. Ai qe fryti i parë dhe premtimi i vjeljes së fundit. Të tjerët do të ngjallen (vilen) në Ardhjen e Dytë, në fund të kohërave (1 Kor. 15:23). Vdekja dhe Ngjallja e Krishtit shënoi fillimin e fundit të kësaj bote. Ai vetë është burimi i ngjalljes. Në Ditën e Fundit nuk do të ketë thjesht ngjallje të të gjithë të krishterëve që besojnë, por të gjithë ata do të marrin pjesë në Ngjalljen e Krishtit. Ashtu sikurse të gjithë vdiqën për njeriun e vjetër - Adamin, të gjithë do të ngjallen përmes ngjalljes së Krishtit (1 Kor. 15:20-24).

**4. Mbi Gjykimin e Fundit:** Ashtu si edhe mësimi paraardhës, edhe ky nuk kufizohet vetëm në mësimin se pas ngjalljes së të gjithëve, do të pasojë gjykimi përfundimtar, por tregon gjithashtu se do të jetë pikërisht Jisui Ai që do të na gjykojë, pasi Ai është Krishti (Jn. 5:22, 27). Judenjtë besonin se Mesia do të gjykojë kombet (krahaso me librin e Enokut 45, 49: “Atë ditë, i Zgjedhuri im do të ulet në fronin e lavdisë dhe do të shqyrtojë veprat e tyre... do të gjykojë gjithë të fshehtat dhe askush nuk do të mund të justifikohet përpara Tij”). Në këtë pikë, mësimi i Krishterë njëjtësohet me atë judaik. Jisui i Nazaretit do të gjykojë të gjithë njerëzit, duke qenë Ai i Zgjedhuri i Perëndisë (Jn. 5:22-27). Kur të vijë koha, të gjithë do të ngrihen nga varret, duke marrë trupat e hirësuar e të përlevduar, e do të qëndrojnë përpara Krishtit, Gjykatësit të Madh. Ai do të nxjerrë në pah të vërtetat e gjithsecilit, duke shpërblyer të drejtët për drejtësinë e tyre dhe duke dënuar të ligjtë për mëkatet e tyre. Ata të cilët do t’i pranojë, do të hyjnë në jetën e përjetshme, kurse ata që do refuzojë do të vuajnë në zjarrin e pasosur. E gjithë jeta jonë tokësore jetohe nën hijen e këtij Gjykimi, asnjë vepër nuk do t’i shpëtojë syrit të Gjykatësit të Madh.

Këto mësimet përbëjnë bazat e katekizmit të lexuesve të kësaj letre, bazat të cilat rrezikonin t’i harronin. Duke rënë pre e presionit të bashkëkombësve të tyre judenj, po largoheshin gjithnjë e më tepër nga botëkuptimi i Krishterë dhe nevojitej t’iu rikujtoheshin vazhdimisht themelet e besimit. Atyre iu duhej **të linin mësimin fillestar të Krishtit** dhe të përparonin në **përsosmëri**. Autori shfaqet më se i gatshëm t’i ndihmojë në këtë përparim, **në e lejoftë Perëndia** që ata të ndryshojnë qëndrimin e t’i përkushtohen besës së Krishterë.

**4 Sepse është e pamundur për ata që u ndriçuan një herë dhe ndjenë shijen e dhuratës qiellore, edhe u bënë pjesëtarë të Frymës së Shenjtë,**

**5 edhe shijuan fjalën e mirë të Perëndisë, edhe të fuqive të jetës së ardhme,**

**6 edhe pastaj u rrëzuan, të përtërihen përsëri në pendim; sepse kryqëzojnë përsëri në veten e tyre të Birin e Perëndisë, edhe e turpërojnë.**

Ripërtëritja shpirtërore ishte e domosdoshme për ta, sepse kishte rrezik të binin në apostazi (mohim të besimit). Duhet të mbanin ndër mend gjithçka që u ishte dhënë dhe të gjitha përjetimet e besimit. Sepse **u ndriçuan dhe ndjenë shijen e dhuratës qiellore** duke u bërë pjesëtarë të Frymës së Shenjtë **edhe shijuan fjalën e mirë të Perëndisë, edhe të fuqive të jetës së ardhme**. Si mund ta hidhnin tej gjithë këtë përjetim?

Në këto vargje pasqyrohet realiteti i jetës së Krishterë dhe se ku konsiston ai.

Së pari, konsiston në ndriçimin. Termi “**u ndriçuan një herë**” (gr. *apax* - shiko 10:2; Juda 3) nënkupton se ndriçimi nuk është ndonjë fazë që kalon, por një gjendje e përhershme. Vetë fjala *ndriçim* (gr. *fortis*) përdorej në Kishën e Hershme për t’iu referuar Misterit të Pagëzimit (e gjejmë të përdorur në apologjinë e shën Justin martirit, kap. 61). Në fragmentin që po analizojmë termi përdoret për t’iu kujtuar lexuesve se si nëpërmjet Pagëzimit kishin dalë nga errësira dhe verbëria dhe kishin hyrë në Dritën e pashtershme të Perëndisë (1 Petr. 2:9). Drita e Birit të Perëndisë derdhet në secilin prej nesh në Misterin e Pagëzimit, duke na hapur sytë e shpirtit drejt të vërtetave të pakonceptueshme për botën.

Ky përjetim përshkruhet edhe si shijim i **dhuratës qiellore**. Për cilën dhuratë (gr. *dorea*) bëhet fjalë? Meqë Shpirti i Shenjtë përendet edhe në vijim të vargut, duket se nuk i referohet pikërisht Atij, por mirësisë dhe shpëtimit të Perëndisë në përgjithësi. Quhet dhuratë sepse u jepet të gjithëve falas, ndërsa termi “shije” lidhet me Psalmin 34 (v.8 sipas LXX) “Shijoni dhe shihni se Zoti është i mirë, lum ai njeri që shpreson tek Ai”. Ky term përmendet edhe në letrën e shën Petros, ku ai e quan Pagëzimin përjetim të shpëtimit të Perëndisë dhe shijim të mirësisë së Tij të pafund (1 Petr.2:2-3). Në Traditën Liturgjikale të Kishës, ky Psalm interpretohet i lidhur me Misterin e Eukaristisë Hyjnore, prandaj mundet që edhe në këtë fragment, fjala “shijim” t’i referohet Eukaristisë.

Përveç këtyre, thuhet për ta se u bënë pjesëtarë të Frymës së Shenjtë. Më lart përmendëm se Shpirti i Shenjtë jepet nëpërmjet vënies së duarve gjatë Pagëzimit

(v.2) dhe ky varg i referohet pikërisht kësaj gjëje. Termi “*pjesëtarë*” (gr. *metoxos*) është përdorur edhe tek 3:1 ku flitet për thirrjen që lartazi të lexuesve, për t’u bërë bij të Perëndisë, si dhe tek 3:14 ku thuhet se janë bërë pjesëtarë të Krishtit në pagëzim, gjë që do t’u sjellë prehjen e përjetshme. Përdorimi i të njëjtit term në këtë fragment lidhet edhe me kontekstet e mëparshme, pasi marrja e Shpirtit të Shenjtë lidhet me përjetimin e hyrjes në Krishterim.

E fundit që përmendet është **shijimi i fjalës së mirë të Perëndisë, edhe i fuqive të jetës së ardhshme**. Kjo lidhet me jetën e krishterë pas Pagëzimit dhe konkretisht me pjesëmarrjen në mbledhjet adhuruese. Duke marrë pjesë në to, të krishterët **shijojnë** dhe përjetojnë **fjalën e mirë të Perëndisë** nëpërmjet udhëzimeve, mësimave e profecive, duke përjetuar kështu mirësinë e Tij. Gjithashtu ftohen të përjetojnë edhe **fuqitë e jetës së ardhshme** përmes shërimeve, mrekullive e ekzorcizmave. Pjesëmarrja në adhurimin e përbashkët i bën të hapur ndaj hirit hyjnor, që ka fuqinë të transformojë, “fjalën e cila mund të shpëtojë shpirtat” (Jak. 1:21) dhe “frymën që punon çudira” (Gal. 3:5).

Të gjitha këto përjetime ishin të njohura për lexuesit e kësaj letre. Si vallë mund ta refuzonin një gjë të tillë? Çfarë rreziku i madh u kanosej nëse vepronin kështu! Nëse rrezoheshin, do të ishte e pamundur të përtëriheshin përsëri në pendim, pasi kështu do të rreshtoheshin edhe ata bashkë me të tjerët që e **kryqëzojnë përsëri të Birin e Perëndisë, dhe e turpërojnë**. Judenjtë që nuk e besuan Krishtin, e quajtën mashtrues dhe iu duk e drejtë që ta turpëronin haptazi (gr. *paradigmatizo* - shiko përdorimin tek Num. 25:4 LXX) mbi kryq. Nëse edhe hebrenjtë e krishterë e linin veten të largoheshin nga besimi i tyre, nuk do të reshtnin thjesht së qeni dishepuj të mirë, por do të rreshtoheshin bashkë me ata që e dorëzuan Krishtin në tortura.

Mund të lindë pyetja se çfarë kuptimi ka kur thuhet se është e pamundur për mohues të tillë të besës të përtërihen përsëri në pendim? Mos vallë është e pamundur për një person të tillë të pendohet e të ndryshojë, apo apostazia e ka bërë t’i ftohet zemra e të katandiset në një gjendje konstante rebelimi? Dimë se nuk është kështu në të vërtetë. Nga historia e Krishterimit, fatkeqësisht kemi plot shembuj personash të cilët e njohën Zotin dhe e mohuan atë, por më pas u penduan. (Mendja na shkon tek apostull Petro, i cili e mohoi Krishtin dhe më pas u pendua, apo shën Markelini, episkop i Romës (kujtimi i tij kremtohet më 7 Qershor) i cili në vitin 304, në kohën e persekutimit të Dioklecianit, mohoi besimin duke iu sakrifikuar idhujve paganë, e më pas u pendua dhe u martirizua.) Pra përderisa të krishterët mund të pendohen, çfarë kuptimi kanë fjalët “*të përtërihen përsëri në pendim*” (gr. *palin anakeinizin eis metanian*)?

Çelësi i kësaj përgjigjeje gjendet në përdorimin e fjalës “pendim” tek 12:17, ku thuhet se Esau, si shiti të drejtat e paralindjes së tij, nuk gjeti vend për pendim ndonëse e kërkoi me lot. Pamundësia për t’u penduar nuk lidhet me gjendjen e rënduar psikologjike të Esaut. Padyshim autori nuk do të thotë se ai nuk ndiente keqardhje, pasi i vinte aq keq sa dergjej në lot, por thotë se “nuk gjeti vend për pendim”, pra nuk ekzistonte mundësia që ai t’i merrte përsëri të drejtat e të parëlindurit dhe bekimin e të atit, pasi i shiti.

Në të njëjtën mënyrë, autori i nxit edhe lexuesit e tij të përparojnë në përsosmëri, që të mund të shohin Atin (12:14-17) dhe të mos privohen nga mëshira e Tij në Ditën e Gjyqit. Nuk duhet kurrësi të braktisin besimin e tyre, sikurse Esau braktisi të drejtat e të parëlindurit me vullnetin e vet. Nëse do të veprojnë si ai, në fund do t’u mohohet shpëtimi dhe nuk do të kenë më mundësi për t’u kthyer pas (v.17).

Ky është edhe kuptimi i vargut 6:6. Pamundësia për t’u ripërtërirë në pendim nënkupton pamundësinë për t’u kthyer në gjendjen e mëparshme, përpara rënies, në Ditën e Gjyqit. Për ndokënd që njeh dhe ka përjetuar bekimet e Perëndisë largohet prej Tij, nuk do të ketë justifikim në Ditën e Gjyqit. Aty do të shterojnë të gjitha mundësitë e vetëkorrigjimit dhe kështu nuk do të ekzistojë më mundësia për t’u ripërtërirë në pendim, në rast se mbeten në gjendje të rënë përgjatë gjithë jetës së tyre dhe nuk kthehen përsëri në besim. Nëse ndodh që të kthehen, kanë sigurinë e plotë se Perëndia do ta pranojë cilindo që pendohet (1 Jn. 1:9). Megjithatë, autori nuk u referohet këtij rasti të fundit të besimtarit që bie, pendohet dhe kthehet përsëri. Rreziku i lexuesve të tij të atëhershëm ishte se mund të binin në apostazi dhe të mbesnin në atë gjendje, dhe pikërisht këtu mbështetet paralajmërimi i tij.

**7 Sepse toka që pi shiun që bie shumë herë mbi të, edhe prodhon barëra të dobishme për ata, për të cilët edhe punohet, merr bekim nga Perëndia.**

**8 Po në nxjerrtë driza e gjemba, është e pavlefshme dhe afër mallkimit, fundi i së cilës është të digjet.**

Paralajmërimi, për të cilin folëm më lart, ilustronet nëpërmjet një shembulli me dheun. **Toka që pi shiun që bie shumë herë mbi të, edhe prodhon barëra të dobishme për ata, për të cilët edhe punohet, merr bekim nga Perëndia.** Kjo është e vërtetë, por nuk është e sigurt se do të jetë gjithmonë kështu. Sepse nëse e njëjta tokë nxjerr më vonë **driza e gjemba**, quhet **e pavlefshme** dhe **e panevojshme** (gr.

*adhokimos*, krahaso me përdorimin tek 1 Kor. 9:27). Madje, nëse ndodh kështu, **është më afër mallkimit dhe fundi i saj është të digjet**. Pronarëve nuk do t'i mbetet asnjë zgjidhje tjetër përveç se t'i venë zjarrin gjembave dhe shkurreve të saj.

E njëjta gjë vlen dhe për hebrenjtë e krishterë të shek. I, të cilëve u drejtohet letra. Mbi ta ishte derdhur me bollëk hiri i Shpirtit të Shenjtë (Joel 2:23, 28), kishin sjellë plot fryte në jetën shpirtërore, dhe kishin tërhequr mbi veten bekimet e Perëndisë. Por nëse ndryshonin gjendjen e tyre, ashtu si edhe dheu, do të quheshin të pavlerë dhe afër mallkimit të Zotit. Fundi i tyre do të ishte zjarri i përjetshëm, prandaj nxiten të mos bëhen të pabesë, të mos bien, por të përparojnë në përsosmëri.

**9 Po për ju, të dashur, ndonëse flasim kështu, jemi të bindur , se keni gjërat më të mira, që i përkasin shpëtimit.**

**10 Sepse Perëndia nuk është i padrejtë, që të harrojë punën tuaj dhe mundin e dashurisë që treguat për emrin e tij me shërbimin që u bëtë e po u bëni shenjtëve.**

**11 Edhe dëshirojmë që gjithsecili prej jush të tregojë po atë zell për vërtetimin e plotë të shpresës deri në fund;**

**12 që të mos bëheni të plogësht, po të bëni si ata që trashëgojnë premtimin me anë të besimit e të durimit.**

Pas gjithë paralajmërimeve për refuzimin nga Perëndia, autori nuk heziton t'i sigurojë lexuesit se nuk nënkupton se ata janë të refuzuar. Përkundrazi, i quan të dashur dhe u siguron se e di që kanë **gjërat më të mira, që i përkasin shpëtimit**. Padyshim që nuk i kishte mallkuar Perëndia, sepse Ai **nuk është i padrejtë dhe nuk e harron punën dhe mundin** që kaluan duke i shërbyer (gr. *diakoneo*) shenjtëve, pra vëllezërve të tyre të krishterë, duke i mirëpritur dhe ofruar për ta. Ata ende vazhdonin me këtë shërbim ndaj gjithsecilit që kishte nevojë. Kështu nuk u jepnin dashuri vetëm atyre, por nëpërmjet tyre edhe vetë Zotit, që i frymëzonte për këto vepra të mira, dhe kjo gjë nuk do t'iu harrohej kurrë.

Autori dëshiron dhe u kërkon që **të tregojnë po atë zell për vërtetimin e plotë të shpresës deri në fund**. Ishin duke ecur mirë dhe nuk duhet të binin në plogështi (gr. *nothros* - krahaso përdorimin e këtij termi tek 5:11) e të humbnin zellin për Perëndinë dhe qielloret. Falë zellit të tyre ishin të kapur fort pas **shpresës** së lavdisë që i priste, dhe prandaj duhet ta mbanin atë deri në fund, për të mos e humbur çmimin. Nëse mbesnin të fortë në besim dhe duronin në vuajtje ashtu si dhe etërit e tyre, profetët

dhe patriarkët, do të bëheshin të denjë për të trashëguar premtimin që Perëndia kishte përgatitur për ta.

13 Sepse Perëndia, kur i premtoi Abrahamit pasi s'kishte asnjë më të madh, mbi të cilin të betohej, u betua mbi veten e tij,

14 duke thënë: "Vërtet duke bekuar do të të bekoj, edhe duke shumuar do të të shumoj".

15 Edhe kështu *Abrahami*, duke pritur me durim, fitoi premtimin.

16 Sepse njerëzit betohen mbi më të madhin, edhe për ata betimi për të vërtetuar është fundi i çdo kundërshtimi.

17 Kështu Perëndia, duke dashur t'u tregojë më tepër trashëgimtarëve të premtimit pakthyeshmërinë e vullnetit të tij, vuri ndërmjetës betimin,

18 që me anë dy gjërash të pakthyeshme, në të cilat është e pamundur të gënjejë Perëndia, të mund të kemi ngushëllim të fortë, ne që kemi kërkuar një strehë, të mbajmë fort shpresën që kemi përpara,

19 të cilën e kemi si spirancë të shpirtit të sigurt e të vërtetë, edhe që hyn në të brendshmen e kurtinës;

20 atje ku një pararendës hyri për ne, Jisui, duke u bërë kryepriift në përjetësi sipas urdhrit të Melkisedekut.

Për t'i nxitur më tej lexuesit në qëndrueshmëri e në durim, autori u sjell një shembull të denjë të mishërimit të këtyre virtyteve, atin e tyre Abrahamin.

Edhe këtij të fundit Perëndia i bëri një premtim, të cilin e plotësoi pa dyshim. Kështu, për ta inkurajuar Abrahamin të qëndronte i patundur në besim, i premtoi atij, edhe **pasi s'kishte asnjë më të madh mbi të cilin të betohej, u betua mbi veten e tij.** Betimi është cituar tek Gjen. 22:17 sipas versionit të Septuagintës. Që Abrahami të merrte premtimin, duhej të ishte i gatshëm të sakrifikonte madje edhe birin e tij të vetëm, Isaakun, nëse ky do të ishte vullneti i Perëndisë për të. Si shpërblim për përkushtimin vetëmohues të Abrahamit ndaj Zotit, Ai i premtoi se do t'i jepte shumë pasardhës përmes Isaakut. Shkrimi origjinal në hebraisht pasqyrohet në përkthimin e Septuagintës në këtë formë: **"duke bekuar do të të bekoj dhe duke shumuar do të të shumoj"** ku koha e tashme e hebraishtes është zëvendësuar me pjesëzat e përdorura në greqisht, për efekt stilistikor përforcues të premtimit të Perëndisë.



Abrahami e pranoi fjalën e Tij dhe, **duke pritur me durim** dhe pa u dorëzuar, **fitoi premtimin**. Vërtet, përmes birit të tij Isaakut, pasardhësit e tij u shtuan dhe u shumuan si rëra e detit pluhuri i tokës (Gjen. 22:17).

Autori ndalet pak në mënyrën e betimit të Perëndisë. Ndërsa **njerëzit betohen mbi më të madhin**, kryesisht mbi zotët e tyre, **për ata betimi për të vërtetuar është fundi i çdo kundërshtimi**. Kjo do të thotë se fjala e dikujt që betohet i siguron të gjithë se do ta mbajë fjalën e dhënë. Kështu edhe Perëndia donte që Abrahami të kishte siguri të plotë se Ai do ta mbante premtimin e dhënë, dhe **duke dashur t'u tregojë më tepër trashëgimtarëve të premtimit** (pasardhësve të Abrahamit) **pakthyeshmërinë e vullnetit të tij, vuri ndërmjetës betimin**, duke u betuar mbi Vetën (ashtu sikurse njerëzit betoheshin për më të mëdhenjtë, dhe nuk ka asnjë më të madh se vetë Perëndia, Ai u betua mbi Vetën). Qëllimi ishte për ta siguruar plotësisht Abrahamin mbi vërtetësinë e fjalës së Tij. Për këtë arsye përdori **dy gjëra të pakthyeshme**: fjalën dhe betimin, **në të cilat është e pamundur të gënjejë Perëndia**. Kështu, nuk kishte vend për asnjë hije dyshimi tek Abrahami, dhe jo vetëm tek ai, por të gjithë **trashëgimtarët e premtimit**, që do të ishin pasardhësit e tij, duke përfshirë këtu edhe hebrejtë e krishterë të cilëve u drejtohet kjo letër. Premtimi për besnikërinë e Perëndisë vlente edhe për këta të fundit, që ata që kishin kërkuar një strehë tek Perëndia të kishin **ngushëllim të fortë e të mbanin fort shpresën që kishin përpara**. Njëpërmjet Ungjillit, atyre u ishte premtuar hyrja në lavdinë e përjetshme, nëse jetonin si dishepuj të denjë të Jisu Krishtit. Kjo ishte edhe shpresa që Perëndia kishte vënë përpara tyre si shpërblim. Duke kujtuar besnikërinë e Zotit ndaj Abrahamit dhe pasardhësve të tij, do të merrnin zemër duke besuar se edhe premtimi i tyre nuk do të mbeste pa u përmbushur.

Dhe sa fuqi të jashtëzakonshme ka fjala e Tij! Atë e kishin si spirancë të shpirtit, që do t'i mbante fort edhe kur stuhitë e jetës rrezikonin t'i përmbysnin të gjitha. Ky shpëtim ishte një siguri e vërtetë, e patundur, për të cilin kishin vërtet shumë nevojë, në atë kohë kur e gjithë bota e tyre dukej se do të shkatërrohej. Bashkëkombësit e tyre jo të krishterë sa vinin e bëheshin më të rreptë ndaj tyre, dhe (se jemi të saktë në përlllogaritjen e kohës kur u shkrua letra - viti 67 ps.K.) madje edhe jeta e tyre ishte tashmë në rrezik. Në Palestinë nuk kishte më siguri, dhe dimë se në vitin 70 pushtuesit romakë e shkatërruan plotësisht. Në këto dallgë të mëdha pasigurish dhe vuajtjesh, kishin më shumë se kurrë nevojë për një spirancë e sigurt shpëtimi. Vetëm duke shpresuar më Krishtin, që ka pushtet mbi qiejt dhe të gjithë dhenë, do të hynin në këtë shpëtim të shumëpritur.

Për më tepër, kjo shpresë **hyn edhe në të brendshmen e kurtinës**, në parajsë. Imazhi që na paraqitet (i cili do të analizohet edhe më tej në vazhdim të letrës) është ai i Tabernakullit tokësor, që krahasohet me atë qiellorin.

Në Tabernakullin tokësor ekzistonte një kurtinë që ndante Shenjtëroren nga Shenjtërorja e Shenjtëroreve, në të cilën ndodhej dhe Arka e Dhiatës. Ajo pjesë që konsiderohej si vendbanimi i Perëndisë në botë, krahasohet tashmë me fronin qiellor. Shpëtimi ynë është **i sigurt dhe i vërtetë**, sepse **Jisui hyri në të brendshmen e kurtinës si pararendës për ne**, që edhe ne të mund të hyjmë në jetën e përjetshme, në plotësinë e prezencës së Perëndisë. Përdorimi i termit “**pararendës**” nënkupton se ashtu siç Jisui hyri në praninë e përjetshme të Perëndisë, ashtu do të hyjmë edhe ne. Ai hapi udhën për ne, duke u bërë ura që ne bijtë të mund të rendim drejt Atit tonë. Në përfundim të fragmentit, autori e mbyll duke vazhduar mendimin e lënë tek 5:10, ku thotë se Jisui do të jetë **kryepriфт në përjetësi, sipas urdhrit të Melkisedekut**.

### 3.5. Kryepriфтëria e Krishtit si ajo e Melkisedekut (7:1-28)

Që nga kjo pikë, autori nis një analizë analitike rreth priфтërisë së Melkisedekut. Ky i fundit ishte një priфт-mbret bashkëkohës me Abrahamin, që sundonte në Salem (në jug të Palestinës). Historia e tij e plotë tregohet në kapitullin 14 të Gjenezës. Pasi Abrahami dhe shërbyesit e tij u kthyen nga një betejë, Melkisedeku, duke qenë mbret i vendit ku ai shkoi, doli ta priste dhe i shpuri bukë e verë, në shenjë mikpritjeje. Duke qenë mbret, Melkisedeku kryente edhe shërbesën priфтërore, dhe si priфт, bekoi edhe Abrahamin, në emrin e Zotit El Elion “Perëndia i Shumëlartë”. Abrahami, që besonte në Perëndinë Jahveh, e pranoi bekimin e tij dhe i dha një të dhjetën e çdo gjëje që kishte marrë si plaçkë lufte.

Është i çuditshëm fakti se ky person nuk përmendet asnjëherë më parë tek Gjenezja derisa e shohim të shfaqet papritur nga hiçi tek kapitulli 14, e të zhduket përsëri pas bekimit të Abrahamit. Kushdo që lexon Gjenezën nuk e pret kurrsesi shfaqjen e tij, dhe as nuk mund të kuptojë se me çfarë të drejte shërbente ai si priфт, pasi, sipas stilit të përshkrimit tek Gjenezja, përpara se dikush të prezantohet si priфт paraqitet e gjithë pema e tij gjenealogjike. Kjo e fundit shërben si dëshmi nëse personi i përket apo jo fisit të duhur për t’u bërë priфт. Një përshkrim i tillë mungon për Melkisedekun. Nuk na thuhet asgjë për origjinën e tij, nuk përmendet emri i të atit dhe madje nuk jepet asnjë e dhënë se çfarë ndodhi me të pasi bekoi Abrahamin.

Faktikisht, për të nuk thuhet më asgjë derisa e shohim të përmendet përsëri tek Psalmi 110 i Davidit, ku mbreti poet flet për pasardhësit e tij dhe thotë se do të gëzojnë një afërsi të tillë me Perëndinë, që zakonisht u jepet vetëm priftërinjve. Thotë gjithashtu se njëri prej tyre do të jetë “kryeprift përjetë, sipas urdhrit të Melkisedekut”. Pra sikurse Melkisedeku ishte mbret dhe prift i përjetshëm (pasi priftëria e tij rridhte nga prejardhja mbretërore), ashtu do të ishte edhe pasardhësi i Davidit. Sipas interpretimeve të mëvonshme të judenjve, këto vargje u panë si profetike për Mesian.

Autori përqendrohet tek figura e Melkisedekut sepse nëpërmjet jetës së tij, shfaqet madhështia e Krishtit, Kryepriftit të lartë të qiejve. Për një lexues hebre, do të ishte e natyrshme të dojë të dijë se nga vjen priftëria e Jisuit, qoftë në qiej apo kudo. Ai nuk ishte nga fisi i Judës, Levit apo Moisiut, ndërkohë që Ligji thoshte se priftërinjtë mund të dalin vetëm nga këto fise.

Përgjigja e kësaj pyetjeje qëndron në vargun profetik të Davidit (Ps. 110:4), ku thuhet se Mesia, që do të dilte nga trangu i Davidit, do të ishte kryeprift sipas urdhrit të Melkisedekut. Pra Kryepriftëria e Lartë e Jisuit buronte nga fakti se Ai ishte Mbreti, njësoj si në rastin e Melkisedekut. Duke qenë Mesi dhe Mbret, është edhe Kryeprift.

Kjo e bën më të lartë se çdo prift tjetër jude, sepse priftëria e Tij i takon një rendi shumë më të lartë. Sipas autorit, priftëria e Melkisedekut qëndronte shumë më lart se urdhri tjetër priftëror i Levit, që u themelua tek Ligji i Moisiut. Kështu kuptojmë se sa i pakrahasueshëm ishte Krishti me gjithë priftërinjtë e tjerë të Tempullit të Jerusalemit. E si mund t’i shkonte ndër mend lexuesve ta braktisnin Atë që ishte superior ndaj të gjithëve?

- 1 Sepse ky Melkisedeku, ishte mbreti i Salemit, prift i fort të lartit Perëndi, i cili u takua me Abrahamin kur ky kthehej nga shpartallimi i mbretërve, edhe e bekoj.**
- 2 Atij Abrahami i ndau edhe të dhjetën e të nga gjithave, i cili së pari përkthehet mbret i drejtësisë, edhe pastaj edhe mbret i Salemit, që do me thënë mbret i paqes,**
- 3 pa atë, pa nënë, pa gjenealogji, pa pasur as fillim ditësh, as fund jete, por bërë i ngjashëm me Birin e Perëndisë, mbetet prift përgjithnjë.**

Këtu autori fillon të krijojë lidhjet. Duke analizuar figurën e Melkisedekut sipas kapitullit 14 të Gjenezës, ai shfaqet si një lloj pararendësi i Mesisë.

**Melkisedeku ishte mbreti i Salemit**, një qyteti në pjesën jugore të Palestinës që me shumë gjasë identifikohet me Jerusalem. Emri Salem lidhet me fjalën hebraike *shalom* (paqe), prandaj autori e përshkruan si mbreti i paqes. Vetë emri Melkisedek përkthehet **mbret i drejtësisë** (fjalë për fjalë ndoshta “Mbreti ynë është i drejtë”, ku ‘mbreti’ i referohet Perëndisë). Duke e përshkruar atë si mbret të **paqes** e të **drejtësisë**, autori nxjerr në pah ngjashmërinë e tij me Krishtin, i Cili është i vetmi që i takojnë këto tituj. Të gjithë mbretërit e tjerë përgjatë historisë u përlyen me gjak dhe ishin edhe ata njerëz të rënë dhe mëkatarë. Melkisedeku, i përshkruar me këto karakteristika, del si parafigurim i Mesisë që pritej.

Të tjera cilësi të Melkisedekut dalin në pah edhe falë të dhënave që jepen për të, ose më saktë, të dhënave që mungojnë. Në traditën judaike ishte komplet e pazakontë që një prift të prezantohej **pa atë, pa nënë dhe pa gjenealogji**, duke qenë se këto të dhëna ishin thelbësore për të dëshmuar për priftërinë e dikujt.

Nuk përmendet as **fillimi i ditëve** të tij (kur lindi) dhe **as fundi i jetës** (çfarë ngjau me të më pas). Sikur të jetë shfaqur papritmas nga hiçi e të jetë zhdukur përsëri.

Përderisa nuk kemi asnjë të dhënë për fundin e tij, mbetet **prift përgjithnjë**. Ky person mistik, i bërë i ngjashëm me Birin e Perëndisë, me shfaqjen e befasishme tek Gjeneza bëhet pararendësi i përshtatshëm për Mesinë që do të vinte.

Meqenëse përgjatë historisë së Kishës ka pasur shumë paqartësi lidhur me interpretimin e këtyre vargjeve, duhet të shtojmë që autori nuk do të thotë se Melkisedeku nuk njohu vdekje dhe se vazhdon të jetë i gjallë. Madje autori nuk fokusohet aspak në përshkrimin e tij si person historik. Si çdo njeri, edhe ai padyshim ka vdekur në një moment. Megjithatë, fokusi i autorit mbetet tek përshkrimi i figurës dhe domethënies së tij.

**4 Pa mendoni sa i madh ishte ky, të cilit Abrahami, kryeati, i dha edhe të dhjetën e plaçkës.**

**5 Edhe nga të bijtë e Levit ata që marrin priftërinë, kanë urdhërimin të marrin sipas ligjit të dhjetën nga populli, domethënë nga vëllezërit e tyre, ndonëse kanë dalë nga mesi i Abrahamit.**

**6 Po ai që nuk e kishte gjenealogjinë nga ata mori të dhjetën nga Abrahami, edhe bekoj atë që kishte premtimin.**

**7 Edhe pa asnjë kundërshtim më i vogli bekohet nga më i madhi.**

8 Edhe këtu njerëz të vdekshëm marrin të dhjeta; po atje *merr të dhjeta* ai që dëshmohet se rron.

9 Edhe që të them kështu, me anë të Abrahamit edhe Leviu, që merr të dhjeta, dha të dhjeta.

10 Sepse ishte ende në mesin e të atit, kur e takoi Melkisedeku atë.

Pas analizës së figurës së Melkisedekut si pararendës i Krishtit, autori i fton lexuesit të **mendojnë** se **sa i madh ishte ai, të cilit Abrahami i dha edhe të dhjetën e plaçkës** së betejës. Meqenëse u tha se Krishti është Kryepriфт “sipas urdhrit të Melkisedekut”, nevojitet të theksohet se kjo priфтëria e Melkisedekut ishte më e lartë se ajo e Aaronit. Nuk do të kishte aspak kuptim të thuhej e kundërta, pra se priфтëria e Krishtit ishte inferiore krahasuar me atë judaike, thjesht si diçka për të ngushëlluar të krishterët të cilëve do t’iu ndalohej pjesëmarrja në Tempull. Përkundrazi, autori u siguron lexuesve të tij se edhe nëse do t’i dëbonin nga Tempulli përsëri do të kishin një Kryepriфт shumë më të lartë se të tjerët, për të Cilin ia vlen çdo sakrificë.

Në mbështetje të argumentit për epërsinë e priфтërisë së Krishtit, ai dëshmon se priфтëria e Melkisedekut kishte epërsi ndaj asaj të Aaronit. Fakti që vetë Melkisedeku **mori të dhjetën** nga Abrahami, dhe **e bekoj atë që kishte premtimin**, tregon se qëndronte më lart sesa ky i fundit.

Abrahami ishte në dijeni dhe e pranonte këtë gjë, pasi ai vetë i dha pjesën e plaçkës, që konsiderohej si një lloj shpërblimi. Gjithashtu, këtë e dëshmon marrja e bekimit nga një priфт, pasi **pa asnjë kundërshtim, më i vogli bekohet nga më i madhi**. Duke qenë më i madh se Abrahami, Melkisedeku ishte më i madh edhe se pasardhësi i tij **Levi** (themeluesi i priфтërisë Levitike që shërbenin në Tempullin e Jerusalemit). Disa mund të mendojnë se përderisa Levi ishte pasardhës i Abrahamit, ishte jo më pak i lartë se ai, e për pasojë, më i lartë edhe se Melkisedeku. Mirëpo autori i siguron për të kundërtën. Duke bekuar Abrahamin, Melkisedeku tregoi superioritetin e tij edhe ndaj Levit, meqë ky i fundit **ishte ende në mesin e të atit, kur e takoi Melkisedeku atë**. Kështu, **me anë të Abrahamit edhe Leviu, që merr të dhjeta** nga populli i tij hebre që ishte nën Ligj, **i dha të dhjeta Melkisedekut**, duke e njohur atë si më të lartë se vetja.

Argumenti që përmendëm së fundmi mund të tingëllojë i çuditshëm për veshët tanë, meqenëse është shumë larg kulturës së sotme individualiste, ku secili person identifikohet vetëm me vetveten. Dimë se përgjatë historisë biblike, çdokush

identifikohet sipas gjenealogjisë përkatëse. Sipas këtij botëkuptimi, origjina dhe grupi shoqëror luan rol përcaktues për gjithsecilin, si biologjikisht ashtu edhe nga ana shpirtërore. Padyshim, kjo nuk nënkupton se thirrja e Perëndisë kufizohet brenda kontureve të grupeve shoqërore përkatëse, por se sipas traditave të lashta të Lindjes së Mesme, pozita e një personi në shoqëri përcaktohet nga origjina e tij. Pra autori nuk po mundohet t'u imponojë lexuesve pikëpamjen e tij, por i fton t'i vëzhgojnë ngjarjet përmes kontekstit të caktuar historik.

**11 Po të ishte pra përsosmëria me anë të priftërisë Levitike, - sepse populli mbi atë mori ligjin, - ç'nevojë ishte pra të ngrihet tjetër prift sipas urdhrit të Melkisedekut, e të mos thuhet më sipas urdhrit të Aaronit?**

**12 Sepse kur ndërrohet priftëria, nga nevoja bëhet edhe ndërrim ligji.**

**13 Sepse ai, për të cilin thuhet këto, ishte prej tjetër fisi, prej të cilit asnjë s'i që afroar theores.**

**14 Sepse është e ditur që Zoti ynë lindi nga Juda, fis për të cilën Moisiu nuk foli asgjë për priftëri.**

Në këtë paragraf autori përmend përfundimet e argumentimit të tij. Në Shkrimin e Shenjtë (Ps. 110:4) thuhet se priftëria e Mesisë do të ishte sipas urdhrit të Melkisedekut që përmendëm edhe në fragmentet paraardhëse. A nuk vlen vetëm ky pohim për të kuptuar se priftëria e Tempullit ishte e papërsosur dhe e pamjaftueshme për të hyrë në Mbretërinë e Perëndisë? Sepse, nëse përsosmëria arrihet me anë të priftërisë levitike, **ç'nevojë do të kishte që të ngrihej një tjetër prift (Mesia) sipas urdhrit të Melkisedekut, e të mos thuhet më sipas urdhrit të Aaronit?** Pra përse duhet që priftëria e Mesisë të ndryshonte nga ajo Levitike?

**Sepse është e ditur (gr. *prodelon*) që Zoti ynë lindi nga Juda, fis për të cilën Moisiu nuk foli asgjë për priftëri.** Sipas mënyrës që Perëndia e kishte organizuar rendin priftëror në Ligjin e Moisiut, askujt nga fisi i Judës nuk lejohej t'i afrohej theores. Kjo detyrë ishte caktuar vetëm për fisin e Levit. E megjithatë, Jisui vinte nga fisi i Judës (sipas mishit), e gjitha kjo sipas ekonomisë së Perëndisë. Nuk do të kishte qenë aspak e vështirë për Zotin që ta caktonte Krishtin nga fisi i Levit, nëse ky do të kishte qenë vullneti i Tij. Kështu, Jisui do të kishte priftërinë Levitike.

Cila ishte arsyeja që Perëndia i caktoi gjërat në mënyrë të tillë që priftëria e Mesisë të ndryshonte nga ajo e Levit?

Arsyeja qëndron pikërisht në faktin se kjo lloj priftërie nuk mund të arrinte në përsosmëri (v.11,19). Prandaj Ligji u gërshetua me priftërinë Levitike, që **kur të ndërrohet priftëria, nga nevoja të bëhet edhe ndërrim ligji**. Për kohën në të cilën u dhanë, Ligji dhe priftëria tokësore Levitike ishin të mjaftueshme për të realizuar atë çka donte Perëndia në atë kohë. Megjithatë, ato nuk kishin fuqi të pastronin shpirtrat e mëkatarëve dhe t'i nxisnin në transformim të brendshëm. Pra nuk ishin të mjaftueshme për Mbretërinë e Perëndisë, prandaj edhe Mesia duhet të kishte një tjetër priftëri.

Le të mundohemi pak të imagjinojmë sesa radikale tingëllon për një hebre (siç ishte dhe autori) të diskutojë për **ndërrim ligji**. Dimë se ata e konsideronin Ligjin të pandryshueshëm e të përjetshëm, Fjalën e Perëndisë drejtuar popullit të Tij Izraelit, dhe mbarë botës. As nuk mund të mendohej që Ligji të ndryshohej a të ndërrohej (krahaso me 8:13). Por pikërisht këtë thotë autori. Për të, fakti që priftëria e Mesisë ndryshonte nga ajo e Levit, nënkuptonte se e gjithë struktura e Ligjit, e lidhur pazgjidhshmërisht me këtë priftëri, duhet të transformohej e të ndërrohej.

Për këtë arsye, domethënia e vargut të shkurtër për priftërinë mesianike sipas urdhrimit të Melkisedekut, është shumë e madhe dhe shkon përtej kohërave.

**15 Por është edhe shumë më tepër e qartë, nëse sipas shëmbëllimit të Melkisedekut ngrihet tjetër prift,**

**16 i cili nuk u bë sipas ligjit të urdhërimit të mishit, por sipas fuqisë të jetës pambarim.**

**17 Sepse ai dëshmon, duke thënë: "Se ti je prift përjetë sipas urdhrimit të Melkisedekut".**

**18 Sepse urdhërimi i parë bie poshtë, kur është i dobët dhe i padobishëm;**

**19 sepse ligji nuk mbaroi asnjë lloj pune, po futi një shpresë më të mirë, me anë të së cilës i afrohem Perëndisë.**

Autori vijon duke krahasuar Krishtin me kryepriftërinjtë e tjerë Levitikë përgjatë shekujve. Kështu e përforcon edhe më tepër argumentin e tij, duke e kthyer nga "të qartë" (gr. *dilon*) apo "shumë të qartë" (gr. *prodilon*) në "**shumë më tepër të qartë**" (gr. *perisoteron katadilon*). Duke parë krahasimin e Krishtit me priftërinjtë e tjerë të Tempullit të Jerusalemit, kushdo mund të kuptojë qartë se kësaj priftërie të vjetër po i vinte fundi.

Kjo për disa arsye: Së pari, priftërinjtë Levitikë ishin njerëz të vdekshëm (v.8) dhe ndërroreshin shpesh pasi “ndaloheshin prej vdekjes të mbeten përgjithnjë” (v.23). Përkundrazi, Krishti nuk u caktua **sipas ligjit të urdhërimit të mishit** (një ligji që trajton gjërat e mishit dhe mbetet në to) **por sipas fuqisë së jetës pambarim**, jashtë çdo kufizimi të mishit dhe botës. Duke qenë **sipas shëmbëllimit të Melkisedekut** (fundi i jetës së të cilit nuk përmendet në Shkrimet - v.3) Krishti rron përjetë (v.8).

Në kontekstin origjinal të Psalmi 110:4: “Ti je prift përjetë sipas urdhrit të Melkisedekut”, fjala “përjetë” nënkupton se Perëndia nuk do t’ia heqë kurrë priftërinë mbretit. Por kuptimi i vërtetë i saj është shumë më i thellë nën dritën e Krishtit, dhe dëshmon se Ai ka **jetë pa mbarim** dhe mbetet Kryeprift i Qiejve, ku qëndron triumfues pas Ngjalljes së Tij të lavdishme.

Ky krahasim tregon qartazi se Perëndia e hodhi poshtë **urdhërimin e parë**, duke qenë ky **i dobët e i padobishëm**. Vetë Ligji nuk mbaroi asnjë lloj pune, pra nuk arriti të ta transformojë natyrën e rënë dhe mëkatore të njeriut, prandaj nuk kishte vend në Mbretërinë Qiellore. Por përmes Kryqëzimit dhe Ngjitjes në Qiej të Krishtit na u dha **një shpresë më e mirë, me anë të së cilës i afrohemi Perëndisë** dhe transformojmë shpirtat tanë.

**20 Edhe meqenëse nuk u bë prift pa betim,**

**21 Sepse ata qenë bërë priftërinj pa betim, po ky me betim, me anë të atij që i tha atij: "Zoti u betua, edhe nuk do të pendohet. Ti je prift përjetë sipas urdhrit të Melkisedekut",**

**22 i një dhiate më të lartë u bë dorëzanë Jisui.**

**23 Edhe ata qenë bërë priftërinj më shumë se një, sepse ndaloheshin prej vdekjes të mbeten përgjithnjë.**

**24 Por ky, pasi mbetet për gjithë jetën, e ka priftërinë të pandërrueshme.**

**25 Prandaj edhe mund t'i shpëtojë krejtësisht ata që afrohen pranë Perëndisë me anë të atij, sepse gjithnjë rron që të ndërmjetojë për ata.**

Autori vijon me krahasimin e priftërisë së Krishtit me Levitët, duke synuar të shfaqë epërsinë e Tij ndaj tyre.

Kur Perëndia i dha Jisuit priftërinë, nuk ia dha pa u betuar më parë, ndërsa Levitët **qenë bërë priftërinj pa betim**. Këta të fundit u caktuan për të shërbyer në theroren



tokësore (Eks. 28:1), por nuk iu premtua priftëria e përjetshme. Fakti që në rastin e Krishtit, ky caktim u shoqërua edhe me vulën e betimit, e bën atë më të madh sesa priftërinjtë e Tempullit.

Këtë e shohim të shprehur edhe në Psalmin 110:4, ku thuhet: **“Zoti u betua, edhe nuk do të pendohet. Ti je prift përjetë..”** Përveç faktit se e shpalli prift të përjetshëm, duke deklaruar se u betua dhe nuk do të pendohet, Perëndia shpreh vendosmërinë për të themeluar një priftëri të re, shumë më të lavdishme se ajo e Aaronit.

Kështu, **Jisui u bë dorëzanë i një dhiate më të lartë.** Ai do të **mbetet për gjithë jetën**, duke pasur një **priftëri të pandërrueshme.** Vdekja nuk mund të ketë pushtet mbi të, sepse Perëndia i dha jetë pa mbarim (v. 15-16). **Prandaj edhe mund t'i shpëtojë krejtësisht** (gr. *eis to panteles* - në të gjitha kohërat) **ata që afrohen pranë Perëndisë me anë të atij.** Nëse një dishepull i Tij merr pjesë në mbledhjet adhuruese, afrohet më tepër me fronin e hirit (4:16), me Jerusalemin Qiellor dhe kupton se gjaku i Jisuit flet më mirë se ai i Abelit (12:22, 24). Falë ndërmjetimit të Krishtit, Kryepriftit të Madh, çdokush prej nesh mund t'i afrohet Perëndisë me guxim, sepse Ai gjithnjë rron që të ndërmjetojë për ne. Kjo nuk duhet të kuptohet mekanikisht, pra sikur Jisui është përjetë i lidhur me një varg të gjatë lutjesh që ia paraqet Atit. Përkundrazi, Ai vetë është ndërmjetimi, Ai, Qengji i therur (Zb. 5:6) dhe prezenca e Tij në të djathtë të Atit.

Nuk na është zbuluar natyra e Krishtit në lavdinë e Tij të plotë, që tejkalon çdo kufizim kohe dhe hapësire. As nuk mund ta perceptojmë dot se si mund të jetë i kudondodhur dhe të dëgjojë të gjithë sa i luten dhe i drejtojnë kërkesa të ndryshme, por ama jemi të sigurt se është gjithnjë i pranishëm dhe dëgjon çdo lutje. Megjithatë, nuk është kjo tema që trajton autori në këtë fragment. Ai tregon se si ne, Kisha e Perëndisë, mund t'i afrohem Atij pavarësisht natyrës tonë mëkatore, falë gjakut të spërkatur të Jisu Krishtit.

**26 Sepse i tillë kryeprift na duhej, i shenjtë, i pafajshëm, i papërlyer, i ndarë nga mëkatarët dhe i bërë më i lartë se qiejt;**

**27 i cili nuk ka përditë nevojë, si ata kryepriftërinjtë, të blatojë therorë më përpara për mëkatet e tij, dhe pastaj për ato të popullit; sepse këtë e bëri një herë e përgjithmonë, kur pruri theror veten e tij.**

**28 Sepse ligji vë kryepriiftërinj njerëz që kanë dobësi; po fjala e betimit që u bë pas ligjit vuri Birin, i cili është i përsosur për gjithë jetën.**

Natyra transhendente e Mbretërisë së Perëndisë e kërkonte me patjetër një **kryepriift të tillë**, të lartë e transhendent. Në këtë Mbretëri nuk ka më vdekje, dhe të gjithë sa hyjnë në Të përsosën, shërohen nga plagët e mëkatit dhe transformohen e bëhen të pavdekshëm. Prandaj edhe kryepriifti që mundëson udhën e shpëtimit duhet të jetë pa mëkat e vdekja të mos ketë pushtet mbi të.

Krishti qëndron në të djathtë të Atit, i shenjtë, (gr. *osios* - krahaso përdorimin tek Tito 1:8) i pafajshëm e i papërlyer. Në ndryshim nga kryepriiftërinjtë e tjerë të cilët ata njihnin (si Ana apo Kajafa), Krishti është **i ndarë nga mëkatarët** dhe pa asnjë lidhje me ta. Ai është bërë **më i lartë se qiejt**, përtej çdo intrige, korrupsioni apo dobësie morale nga të cilat nuk shpëtonin dot as kryepriiftërinjtë e kësaj bote.

Të gjithë ata ishin mëkatarë dhe u nevojitej më parë **të blatonin therore për mëkatet e tyre, dhe pastaj për ato të popullit**. Edhe më i larti ndër ta (këtu mund të sjellim ndër mend kryepriiftin Simeon, të birin e Onias, për të cilin flitet tek Siraku 50:1-21) nuk ishte pa **dobësi**.

Por Krishti qëndron shumë më lart sesa të gjithë ata. Ai nuk ka nevojë **të blatojë theror** ditë për ditë në altar, **sepse këtë e bëri njëherë e përgjithmonë, kur pruri theror veten** mbi kryq. Ligji vë kryepriiftërinj njerëz që kanë dobësi dhe vepra e të cilëve nuk i tejkalon kufijtë e mëkatit dhe të vdekjes. Prandaj **fjala** e Perëndisë, e dhënë nëpërmjet **betimit** profetik që do të mbesë përjetë (Ps. 110:4) **vuri Birin, i cili është i përsosur për të gjithë jetën** dhe i paprekur nga kthetrat e vdekjes.

### **3.6. Priiftëria e Krishtit është më e lartë se ajo e Aaronit (8:1 - 10:18)**

**1 Edhe përmbledhja e atyre që themi është kjo: Kemi një kryepriift të tillë, i cili ndenji në të djathtë të fronit të madhërisë në qiejt,**

**2 edhe një shërbyes i shenjtërores dhe i tendës së vërtetë, të cilën e ngriti Zoti, e jo njeri.**

Pas krahasimit të detajuar të priiftërisë së Melkisedekut dhe asaj levitike, autori bën një përmbledhje (gr. *kefalion*, që fjalë për fjalë përkthehet "koka" ose "më kryesorja") të

të gjithë argumentit të tij, duke thënë: “Kemi një kryepriift të tillë, Jisuin, i **cili ndenji në të djathtë të fronit të madhërisë në qiejt**, duke pasur të njëjtin pushtet me Atin (mënyra që i referohet Perëndisë si “Madhëri i qiejve” është tipike e judenjve). Jisui qëndron pranë Atit si një **shërbyes i shenjtërores dhe i tendës së vërtetë**, Tabernakullit qiellor, **të cilën e ngriti Zoti, e jo njeriu**. Fjala “shërbyes” që në greqisht është shkruar *leitourgos/ litourgia* (emër) përdoren tek Septuaginta për shërbesat dhe ritualet e priftërinjve në Tempull (krahaso me Eks. 28:35 LXX ku tregohet për Aaronin i cili shërbente (*leitourgein*) veshur me stolinë e tij priftërore). Krishti shërben si kryepriift duke ofruar të shenjtat para Perëndisë. Meqë në rastin e Tij bëhet fjalë për një priftëri qiellore, është pakrahasueshmërisht më e lavdishme se ajo e priftërinjve levitë.

**3 Sepse çdo kryepriift vihet që të blatojë dhurata e therorë; prandaj është e nevojshme të ketë edhe ky diçka për të blatur therore.**

**4 Sepse po të ishte mbi dhé, nuk do të ishte priift, sepse janë priftërinjtë që sjellin dhuratat sipas ligjit;**

**5 të cilët shërbejnë sipas shembullit dhe sipas hijes së qielloreve, siç i qe thënë Moisiut, kur kishte për të ndërtuar tendën, sepse "Shiko", thotë ai, "t'i bësh të gjitha sipas formës që t'u tregua ty në mal".**

Duke qenë Kryepriift, është e nevojshme edhe për Krishtin të ketë diçka për të blatur therore, si çdo kryepriift tjetër. Po për çfarë shërbimi dhe blatimi bëhej fjalë?

Nuk mund të ishte diçka e ngjashme me blatimet e Tempullit, që ofronin kafshë të ngordhura, pasi Krishti nuk është thjesht një version më i ngritur dhe hyjnor i levitëve. **Sepse po të ishte mbi dhé, nuk do të ishte priift, sepse janë të mjaftueshëm priftërinjtë që sjellin dhurata** të tilla siç përmendëm **sipas ligjit**. Nuk nevojitej që të shtohet edhe Krishti në radhët e tyre.

Priftëria e Krishtit është transhendente, hyjnore dhe ndryshon nga priftëria e Tempullit ashtu siç qielli ndryshon nga toka.

Priftërinjtë levitë, të cilët shërbenin në shenjtëroren tokësore, shërbejnë (gr. *latrevo* - krahaso me përdorimin tek Vep. Ap. 7:7) **sipas shembullit** të shenjtërores qiellore, duke qenë thjesht një **hije** e parafigurim i realitetit hyjnor.

Për këtë dëshmohej që nga udhëzimi që Perëndia i dha **Moisiut, kur kishte për të ndërtuar tendën**. Në atë kohë, teksa ndodheshin në Malin Sina, Perëndia i mësoi Moisiut çdo detaj për mënyrën se si duhet ta ndërtonte shenjtëroren, duke i shfaqur edhe një vegim të lavdisë së Tij mbi mal. Më pas, kur erdhi koha për ndërtimin e saj, Perëndia iu referua pikërisht atij vizioni si **formë** (gr. *tipos*, shih Eks. 25:40 LXX) a model ndërtimi. Shenjtërorja tokësore do të funksiononte si një lloj parafigurimi i asaj hyjnore, vendbanimi i Tij mes njerëzve si parafigurim i fronit të Tij qiellor. Priftërinjtë levitë shërbenin pra sipas këtij shembulli, kurse Krishti shërben në shenjtëroren hyjnore.

## DISKUTIM

### Mbi Tempullin dhe Shenjtëroren si antitipa

Në kohërat e lashta, koncepti i Platonit mbi “tipat” dhe “antitipat” (gr. *tipos* dhe *antitipos*) ishte shumë i përhapur. Sipas këtij filozofi, ekzistojnë realitetet transhendente, të cilat ai i quan “ide” ose tipa dhe realitetet e kësaj bote, të cilat janë thjesht kopje të zbehta të atyre hyjnore. Këto ai i quajti kopje ose antitipa. Në kohën kur jetuan apostujt, edhe ata të cilët nuk i mbështesnin idetë Platonike, përsëri i përdornin këto terma, pasi qenë pranuar si të vërteta universale.

Që në kohërat e babilonasve, njerëzit mendonin se tempujt kushtuar perëndive ishin imazhe të banesave të tyre qiellore, pasi termat “tempull” dhe “banesë” përdorreshin si për tokësoret, ashtu edhe për qielloret. Këtë e shohim edhe në Dhiatën e Vjetër, në Psalmi 18:6, ku Davidi shkruan se Perëndia e dëgjoi nga “Tempulli i Tij”, pra nga banesa e Tij qiellore, ndërsa Tempulli i Solomonit nuk ishte ndërtuar ende.

Duke e parë në këtë kontekst historik, është normale që hebrenjtë bashkëkohës me Krishtin të mendonin se Shenjtërorja që ndërtoi Moisiu ishte një imazh i banesës qiellore të Perëndisë. Filo (hebre nga Aleksandria dhe ithtar i ideve të Platonit, që ishte gjithashtu bashkëkohës i Krishtit) shkroi se Moisiu “arriti që përmes syve të shpirtit të shihte idetë e fshehura pas objekteve materiale (të shenjtërores)” (*Jeta e Moisiut, kap. II*). Pra, sipas tij, kur Moisiu gjendej në Malin Sina, u denjësua të shihte “idenë” qiellore të Shenjtërores dhe të gjithë elementeve të saj, banesën qiellore të Perëndisë, tipin. Në bazë të këtij tipi, ai ndërtoi më pas shenjtëroren tokësore, pra antitipin.

Ky lloj mendimi reflektoret edhe tek Urtësia e Solomonit 9:8, ku shkruhet: “..më urdhërove (Perëndia) të ndërtoj tempullin në malin tënd të shenjtë, e altarin në qytetin e banimit tënd, në gjedhen e Tendës së shenjtë, që e përgatite prej fillimit”. Në thelb është i njëjti mendim si i Filos: Perëndia ka përgatitur një shenjtërore qiellore, si banesë të Tijën “që prej fillimit” dhe shenjtërorja tokësore e Tempullit të Jerusalemit është thjesht një “kopje” e saj.

Të njëjtat terma si më lart përdoren dhe nga autori i kësaj letre. Pa u ndalur në mendimet e Platonit, ai tregon se Moisiut iu shfaq Perëndia në lavdinë e Tij (*tipos*) dhe shenjtërorja që ndërtoi ishte një parafigurim i lavdisë së Tij (*antitipos*). Sipas këtij perceptimi, të gjitha shërbesat tokësore në Tempull mbeten thjesht antitipa të realiteteve hyjnore, parafigurime të Shenjtërores Hyjnore të Krishtit.

Blatat e priftërinjve levitë, pavarësisht të gjithë pompozitetit të tyre, mbeteshin “antitipa”, ndërsa Krishti, Kryepriifti i Lartë i Qiejve, është Blatuesi i vërtetë dhe “tipi” i mirëfilltë.

**6 Po tani Krishti mori një shërbesë aq të shquar, sa është edhe ndërmjetës i një dhiate më të mirë, e cila u bë ligj mbi premtime më të mira.**

**7 Sepse po të ishte pa të metë ajo e para, nuk do të kërkohej vend për të dytën.**

**Krishti mori një shërbesë** (gr. *leitourgia*) shumë të shquar, një priftëri të përsosur. Për këtë arsye, e përsosur është edhe **dhiata** për të cilën u bë **ndërmjetës**, pasi ajo **u bë ligj mbi premtime më të mira**. Pra dhiata që solli Krishti e udhëheq popullin e Perëndisë tek Zoti, në një mënyrë që dhiata e vjetër nuk mund t’ia arrinte dot kurrë. Epërsia e pashoqe e dhiatës së Krishtit mbi atë Judaikë dëshmohej mbi të gjitha nga vetë ekzistenca e saj. **Sepse po të ishte pa të metë ajo e para**, dhe po të arrinte t’i përmbushte të gjitha ato çka duheshin për të hyrë në Mbretërinë e Perëndisë, **nuk do të kërkohej vend për të dytën**. Fakti që Perëndia anashkaloi priftërinë e Tempullit duke caktuar Krishtin si Kryepriift të Lartë përpara Tij tregon pamjaftueshmërinë e priftërisë levitike.

**8 Sepse Perëndia duke qortuar ata thotë: "Ja tek po vijnë ditë, thotë Zoti, edhe do të bëj një dhiatë të re me shtëpinë e Izraelit dhe me shtëpinë e Judës,**

9 jo sipas dhiatës që bëra me etërit e tyre atë ditë që i mora ata prej dore, që t'i nxirrja jashtë prej dheut të Egjiptit; sepse ata nuk qëndruan në dhiatën time, edhe unë s'u kujdesa për ata, thotë Zoti.

10 Sepse kjo është dhiata që do të bëj me shtëpinë e Izraelit pas atyre ditëve, thotë Zoti, do të vë ligjet e mia në mendjet e tyre, edhe do t'i shkruaj ata mbi zemrat e tyre, edhe do të jem Perëndia i tyre dhe ata do të jenë populli im.

11 Edhe asnjë prej tyre nuk do të mësojë të afërmin e tij dhe asnjë të vëllanë e tij, duke thënë: Njih Zotin; sepse të gjithë do të më njohin, që prej të voglit të tyre e deri në më të madhin e tyre.

12 Sepse do të jem i mëshirshëm në paudhësitë e tyre, edhe nuk do të kujtoj më mëkatet e tyre dhe paligjësitë e tyre".

Të thuash se Ligji i Moisiut është i pamjaftueshëm është e papercptueshme për një hebre. Për ta Ligji është i përjetshëm dhe i lavdishëm, pra me ç'të drejtë autori e bën një pohim të tillë?

Për të argumentuar qëndrimin e tij, ai vepron si zakonisht sipas traditës judaike, duke cituar një varg të Shkrimeve, konkretisht Jer. 31:31-34. Fakti se dhiata ekzistuese nuk ishte e përsosur dëshmohej nga **qortimi** që Perëndia i bëri atyre duke i thënë se do të bënte **një dhiatë të re**, që t'i hapte dyert për në Mbretërinë e Tij. Nëse dhiata e vjetër do të ishte e mjaftueshme për të hyrë në Mbretëri, as do të ishte nevoja për një të re.

Për më tepër, **dhiata e re** që Perëndia do të bënte me shtëpinë e Izraelit do të ishte **jo sipas dhiatës që bëri me etërit e tyre atë ditë që i mori me dashuri nga dora për t'i nxjerrë jashtë dheut të Egjiptit**, në kohën e profetit Moisi. Kjo besëlidhje kishte kufizimet e veta për shkak të apostazisë së vazhdueshme të popullit. Kishte aq shumë raste ku Izraeli **nuk qëndroi në dhiatën** e Perëndisë, dhe prandaj Ai s'u kujdes për ata dhe i la të binin në duart e armiqve të tyre (shih Gjyq. 2:11-21). Ligji i Moisiut nuk mund të bënte asgjë më tepër sesa të mësonte për të vërtetën dhe drejtësinë, por nuk mund t'i ndihmonte e t'i nxiste njerëzit që të ecnin në udhën e drejtësisë, gjë që vërtetohet më së miri nga historia e popullit të Izraelit. Prandaj kjo dhiatë mbeti diçka sipërfaqësore, e gdhendur vetëm në rrasa guri (2 Kor. 3:3).

Përkundrazi, besëlidhja e re do të shkruhej në **zemrat** e njerëzve, duke depërtuar deri në thellësi të natyrës njerëzore e duke transformuar shpirtat në mënyrë që ligjet e Perëndisë të gdhenden në mendjet e gjithsecilit. Pas kësaj, nuk do të kishte më

nevojë për profetë që t'i qortonin njerëzit në rast apostazie, duke i nxitur në pendim e duke thënë "Njih Zotin!", sepse të gjithë do ta njohin, që prej të voglit të tyre e deri në më të madhin e tyre.

Kjo do të shënonte edhe përmbushjen e premtimeve të lashta për një komunikim personal të Perëndisë me njerëzit, ku Ai do të jetë Perëndia i tyre, duke i ofruar mbrojtjen dhe bekimet e Tij, dhe ata do të jenë populli i Tij besnik. Kaq thelbësor do të ishte transformimi i shpirtave të njerëzve sa që Zoti do të ishte i mëshirshëm në paudhësitë e tyre dhe nuk do të kujtonte mëkatet dhe paligjësitë e tyre. (Në greqisht theksohet shumë pjesëza mohuese "nuk" - gr. *ou*).

Thirrja "kujto" që e shohim të përmendur shumë herë në Shkrimin e Shenjtë, nuk ka vetëm synim të sjellë diçka ndër mend, por ushton më tepër si një thirrje për të vepruar. Kështu edhe Perëndia e "kujtoi" popullin e Tij teksa ishte nisur për betejë, duke i mundësuar fitoren (Num. 10:9), por edhe në rastin e vejushës në Sareptë të Sidonës, e cila mendoi se Perëndia kishte kujtuar mëkatet e saj dhe prandaj e kishte lejuar që të prekej nga fatkeqësia (1 Mb. 17:18). Perëndia gjithashtu i "kujtoi" mëkatet e popullit të Vet kur i gjykoi për pabesinë e tyre.

E gjithë kjo do t'i përkiste tashmë të kaluarës. Izraeli i besëlidhjes së re përjeton transformim rrënjësor përmes pësimimit të pashembullt të Krishtit, dhe nuk ka vend më për gjykime të tilla si më parë (si p.sh në kohën e robërisë Babilonase). Kështu shohim kjo besëlidhje e re e themeluar mbi priftërinë e Krishtit është vërtet shumë më e lartë sesa e vjetra, të cilës i shërbenin priftërinjtë levitë (v.6), sepse mban premtimin e transformimit dhe pastrimit të brendshëm shpirtëror.

### **13 Duke thënë "një dhiatë e re" e vjetërsoi të parën; edhe ajo që vjetërsohet e plaket është afër prishjes.**

Në fund të citimit të profecisë së Jeremias (31), autori e mbyll me një përmbledhje të mendimit të tij. "Një dhiatë e re" nënkuptonte jo vetëm pamjaftueshmërinë e të parës, por gjithashtu se vjetërsimin e saj. Në greqisht, ekuivalentja e fjalës "vjetërsim" është "*palio*" (e përdorur edhe tek 1:11 ku i referohet vjetërsimit të të gjithë botës) që do të thotë "i vjetër".

Ky cilësim i bërë ndaj dhiatës së vjetër tregonte se ajo ishte tashmë e **plakur** (gr. *gerasko*) dhe **afër prishjes**, pra i kishte mbushur ditët e saj.

Duke ditur të gjitha këto, do të ishte e pamend për lexuesit e atëhershëm të largoheshin nga Krishti për hir të Judaizmit, që gjendej tashmë në prag të fundit.

## DISKUTIM

### Mbi zëvendësimin e Dhiatës së Vjetër

Kur autori i Letrës së Hebrenjve flet për besëlidhjen e vjetër duke e quajtur të vjetërsuar dhe afër prishjes, i referohet Ligjit të Moisiut dhe të gjithë traditës së hershme Judaike. Thelbi i argumentit të tij është se Ligji kishte si synim të ruante Izraelin si popull të zgjedhur të Perëndisë, duke iu mësuar atyre mësim të ndryshme mbi moralin dhe duke i përgatitur për ardhjen e Krishtit.

Si rrjedhojë, pas ardhjes së Krishtit, nuk nevojitet më Ligji si mënyrë jetese. Rituale apo rregullat didaktike që shkruheshin në të (duke përfshirë këtu rrethprerjen, rregullat e agjërimit apo blatimin e theroreve) nuk bëjnë më asnjë dobi. Perëndia i kishte lënë të qëndronin në fuqi “deri në kohën e ndreqjes” (9:10) pra deri në kohën e ardhjes mbi dhë të Krishtit, Kryepriftit të përjetshëm.

Tani që Krishti qëndron në Fronin Qiellor, nuk na nevojiten më udhëzimet e Ligjit. Ato vërtet mbartin vlera kulturore, por nuk përbëjnë më domosdoshmëri për besëlidhjen e re. Hebrenjtë mund të vazhdojnë të rrethpriten e të mënjanojnë mishin e dërrit, meqenëse kjo është pjesë e kulturës së tyre. Por këto nuk hyjnë më në kategorinë e detyrimeve pa të cilat nuk mund të quhet dikush i krishterë. Në Krishtin Jisu as rrethprerja ka fuqi, as parrethprerja, por krijimi i ri (Gal. 6:15).

Kjo nuk do të thotë kurrsesi që tashmë Izraeli pushon së qeni popull i Perëndisë, megjithëse statusi i tyre mund të duket pak i paqartë. Dhuratat e Perëndisë janë të patundshme (Rom. 11:29), pra hebrenjtë gëzojnë ende një status më të veçantë përpara Tij. Megjithatë, statusi në vetvete nuk u siguron ndonjë bekim, pasi këto të fundit vijnë vetëm nëpërmjet bindjes. Duke menduar ta braktisin Krishtin me vullnetin e tyre të lirë, hebrenjtë e vendosin veten e tyre në anën e armiqve të Perëndisë. Kështu, nga pikëpamja e statusit të tyre si popull i Perëndisë, ata çmohen për hir të etërve të tyre, por nga pikëpamja e bekimeve hyjnore janë armiq të Ungjillit, sepse nuk e pranojnë atë (Rom. 11:28). Pra padyshim që Mbretëria e Perëndisë qëndron e hapur ndaj tyre, por pa vepra pendimi dhe pa besim në Krishtin nuk do të mund të hyjnë në të.



Megjithëse janë “bij të Mbretërisë”, edhe ata do të hidhen në errësirën e jashtme nëse vazhdojnë t'i kundërvihen Perëndisë (Mt. 8:12). Në fakt, statusi i tyre nuk ndryshon shumë krahasuar me kohërat e hershme, përpara ardhjes në botë të Krishtit. Në shek. VI p.Kr., gjatë periudhës së idhujtarisë, fisi i Judës ishte populli i zgjedhur i Perëndisë. Megjithatë, për shkak të pabesisë dhe idhujtarisë së tyre Perëndia i refuzoi dhe i trajtoi si armiq të Tij, duke sjellë mbi ta robërinë e Babilonisë në formë gjykimi. Edhe tani, ata mbeten bij të Perëndisë, por nëse nuk marrin Pagëzimin e Shenjtë dhe nuk bëhen nxënës të Krishtit, do të përjashtohen nga shpërblimi. Vetëm nëpërmjet besimit mund të jemi të hapur ndaj bekimeve të Perëndisë dhe të hyjmë në shpëtimin e Tij.

- 1 Ishte pra edhe *dhiata* e parë rregulla adhurimi dhe shenjtëroren tokësore.
- 2 Sepse u ndërtua tenda e parë, në të cilën ishte edhe kandileri, edhe tryeza, edhe paravënia e bukëve, *tendë* e cila quhet Shenjtërore.
- 3 Edhe pas kurtinës së dytë *ishte* tenda që quhet Shenjtërore e Shenjtëroreve,
- 4 e cila kishte një temianicë të artë, edhe arkën e dhiatës të mbuluar përreth nga të gjitha anët me ar, në të cilën ishte shtamba e artë që kishte mannën, edhe shkopi i Aronit që çeli sythe, edhe pllakat e dhiatës.
- 5 Edhe përsipër asaj ishin Keruvimet e lavdisë që i bënë hije shlyesit, për të cilat nuk është tani nevoja të flasim hollësisht.

Pasi autori e shtjelloi gjerësisht se përse priftëria e Krishtit është më e lartë se ajo e priftërinjve të Tempullit (8:3-4), në këtë kapitull vijon ta shpjegojë më gjerë. Këtë e bën në formë krahasimi me **dhiatën e parë**, të cilën Perëndia e themeloi nëpërmjet Moisiut.

Fillimisht autori bën përshkrimin fizik të **tendës së parë** (e cila qe e lëvizshme dhe u përdor deri në kohën e Mbretit David), pa kaluar ende në shenjtëroren që ndërtoi Solomoni apo në tjetrën që përdorej në kohën kur u shkrua letra. Kjo për arsye se tenda e parë ishte më e thjeshtë në strukturë krahasuar me dy të tjerat (meqenëse ishte e lëvizshme dhe duhet të ngrihej dhe të ndërtohej përsëri herë pas here) dhe gjithashtu për faktin se ishte e përkohshme.

Tenda kishte rregulla adhurimi (mjete të nevojshme për të kryer rituale të ndryshme fetare) dhe një shenjtërore tokësore (gr. *agion kosmikon*) me tipare dhe kufizime

vetëm për jetën tokësore (gr. *kosmos*) Këtu janë përshkruar shumë shkurtimisht të gjitha matjet dhe rregullimet të cilat shpjegohen të detajuara tek Eksodi 25-30. Kjo shenjtërore konsistonte në **tendën e parë, në të cilën ishte edhe kandileri**, edhe një **tryezë** mbi të cilën vendoseshin dymbëdhjetë **bukët** e blatës, që simbolizonin jetën e dymbëdhjetë fiseve të Izraelit. Kjo tendë quhej **shenjtërore**.

Brenda saj ndodhej **një kurtinë e dytë**, pas të cilës gjendej **tenda që quhet Shenjtërore e Shenjtëroreve**, vendi më i shenjtë, banesa e Perëndisë mes njerëzve. Në hyrje ndodhej një **temjanicë e artë**, që qëndronte përballë hyrjes në Shenjtëroren e Shenjtëroreve. Në tempujt paganë, në këtë tendë gjendej edhe statuja e ndonjë idhulli, por Perëndia i Izraelit i ndalonte paraqitje të tilla, prandaj në këtë tendë nuk kishte asnjë idhull. Në vend të tyre qëndronte **arka e dhiatës, e mbuluar përreth nga të gjitha anët me ar**.

Brenda në arkë gjendej **shtamba e artë që kishte mannën**, me të cilën Perëndia ushqeu popullin e Tij tekta gjendej në shkretëtirë; shkopin e Aaronit që çeli sythe, me të cilin ai u vërtetoi priftërinë e tij të gjithë atyre që i qëndronin kundër. Së fundmi, aty gjendeshin edhe **pllakat e dhiatës** që iu dhanë Moisiut në Malin Sina (Eks. 16:32-34; 25:16; Num. 17:10). Mbi këtë arkë gjendeshin **Keruvimet e lavdisë** (imazhe të arta të engjëjve) **që i bënë hije shlyesit**, në vendin ku bëhej blatimi. Keruvimet i shërbenin Perëndisë në qiej, ndërsa ato që gjendeshin në shenjtërore ishin thjesht imazhe të tyre. Secila nga këto që përmendëm ka domethënien e saj të veçantë, por autori nuk e pa të nevojshme **të fliste për to hollësisht**, pasi kështu do të zgjatej së tepërmi.

Përse duhet të përmendeshin të gjitha këto? Qëllimi është që lexuesit të kuptojnë se dhiata levitike, duke pasur një natyrë tokësore, përmbante vetëm gjëra të prekshme. Objektet që ndodheshin në të mund të gjenden edhe në shtëpitë e gjithsecilit, si p.sh. tryeza, buka, shtamba e kandileri. Të tjerat mund të konsiderohen si suvenire nga koha e mërgimit të popullit të Izraelit (manna, shkopi i Aaronit që çeli sythe, pllakat që mori Moisiu etj.). Të gjitha këto dëshmojnë se kjo shenjtërore lidhej vetëm me tokësoret.

Vërtet, priftërisë së Moisiut nuk mund t'i mohohet lavdia, por mbetet një lavdi tokësore, e përbërë kryesisht nga **ari** (që e shohim të përmendet tri herë: tek temjanica e artë, arka e shtamba). Në ndryshim nga ajo, dhiata e re është e mbushur me lavdinë e Perëndisë dhe nuk mbetet në tokësoret, si e vjetra.

## DISKUTIM

### Mbi kuptimin e objekteve të Shenjtërores

Meqenëse autori i letrës nuk ndalet të japë një shpjegim më analitik mbi objektet e Tempullit, mundet thjesht të japim hipoteza mbi kuptimin e tyre dhe atë çka përfaqësojnë. Unë do të sugjeroja si më poshtë:

Perëndia e urdhëroi Izraelin që në tendën e parë, pra në Shenjtëroren, të vendosnin një kandilier me shtatë qirinj. Ai do të rrinte përherë i ndezur dhe do të përfaqësonte praninë e Tij në mes të popullit të vet. Ashtu sikurse drita e qiriut nuk do të fikej, ashtu edhe Perëndia nuk do t'i braktiste ata kurrë. Sipas mendimit tim, kjo është si një profeci për ardhjen e Krishtit, Dritës së Botës. Kandilieri e mbajti zjarrin e qirinjve ashtu si e Tërëshenjta Mari mbajti Krishtin në barkun e saj. Krishti është flaka që ndriçon, Maria është kandilieri.

Në këtë tendë ndodhej gjithashtu tryeza dhe bukët e blatës. Këto ishin dymbëdhjetë bukë, të cilat ndërroheshin çdo javë dhe konsumoheshin nga priftërinjtë. Nga vetë numri i tyre duket qartë se përfaqësonin dymbëdhjetë fiset e Izraelit. Edhe bukët simbolizojnë Krishtin, Bukën e Jetës, që është edhe vetë mishërimi i Izraelit. Pra bukët përfaqësonin njëkohësisht popullin e Izraelit dhe Perëndinë e tyre. Ky imazh gjen përmbushjen e tij në Kishë, e cila është njëkohësisht Trupi i Krishtit dhe bashkësia e popullit të krishterë. (Prandaj edhe apostull Pavli tek 1 Kor. 12:12 e quajti Kishën "Krishti", pasi Ai është plotësia dhe përmbushja e saj; Efes. 1:23). Ky identitet gjen përmbushjen e tij të plotë në Misterin e Eukaristisë Hyjnore, ku besimtarët marrin vetë Krishtin. Meqenëse thamë se Krishti është buka e blatës, Maria është tryeza që e mban atë.

Në hyrjen e Shenjtërores së Shenjtëroreve qëndronte temjanica e artë, që përfaqësonte lutjet e njerëzve që ngrihen drejt Perëndisë dhe pranohen prej Tij (prandaj në ditët që bëheshin sakrifica, digjej edhe temjan, "kështu ai [kryeprihti] nuk do të vdesë"- Lev. 16:13). Edhe temjanica është simbol i Krishtit, nëpërmjet të cilit lutjet tona ngrihen drejt fronit të Perëndisë. Krishti është temjani erëmirë, ndërsa Maria është altari mbi të cilin ofrohet ky temjan. Ashtu sikurse nevojitet altari për të kryer flijimet, nevojitet edhe pranimi i Marisë që Krishti të mishërohej e të vinte në botë.

Brenda Shenjtërores së Shenjtëroreve qëndronte arka e dhiatës. Ajo ishte vendbanimi i Perëndisë mes njerëzve dhe për këtë arsye qëndronin mbi të Keruvimet e lavdisë, ashtu si në Fronin Qiellor të Perëndisë gjenden me mijëra Keruvime dhe Serafime që

i shërbejnë. Banesa e Perëndisë ndër njerëzit është simbol i Mishërimit të Tij, ndërsa arka që është në vetvete banesa e Tij, simbolizon Hyjlindësen, e cila u denjësuara të mbante Perëndinë e Mishëruar në mitrën e saj.

Brenda arkës kishte disa objekte. Së pari, në të gjendej manna, me të cilën Zoti ushqeu popullin e Tij në ditët që ndodheshin në shkretëtirë. Duke e parë nën dritën e Krishtit, Ai është Buka e Jetës që jep jetë të përjetshme. Shtamba që mbante mannën është gjithashtu parafigurim i Marisë.

Në arkë gjendej dhe shkopi i Aaronit që çeli sythe. Kur populli i Izraelit filloi të mos besonte për thirrjen hyjnore të Aaronit në priftëri, Zoti ua vërtetoi nëpërmjet mrekullisë së çeljes së sythave në shkopin e tij (Num. 17). Të gjithë përfaqësuesit e fiseve shkruan emrat në shkopinjë përkatës (si shenjë e autoritetit të tyre mbi fisin përkatës) dhe Moisiu i mori të gjitha, bashkë me atë të Aaronit, dhe i vuri në Shenjtërore. Të nesërmen panë se megjithëse shkopi i tij përbëhej nga dru i tharë, kishte çelur sythe, lule dhe kishte prodhuar bajame. Fuqia e Perëndisë nuk njih kurrfarë kufizimi, Ai mund të nxjerrë fryte edhe nga një dru i pajetë. Kjo u bë për të dëshmuar përpara të gjithëve se Aaroni dhe fisi i tij ishin zgjedhur për të dhënë fryte shpirtërore në popullin e Izraelit. Jeta e vërtetë shpirtërore themelohet në Krishtin, i Cili u shfaq ndër ne në mënyrë të përmbinatyrshme, ashtu si sythet dhe lulet e shkopit, nëpërmjet Virgjëreshës së Tërëshenjtë. Maria është shkopi, ndërsa Krishti sythet. Vetëm në të gjendet priftëria e frytshme dhe që çon në shpëtim.

Së fundmi, në arkë ndodheshin edhe pllakat e dhiatës, dy pllakat prej guri në të cilat Perëndia shkroi Dhjetë Urdhërimet. Edhe këto simbolizojnë Krishtin, Fjalën e përjetshme të Atit, mesazhin e Tij për të gjithë botën.

**6 Edhe duke qenë këto të ndërtuara kështu, në tendën e parë gjithnjë hyjnë priftërinjtë që bëjnë lutjet.**

**7 Po në të dytën një herë në vit *hyn* vetëm kryepriifti, jo pa gjak, të cilin e blaton *theror* për veten e tij dhe për fajet e popullit, që i bëjnë nga padija.**

**8 Edhe këtë e tregonte Fryma e Shenjtë, se ende nuk ishte shfaqur rruga për në Shenjtëroren e Shenjtëroreve, deri sa ende po qëndronte tenda e parë,**

**9 e cila ishte simbol për kohën e tanishme, sipas të cilit dhuratat e therorët e ofruar nuk mund ta bënin të përsosur nga ndërgjegjja atë që lutej,**

**10 sepse ishin caktuar vetëm me ushqime, pije dhe për larje të ndryshme, e për rregulla mishi, deri në kohën e ndreqjes.**

Mënyra e kryerjes së shërbesave priftërore në këtë shenjtërore dëshmon edhe më tepër për kufizimin e saj vetëm në gjërat e botës. **Në tendën e parë gjithnjë hynin priftërinjtë që bënin lutjet** (gr. *latreias* - krahaso me përdorimin në v.1). Këta të fundit nuk mund të hynin në Shenjtëroren e Shenjtëroreve. Aty hynte vetëm **kryepriifti**, edhe ky **një herë në vit, jo pa gjak, që e blatonte theror për veten e tij dhe për fajet e popullit**, të bëra **nga padija**. Edhe kryepriifti, duke qenë njeri si gjithë të tjerët, duhet të ofronte theror për veten e tij, krahas popullit, pra edhe afërsia e tij me Perëndinë ishte e limituar. (Ritualet e flijimit përshkruhen imtësisht tek Lev. 16). Ishin vendosur të gjitha në mënyrë të tillë, që të mos kishte shumë akses në Shenjtëroren e Shenjtëroreve, në banesën e Perëndisë. Vetëm fakti që ekzistonin dy tenda dëshmon për këtë gjë.

E gjithë kjo ndarje ishte bërë për një qëllim të caktuar. Ishte vepër e Frymës së Shenjtë, që foli nëpërmjet zërit të profetëve dhe në këtë mënyrë po profetizonte se **ende nuk ishte shfaqur rruga për në Shenjtëroren e Shenjtëroreve, derisa ende po qëndronte tenda e parë**. Kjo, sipas autorit, ishte një simbol për kohën në të cilën u shkrua letra. Tenda e parë simbolizonte kufizimet e priftërinjve që blatonin therore çdo ditë. Ata mund të shkonin deri aty, por jo përtej saj. Pra ekzistonte një vel mes Perëndisë dhe njerëzve.

Gjatë asaj kohe, **dhuratat dhe theroret** ofroheshin në tendën e parë. Megjithatë, ato **nuk mund ta bënin të përsosur nga ndërgjegjja atë që lutej**. Nuk mund të sillnin transformim të brendshëm, larje të mëkateve dhe pastrim të shpirtit. Kjo për arsye se **ishin caktuar vetëm me ushqime, pije dhe për larje të ndryshme, e për rregulla mishi**. Pra Ligji kishte të bënte me të ngrënët e të pirët, të ndante ushqimet e ndotura nga ato që pastrat, të vendoste se cilat mund të konsumoheshin nga kush dhe kur (shiko Lev. 6:14-18; 10:9; 11) pra me gjëra të përkohshme të kësaj bote. Ligji trajtonte gjithashtu edhe rregullat e pastërtisë ceremoniale të jashtme, të tilla që nuk preknin zemrën por mbeteshin vetëm në të jashtmet, të atyre që mund të pastroheshin nëpërmjet **larjeve të ndryshme** (shiko Lev. 14:8-9).

Këto ishin vendosur në këtë mënyrë **deri në kohën e ndreqjes** (gr. *diorthosis* - krahaso me përdorimin e saj tek Vep. Ap. 24:2). Pra këto rregulla ishin të përkohshme dhe i ishin dhënë Izraelit për t'u zbatuar deri në kohën e ardhjes së Krishtit, i Cili do të transformonte gjithçka.

11 Por si erdhi Krishti, kryepriifti i të mirave të ardhshme, me anë të tendës më të madhe e më të përsosur, që s'është bërë me dorë, domethënë, që s'është prej këtij krijimi.

12 As me anë gjaku cjepsh e viçash, po me anë të gjakut të tij hyri një herë e përgjithmonë në Shenjtëroren e Shenjtëroreve, edhe fitoi shpërblim të përjetshëm.

13 Sepse në qoftë se gjaku i demave e i cjepeve, edhe hiri i mëshqerrës që spërkat të ndoturit, shenjtëron për pastrimin e mishit,

14 sa më tepër gjaku i Krishtit, i cili me anë të Frymës së përjetshme i blatoi veten e tij pa njollë Perëndisë, do të pastrojë ndërgjegjen tuaj nga punë të vdekura, që t'i shërbeni Perëndisë së gjallë?

Transformimi për të cilin folëm më lart ka ardhur tashmë. **Si erdhi Krishti, kryepriifti i të mirave të ardhshme** (të mirat e Mbretërisë së Perëndisë, që ishin profetizuar në Shkrimet), hyri në tendën më të madhe e të përsosur, që s'është bërë me dorë. Krishti nuk erdhi për të shërbyer si Kryepriift në shenjtëroren tokësore, pasi ajo ishte e përkohshme dhe e kufizuar vetëm në gjërat e kësaj bote. Përkundrazi, erdhi për të na sjellë të vërtetën e përjetshme të Mbretërisë, prandaj hyri në banesën e vërtetë të Perëndisë, që **nuk është e bërë me dorë**, pra që **s'është prej këtij krijimi**. Kryepriiftërinjtë levitë hynin në Shenjtëroren tokësore me anë gjaku cjepsh e viçash, ndërsa Krishti, me anë të gjakut të tij, hyri në Shenjtëroren hyjnore.

Nuk qe e nevojshme për Të të hynte çdo vit, siç bënin kryepriiftërinjtë e tjerë, por një herë e përgjithmonë (gr. *efapaks* - krahaso me përdorimin tek 7:27). Gjaku i derdhur mbi kryq fitoi shpërblim të përjetshëm, pastrimin e mëkateve tona (1:3) në një mënyrë që ritet e mëparshme nuk do të mund t'ia arrinin dot kurrë, duke na nxjerrë nga skllavëria shpirtërore e duke na bërë bij të Perëndisë.

Kjo nuk është diçka e papritur. Të gjithë ishin në dijeni se **gjaku i demave e i cjepeve, edhe hiri i mëshqerrës që spërkat të ndoturit** mundet vërtet të shenjtërojë ata që konsideroheshin të ndotur, për pastrimin e mishit (shih Num. 19). Nëse gjëra të tilla arrinin të pastrojnë dikë nga ana e jashtme, **sa më tepër Gjaku i Krishtit** do të mund të **pastrojë ndërgjegjen** e njerëzve **nga punët e vdekura** të mëkatit, që të mundën lirisht **t'i shërbejnë Perëndisë së gjallë?**

Theroret e kafshëve as nuk mund të krahasoheshin me atë të Krishtit. Ato nuk kishin fuqi jetëdhënëse e as mund të ndihmonin në problemet shpirtërore të njerëzve. Nuk mund të bënin asgjë ndaj mëkateve (10:4). Vetëm Gjaku i Birit të Perëndisë është burim jete, sepse Ai i **blatoi veten e tij pa njollë Perëndisë me anë të Frymës së përjetshme**. Duke qenë vetë i panjollë, pa mëkat, mund të na pastrojë ne nga

mëkatet tona. Nëpërmjet sakrificës së Tij ,ndërgjegjet tona mund të pastrohen nga çdo paudhësi, dhe kështu mund të denjësohemi për të qëndruar përpara Perëndisë. Kur themi se Krishti e ofroi veten e Tij të panjollë nëpërmjet Frymës së përjetshme, nënkuptojmë se Ai jetoi dhe vdiq me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë të Perëndisë, e ofroi veten si theror në Frymë, kështu që sakrifica e Tij nuk është e lidhur me një kohë dhe vend të caktuar, siç ishte bërë gjer në atë kohë, por është e përjetshme.

Vinte një moment që theroret tokësore e humbnin fuqinë e tyre dhe nevojitej të ofroheshin përsëri të tjera (krahaso me 10:1). Por duke qenë në Frymën e Shenjtë, therorja e Krishtit nuk e humbet kurrë potencialin e saj, tejkalon çdo limit kohe apo hapësire, dhe mbetet **përjetë**.

Fjala e cila në shqip është përkthyer “ndërgjegje” është në fakt ekuivalentja e fjalës *sinidhisi* në greqisht, e cila ka kuptim më të thellë sesa thjesht ndjenja mbytëse që pushton dikë pas kryerjes së një mëkati. Ajo përfshin të gjithë orientimin e brendshëm moral, zemrën, ndjesitë dhe vigjilencën shpirtërore. Në këtë kuptim, Gjaku i derdhur i Krishtit ka fuqinë të pastrojë më të brendshmet e ndërgjegjes sonë duke larguar ndjenjën e fajit dhe duke na transformuar e ndriçuar.

**15 Edhe prandaj ai është ndërmjetësi i një dhiate të re, që, me anë të vdekjes që u bë për shpërblimin e shkeljeve në kohën e dhiatës së parë, të marrin ata që janë thirrur premtimin e trashëgimit të përjetshëm.**

**16 Sepse atje ku ka dhiatë është e nevojshme të ketë vdekje të atij që bëri dhiatën**

**17 Sepse dhiata ka fuqi mbasi ata kanë vdekur; sepse kurrë s'ka fuqi deri sa rron ai që bëri dhiatën.**

**18 Prandaj as e para nuk qe vërtetuar pa gjak;**

**19 sepse pasi iu tha prej Moisiut gjithë popullit çdo porosi sipas ligjit, ai mori gjakun e viçave e të cjepëve, bashkë me ujë e me lesh të kuq e me hisop, edhe spërkati edhe vetë librin e gjithë popullin,**

**20 duke thënë: "Ky është gjaku i dhiatës që urdhëroi Perëndia për ju".**

**21 Edhe gjithashtu spërkati me gjak edhe tendën dhe gjithë enët e shërbesës.**

**22 Edhe sipas ligjit pothuajse të gjitha gjërat pastrohen me gjak, dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë.**

Kryeriftëria e Krishtit është themeluar mbi pësimin e Tij vullnetar dhe vdekjen në Kryq. Vetëm falë vdekjes Ai mundi të bëhet ndërmjetës i një dhiate të re. **Me anë të vdekjes që u bë për shpërblimin e shkeljeve në kohën e dhiatës së parë, marrin ata që janë thirrur premtimin e trashëgimit të përjetshëm.** Të gjitha premtimet që

iu bënë pasardhësve të Abrahamit u përmbushën vetëm falë vdekjes së Krishtit. Ata i mbanin peng shkeljet e bëra në kohën e dhiatës së parë, por vdekja e Tij i çliroi. Për të bërë më të qartë kuptimin e vdekjes në këtë dhiatë të re, autori bën analizën e fjalës dhiatë (gr. *dhiathiki* - besëlidhje apo testament). Sipas tij, **atje ku ka dhiatë është e nevojshme të ketë vdekje të atij që bëri dhiatën**, pasi ajo ka fuqi vetëm pas vdekjes së tij, por jo **deri sa rron ai që bëri dhiatën**. E thënë më qartë, që një dhiatë të hyjë në fuqi, duhet më parë të vdesë ai që e ka bërë. Kjo lojë fjalësh në dukje ka për qëllim të tregojë domosdoshmërinë e vdekjes së Jisuit, në mënyrë që dhiata të mund të hynte në përdorim.

I njëjti rregull vlejti edhe për **dhiatën e parë**, pasi as ajo **nuk qe vërtetuar pa gjak**. Dimë se tek kapitulli 24 i Eksodit (Daljes), **pasi Moisiu i tha popullit çdo porosi sipas ligjit, ai theri viçat dhe cjeptë**, dhe pasi mori gjakun e tyre **bashkë me ujë e me lesh të kuq e me hisop, spërkati edhe vetë librin e gjithë popullin, duke thënë: "Ky është gjaku i dhiatës që urdhëroi Perëndia për ju"**. Vdekja dhe gjaku i derdhur në këto therore ishte një paraprijë e gjakut që do të duhej të derdhte Krishti.

Autori vijon duke shpjeguar se në dhiatën e Moisiut, nevojitej vazhdimisht gjak therorësh. Moisiu **gjithashtu spërkati me gjak edhe tendën dhe gjithë enët e shërbesës** (gr. *leitourgia*) si dhe Aaronin dhe bijtë e Tij gjatë fronëzimit të tyre (Eks. 29) e në çdo vit që pasonte, në ditën e ofrimit (Lev. 16). Kaq vend thelbësor kishte vdekja sakrifikuese në bashkimin me Perëndinë, saqë **pothuajse të gjitha gjërat pastroheshin me gjak, dhe pa derdhur gjak nuk merrej ndjesa e mëkateve**. Nëse populli i dhiatës së parë do të kishte dëgjuar për therore të pagjashme edhe për blatim të bukës dhe verës, me siguri do ta kishte quajtur atë të pafrytshme.

**23 Ishte e nevojshme pra që format e qielloreve të pastrohen me këto, po qielloret me therorë më të mirë se këto.**

**24 Sepse Krishti nuk hyri në shenjtërore të bëra me dorë, që janë kopje të të vërtetave, po në qiell vetë, që të paraqitet tani përpara Perëndisë për ne;**

Thelbi i priftërisë së Krishtit qëndron në vdekjen e Tij, atë vdekje e cila pastroi të gjithë botën nga mëkati. Shenjtërorja tokësore e ndërtuar sipas Ligjit, me format e qielloreve, pastrohej nëpërmjet theroreve të kafshëve. Pra, shenjtërorja ndotej nga mëkatet e njerëzve dhe për shlyerjen e tyre nevojitej therore e përgjakshme (si edhe në ditën e flijimeve vjetore - Lev. 16). Por **qielloret**, simbol i të cilave ishte edhe vetë Tenda e Moisiut, duhet të pastroheshin **me therorë më të mirë se këto**. Kjo gjë



dëshmon se gjaku i kafshëve nuk mund t'u siguronte njerëzve hyrjen në jetën e përjetshme. Kjo mund të arrihej vetëm nëpërmjet Gjakut të shenjtë të Krishtit.

Prandaj edhe **nuk hyri në shenjtërore të bëra me dorë, që janë kopje të të vërtetave, po në qiell vetë, që të paraqitet tani përpara Perëndisë për ne.**

Termi i përkthyer "formë" i korrespondon fjalës greke "*antitipos*". Sipas mendimit të Platonit, që kemi trajtuar dhe më parë, ekziston bota transhendente e idealeve dhe bota materiale e perceptimeve shqisore. Kjo e fundit përbën dhe atë që quajmë formë, kopje ose antitip. Shenjtërorja qiellore është idealja (shiko 8:5), ndërsa ajo tokësore është **forma** ose reflektimi i të parës.

Krishti nuk hyri në kopjen tokësore, por në idealen hyjnore, duke qëndruar në praninë e Atit dhe duke ndërmjetuar dhe sakrifikuar pareshtur për ne.

**25 as të ofrojë veten e tij shumë herë, siç hyn kryepriifti në shenjtërore vit për vit me gjak jo të vetin;**

**26 sepse atëherë duhej shumë herë të pësonte qëkurse u fillua bota; - por tani një herë në fund të jetëve ai u shfaq, që të prishë mëkatet me anë të flijimit të vetes së tij.**

**27 Edhe siç është urdhëruar për njerëzit një herë të vdesin, edhe pastaj është gjyqi,**

**28 kështu edhe Krishti, pasi një herë u pru theror që të ngrejë mëkatet e shumë vetave, do të duket për së dyti pa mëkat tek ata që e presin atë për shpëtim.**

Ekziston edhe një dallim i fundit që duhet bërë ndërmjet dy priftërive. Përveç faktit që Krishti nuk mori gjakun e dhenvë e të cjepve për ta ofruar si theror pastrimi, po sakrifikoi gjakun e vet; por edhe nuk u paraqit përpara Zotit sistematikisht. Kryepriiftërinjtë e tjerë hynin në shenjtërore vit për vit dhe jo me gjak të vetin, duke u përpjekur që në këtë mënyrë t'i afronin njerëzit me Perëndinë. Në të kundërt, për Krishtin mjaftoi vetëm një herë ta jepte veten e Tij si theror. Kjo nuk do të thoshte se sakrifica e tij vlejti vetëm për mëkatet e kryera deri në atë pikë, por jo më pas, si në rastin e kryepriiftërinjve të tendës tokësore. Nëse do të ishte kështu, atij i **duhej shumë herë të pësonte qëkurse u fillua bota**, duke vdekur për çdo brez, që t'u jepte faljen e mëkateve.

Sigurisht, Ligji ishte i kufizuar nga faktori kohë, prandaj theroret mund të pastronin vetëm mëkatet e kryera deri në atë periudhë kohe. Përkundrazi, sakrifica e Krishtit është e përjetshme dhe e pakufizuar. Pra në përmbushjen e kohërave, **në fund të jetëve, Ai u shfaq që të prishë mëkatet me anë të flijimit të vetes së tij.** Ofrimi i Tij ishte eskatologjik, i bërë një herë për të gjithë brezat e njerëzve.

Vdekja e Krishtit ishte e domosdoshme për jetën e mbarë njerëzimit. Ai vdiq një herë për të gjitha, siç do të duhej edhe ne të vdisnim një herë për të gjitha mëkatet dhe sëmundjet tona, meqenëse kjo është kura që na shëroi nga të gjitha. **Siç është urdhëruar për njerëzit të vdesin një herë, edhe pastaj të gjykohen,** duke qëndruar përpara Gjykatores së Krishtit, **kështu edhe Krishti, pasi një herë u pru theror** me anë të vdekjes, **që të ngrejë mëkatet e shumë vetave,** do të jetë Gjykatësi ynë.

Kur të përmbushet koha që **të duket për së dyti,** nuk do të vdesë përsëri, por do të vijë si Gjykatës i lavdishëm **tek ata që e presin për shpëtim.**

- 1 **Sepse ligji, duke pasur një hije të të mirave të ardhshme e jo vetë figurën e gjërave, s'mundet kurrë me anë të po atyre therorëve, që sjellin përherë vit për vit, të bëjë të përsosur ata që afrohen.**
- 2 **Sepse atëherë do të kishin pushuar së pruri therorë, sepse adhuruesit, si të pastroheshin një herë, nuk do të kishin më asnjë ndërgjegje mëkatesh.**
- 3 **Po në ato therorë ka një kujtesë mëkatesh vit për vit.**
- 4 **Sepse është e pamundur që gjak demash e cjepsh të heqë mëkate.**

Vetëm përmes gjakut të Krishtit mundësohet falja e vërtetë e mëkateve (9:23-26). Fakti që sakrificat e Tempullit nuk mund të arrinin kurrë atë që bëri Ai, tregon se therorja e Krishtit nuk është thjesht një alternativë krahas theroreve të Tempullit, asgjë nuk mund të krahasohet me flijimin e Tij. Kjo sepse Ligji nuk u krijua për të përmbushur pastrimin e zemrave dhe transformimin e natyrës njerëzore, por që të profetizonte për këtë. Pra e vërteta nuk ishte se sakrificat e Tempullit u krijuan me synimin për të çrrënjësuar mëkatet dhe dështuan, përkundrazi.

Ligji ishte vetëm një **hije** e të mirave të ardhshme të Mbretërisë së Perëndisë dhe jo vetë **figura** (gr. *ikona*) e këtyre gjërave. Pra ndryshimi këtu qëndron mes një pamjeje të qartë dhe një tjetre të mjegulluar. Tek Kol. 1:15 Jisui quhet "Ikona e Perëndisë së gjallë", pra shfaqja e dukshme e Atit të padukshëm dhe karakteri i qenies së Tij (1:3). Termi *figurë* përdoret në të njëjtin kuptim, pra që të gjitha gjërat e mira të Perëndisë shfaqen nëpërmjet personit të Krishtit, ndërsa Ligji ishte thjesht një kopje e mjegullt e Tij. Kështu, ai nuk mundej **kurrë me anë të po atyre therorëve, që priftërinjtë levitë sjellin përherë vit për vit, të bëjë të përsosur e të ketë fuqi transformuese mbi ata që afrohen.** Sakrificat e atëhershme dëshmonin se sa shumë dëshironin njerëzit të merrnin falje e të ripërtëriheshin shpirtërisht, por nuk ia arrinin dot. Nëse vërtet **adhuruesit do të pastroheshin një herë, nuk do të kishin më asnjë ndërgjegje mëkatesh** dhe për pasojë nuk do t'u nevojitej të ofronin më therore të tjera. Cili vallë shkon dhe viziton mjekun pasi është shëruar?

Autori mediton edhe mbi shpeshhtësinë e theroreve që bëheshin nën Ligj. Therore bëheshin vazhdimisht. Me rastin e kushtimit të Tempullit ndaj Solomonit u ofruan 22.000 qe dhe 120.000 dele (1 Mb. 8:63). Duket se ato nuk synonin të sillnin transformimin shpirtëror, por vetëm të shprehnin nevojën e thellë që kishin për të. Pra kjo praktikë solli jo falje, por *kujtesë mëkatesh* (gr. *anamnisis*). Koncepti i kujtesës nuk është i njëjti me atë të kohëve të sotme, por është koncepti i hershëm i kujtesës së Perëndisë, që nxit në vepra (shiko tek 8:12). Autori e bën të qartë se theroret e Ligjit shërbenin si kujtesë ndaj Perëndisë, për mëkatet dhe provokimet e njerëzve (1 Mb. 17:18).

Adhuresi i gjendur nën Ligj vinte në shenjtërore ku shpallte mëkatet e tij dhe nevojën e madhe për falje, të cilën nuk e merrte dot. Kjo jo për faj të adhuresit, por sepse **është e pamundur që gjak demash e cjepsh të heqë mëkate**. Vallë si do të mundej gjaku i një gjallese të spërkatur mbi shenjtëroren e gurtë të transformonte shpirtin njerëzish, apo t'u dhuronte jetë?

**5 Prandaj, ai duke hyrë në botë, thotë: "Theror e dhuratë nuk deshe, po bëre gati për mua një trup.**

**6 Therorë me djegie të plotë dhe *flijime* për mëkat nuk pëlqeve.**

**7 Atëherë thashë: Ja tek po vij, - në rrotullin e librit është shkruar për mua, - për të bërë, o Perëndi, dëshirën tënde".**

**8 Pasi tha më sipër: "Se theror dhe dhuratë, edhe therore me djegie të plotë dhe *flijime* për mëkat nuk deshe, as nuk i pëlqeve", - të cilat sillen sipas ligjit,**

**9 atëherë tha: "Ja tek po vij, për të bërë, o Perëndi, dëshirën tënde". Hedh tej të parën, që të mbështesë të dytën.**

Shenjtërimi i natyrës njerëzore mund të realizohet vetëm me ardhjen e Mesisë dhe të Mbretërisë së Perëndisë. Për ta shpjeguar këtë tezë, autori përdor metodën e përhershme të citimit të Shkrimeve. Në Psalmin 39:7 (vetëm tek Septuaginta) Mesia i drejtohet Perëndisë Atë duke thënë: **"Theror e dhuratë nuk deshe, po bëre gati për mua një trup. Therorë me djegie të plotë dhe *flijime* për mëkat nuk pëlqeve**. Në kontekstin origjinal, këto janë fjalë të një njeriu që e dinte se ajo çka kërkon Perëndia nuk është gjaku i kafshëve, por një zemër e dashur dhe e bindur, pa të cilën sakrificat nuk vlejné kurrjë. Këtë fragment autori e interpreton si profeci për Mesinë, si të jetë zëri i Atij që flet. (Në të vërtetë, për referencat për armiqtë që kërkojnë t'i marrin jetën psalmistit në Psalmin 39:14 ekziston një interpretim mesianik, gjithashtu edhe

në Psalmin pasardhës ku shkruhet për tradhtarët që hanë bukën e psalmistit dhe ngrejnë më pas thembrën kundër tij [Ps. 40:9; Jn. 13:18].)

Sipas këtij interpretimi, vargjet e lartpërmendura profetizojnë për **hyrjen në botë** të Krishtit nëpërmjet Virgjëreshës, në kohën kur Perëndia **bëri gati një trup** për Të. Mesia erdhi (Thirrja “**Ja tek po vij**” përmban ton thirror) për të bërë **dëshirën** e Atit për shpëtimin e botës. Rëndësia e kësaj vepre ishte kaq e madhe sa që për Të ishte **shkruar** edhe në **rrotullin e librit**, pra në Ligj.

Autori kërkon të theksojë se në psalmin në fjalë ekziston një kontrast mes veprës shpëtimtare të Krishtit dhe theroreve të Tempullit. Duket sikur Perëndia i vendos qëllimisht mënjane theroret tokësore duke mos shfaqur pëlqim për to, por duke pranuar vetëm veprën e Krishtit. Prandaj, duke iu drejtuar Atit, Mesia thotë: “..theror dhe dhuratë, edhe therore me djegie të plotë dhe *flijime* për mëkat nuk deshe, as nuk i pëlqeve” dhe më pas shton: “**Ja tek po vij për të bërë, o Perëndi, dëshirën tënde**”. Theroret e Tempullit përfaqësojnë Ligjin e Moisiut në tërësi, të cilin e shohim të lihet mënjane. Psalmisti/ Mesia hedh tej të parën (Ligjin dhe theroret e Tempullit) që të mbështesë të dytën. Kështu, dhiata e vjetër i lë vendin të resë, të themeluar mbi personin e Jisu Krishtit.

**10 Prej kësaj dëshire jemi shenjtëruar me anë të flijimit të trupit të Jisu Krishtit që u bë theror një herë për të gjithë.**

**11 Dhe çdo prift rri përditë duke shërbyer, edhe ofron shumë herë po ata therorë, të cilët kurrë nuk mund të heqin mëkate.**

**12 Po ai, pasi ofroi një theror për mëkate, ndenji përgjithnjë në të djathtë të Perëndisë,**

**13 duke pritur pastaj deri sa të vihen armiqtë e tij nënkëmbje e këmbëve të tij,**

**14 sepse me një dhuratë bëri të përsosur përgjithnjë ata që shenjtërohen.**

Siç trajtuam edhe më lart, Krishti erdhi në botë për të bërë dëshirën e Atit (v.7) dhe për të themeluar një dhiatë të re. Falë **kësaj dëshire jemi shenjtëruar** dhe **me anë të flijimit të trupit të Jisu Krishtit** janë pastruar zemrat dhe ndërgjegjet tona. Kjo therore ishte **një herë për të gjithë**, gjë që dëshmon përsëri për superioritetin e saj ndaj theroreve të Tempullit, të cilat nevojitej të bëheshin herë pas here. Sipas Ligjit, jo vetëm Kryepriifti por dhe çdo prift rrinte përditë duke shërbyer (gr. *leitourgo*, krahaso me 8:6; 9:21) dhe ofronin shumë herë po ata therorë. Kështu na krijohet një imazh mundimesh të vazhdueshme, madje edhe te kota, pasi **ata therorë nuk mundën dot**

**kurrë të heqin mëkate.** Kështu, edhe priftërinjtë levitë krijojnë një imazh frustrimi dhe kotësie.

Ndryshe ndodh me Krishtin. Ai, pasi ofroi theror për mëkate, ndenji përgjithnjë në të djathtë të Perëndisë, i lartësuar përmbi të gjithë. Kontrasti midis tyre është më se i qartë: priftërinjtë e Tempullit nuk mund ta përfundonin dot kurrë punën e tyre dhe theroret e tyre nuk bënë ndonjë dobi. Në të kundërt, vepra e Krishtit u përmbush plotësisht. Tani, gjithçka që i mbetet është të presë derisa **armiqtë** të vihen **nënkëmbje e këmbëve të tij.**

Psalmi që i referohet autori në këtë fragment është përsëri Psalmi 110, i njëjti që profetizoi se Ai do të jetë Kryepriфт përjetë, sipas urdhrit të Melkisedekut. Autoriteti i plotë si Mesi dhe fitorja e Tij mbi armiqtë përbëjnë përmbushjen e veprës Kryepriфтërore (përmes këtyre fjalëve autori mund të ketë synuar një paralajmërim të fshehur për të gjithë ata që rrezikojnë ta bëjnë veten e tyre **armiq** të Krishtit, duke mohuar besimin). Gjykatësi qëndron dhe pret në fron në të djathtë të Atit, pasi **me një dhuratë bëri të përsosur gjithnjë ata që shenjtërohen** (gr. *agiazō* - nënkupton pastrimin e zemrës, marrjen e faljes dhe transformimin e shpirtit më Krishtin, pra nuk konsiston vetëm në ndryshimin e sjelljes; shiko një përdorim të ngjashëm tek 1 Kor. 6:11.) Të qenit i krishterë është një rilindje shpirtërore e përhershme dhe e qëndrueshme, pastrim i mendjes dhe i zemrës (krahaso me Vep. Ap. 15:9).

**15 Po edhe Fryma e Shenjtë dëshmon tek ne; sepse pasi pati thënë më përpara:**

**16 "Kjo është dhiata që do të bëj për ata pas atyre ditëve, thotë Zoti, do të vë ligjet e mia në zemrat e tyre, edhe do t'i shkruaj ato në mendjet e tyre".**

**17 Shtoi: "edhe mëkatet e tyre dhe paudhësitë e tyre nuk do t'i kujtoj më".**

**18 Edhe kur ka ndjesë të këtyre, nuk ka më dhuratë për mëkat.**

Autori i referohet përsëri Jeremias (31:33-34), të cilin e përmendëm edhe më parë tek 8:8-12. Përzgjedh pikërisht këtë referim, pasi në të **dëshmon Fryma e Shenjtë**, pra bëhet fjalë për vargje profetike për shpëtimin e të Krishterëve. **Sepse pasi pati thënë më përpara: "Kjo është dhiata që do të bëj për ata pas atyre ditëve, do të vë ligjet e mia në zemrat e tyre dhe mëkatet dhe paudhësitë e tyre nuk do t'i kujtoj më".**

Autori thekson se kjo besëlidhje e re përfshin transformimin e zemrave të njerëzve ("..do të vë ligjet e mia në zemrat e tyre..") ku Perëndia **nuk do t'i kujtojë më mëkatet dhe paudhësitë** e tyre. Pra më në fund kemi një zgjidhje të problemit të mëkatit. Sakrifica e vullnetshme e Krishtit solli **ndjesën** e mëkateve, dhe e pastroi zemrën nga balta e tyre. Prandaj **nuk ka më dhuratë për mëkat**, pasi nuk nevojitet

më kjo gjë. Këto vargje profetike theksojnë edhe një herë se Kryepriiftit Jisu iu desh të ofronte vetëm një therore të përjetshme, veten e Tij, dhe nuk do t'i duhej të ofronte më kurrë.

## DISKUTIM

### Mbi flijimin e Krishtit dhe Eukaristinë Hyjnore

Sakrifica e Krishtit mbi Kryq nuk duhet parë vetëm në kuadrin e një ngjarjeje historike, por edhe në atë eskatologjik. “Me anë të Frymës së përjetshme” (9:14) Ai ia blatoi veten Perëndisë vullnetarisht, njëherë e përgjithmonë (7:27), dhe nëpërmjet këtij flijimi të papërsëritshëm ngriti dhe shfarosi gjithë mëkatet e botës.

Gjithmonë Kisha e Shenjtë e ka interpretuar Eukaristinë Hyjnore si një flijim (krahaso me kapitullin 14 të “Didakia-s” [Mësimet], që daton që nga viti 100 ps. K., ku Eukaristisë i referohet si “flijimi yt”). Në fakt, sipas Mësimeve të Kishës, Eukaristia Hyjnore identifikohet me flijimin e Krishtit, dhe prifti që meshon quhet “ofruesi” i blatës tek Perëndia (p.sh. tek Letra e Klementit të Romës drejtuar Korinthianëve, kap 44, e cila daton rreth vitit 95 ps.K.). Edhe në Liturgjinë Hyjnore të ditëve të sotme, i referohemi flijimit eukaristik me të njëjtat terma. Pra si mund të lidhet kjo me atë çka mësojmë nga kjo letër, pra se sakrifica e Krishtit është e përjetshme dhe e papërsëritshme?

Është shumë e rëndësishme të kuptojmë jo vetëm atë çka Kisha na mëson lidhur me këtë temë, por njëkohësisht edhe atë çka nuk na mëson. Kisha nuk na mëson se Krishti vdes trupërisht çdo herë që kremtojmë Eukaristinë, apo përjeton çdo herë të njëjtat vuajtje dhe agoni të Golgothasë. Një mësim i tillë do të binte në kundërshtim me Letrën që po analizojmë. Por nuk është ky kuptimi i flijimit Eukaristik.

Kisha na mëson se Eukaristia është flijim në kuptimin që është “therore e pagjakshme”, pra jo flijim fizik, por racional, mendor dhe shpirtëror (gr. *logikin kai animokton latrian*). Thënë më saktë, është një *anamnisis* apo përkujtim i flijimit të Krishtit përpara Perëndisë. Brenda këtij përkujtimi, ne jetojmë flijimin e Tij të përjetshëm, i cili është i pranishëm aty mes nesh.

Krishti vazhdon të qëndrojë në Qiell përpara Atit, si ndërmjetësi ynë. Ai qëndron në mes të fronit si Qengji i therur (Zb. 5:6), therorja e përjetshme. Në Eukaristinë Hyjnore përkujtojmë dhe jetojmë pikërisht këtë prani të Tijën përpara Atit si një flijim i përjetshëm, duke e bërë kështu të pranishëm edhe aty mes nesh.

Në Predikimin e tij të 17-të drejtuar Hebrenjve, shën Joan Gojarti thotë: “Ne ofrojmë të njëjtin person, jo sot një qengj dhe të nesërmen një tjetër, por të njëjtin... ofrojmë

tani atë që na u ofrua (nga Krishti), e cila nuk mund të shterojë... Nuk ofrojmë një flijim tjetër (në ndryshim nga ai që Krishti flijoi), por të njëjtin, duke përkujtuar sakrificën e Tij.”

Kryepriiftëria qiellore e Krishtit përmbushet në priiftërinë e Kishës sonë të Shenjtë (krahaso me 1 Petr. 2:9), kështu, përmes Liturgjisë Hyjnore, ne marrim guxim dhe i qasemi flijimit të Tij. Vetëm duke pasur Krishtin si Kryepriiftin tonë të lartë, ne, Kisha, Trupi i Tij, denjësohemi që presviterët tanë të shërbejnë si priiftërinj në Shenjtëroren e Tij. Krishti mbetet gjithmonë i pranishëm aty, në të Shenjtat e të Shenjtave, duke qenë Ai vetë Eukaristia jonë. Vetëm falë pranisë së Tij të përjetshme pranë Fronit të Atit mundemi edhe ne të Krishterët të kemi një marrëdhënie kaq të afërt me Perëndinë, dhe kështu të pastrohemi e të hirësohemi për shërimin dhe transformimin thelbësor të qenies sonë.

IV  
TË NGJITEMI FORT PAS KRISHTIT  
(10:19-12:29)

Pasi në kapitujt e mëparshëm pamë se autori u ndal dhe analizoi gjerësisht faktin se Krishti është Kryepriifti i Lartë i Qiejve dhe se Kryepriiftëria e Tij është shumë më e lartë se ajo e priiftërinjve levitë, fillon tashmë t'i zbatojë këto mësimë.

Nëse Ai është vërtet Kryepriifti i Lartë, lexuesit e letrës duhet të ngjiten fort pas Tij! Të mos largohen kurrsesi nga besëlidhja me Të duke u rikthyer në Judaizëm, duke u mbështetur në një mënyrë jetese tashmë inferiore e të vjetërsuar. Nëse do të vepronin kështu, nuk do të merrnin dot falje në Ditën e Gjyqit. Si banorë të popullit të shenjtë të Izraelit, duhej të imitonin etërit e tyre dhe besimin e madh që kishin, teksa pritnin shpërblimin e përjetshëm.

#### 4.1. Mos u tërhiqni nga Adhurimi i Krishterë (10:19-39)

**19 Duke pasur pra, vëllezër, guxim të hyjmë në shenjtërore me anë të gjakut të Jisuit,**

**20 me anë të një udhe të re e të gjallë, të cilën e hapi për ne me anë të kurtinës, domethënë, të mishit të tij,**

**21 edhe duke pasur një priift të madh mbi shtëpinë e Perëndisë,**

**22 le të afrohemi me zemër të vërtetë e me besim të plotë, duke pasur zemrat tona të pastruara prej ndërgjegjeje të ligë;**

Vërejmë se autori iu drejtohet si “vëllezër” jo vetëm të njëri-tjetrit, por në Krishtin, meqenëse janë bërë tashmë pjesëtarë të një thirrjeje qiellore (3:1) dhe kanë **guxim** të hyjnë në shenjtërore (në Parajsë) **me anë të gjakut të Jisuit**. Krishti përgatiti për ne një **udhë të re e të gjallë, të cilën e hapi për ne me anë të kurtinës**.

Autori përdor imazhet e njohura të priiftërisë levitike për të bërë analogji dhe sqaruar për dhiatën e re të Krishtit (krahaso me 9:11-12). Ashtu sikurse kryepriiftërinjtë e atëhershëm hynin në Shenjtëroren e Shenjtëroreve, jo pa gjak (9:7), kështu edhe Krishti, përmes gjakut të Tij, hyri në fronin Qiellor, në mbushullinë e pranisë së Atit. Kryepriiftit tokësor i duhej të kalonte përmes një **kurtine**; Krishtit iu desh të hynte në portat e vdekjes, porta të pahapura kurrë më parë, por që u **hapën me anë të mishit të Tij**. Kjo mënyrë e qasjes ndaj Perëndisë quhej **e re**, sepse Krishti e hapi udhën për



të parën herë në histori; gjithashtu quhej edhe e **gjallë**, sepse Biri, Ndërmjetësi ynë tek Perëndia, rron përjetë.

Kështu, **duke pasur një prift të madh mbi shtëpinë e Perëndisë**, shtëpia e të cilit jemi ne (3:6), të gjithë lexuesit thirren t'i afrohen Atij **me zemër të vërtetë** në Liturgjinë Hyjnore. Pra, të mbetemi besnikë ndaj Krishtit duke i rezistuar çdo filizi të **ligë të ndërgjegjes**, që rrezikon të zhvillohet në zemrat tona. Thirrja për t'u afruar me besim të plotë, me sigurinë se Perëndia do na pranojë dhe ndihmojë, mbetet e hapur për të gjithë. Mund të marrim guxim për këtë, **duke pasur zemrat tona të pastruara prej ndërgjegjeje të ligë**.

Për të analizuar sa thamë më lart, autori ka përdorur sërish një imazh të priftërisë së Tempullit, konkretisht, në përgatitjen e duhur për pjesëmarrjen në adhurim. Tek Numrat 19 jepen rregullat e pastrimit, ku përfshiheshin hedhja e hirit të kafshës së flijuar mbi personat e papastër apo larjen e rrobave dhe të trupit me ujë. Pas këtyre ritualeve, personave të papastër u duhej të prisnin deri në mbrëmje, dhe vetëm atëherë mund të quheshin të pastruar e të denjë për të adhuruar Perëndinë në Tempull.

Në mënyrë të ngjashme, edhe i Krishteri është pastruar dhe denjësuar për t'iu afruar fronit të Perëndisë nëpërmjet Krishtit. Por në ndryshim nga rituali i Tempullit, tashmë nuk pastrohet ana e jashtme, por **ndërgjegjja e ligë**. As nuk nevojitet më larja e trupit dhe pritja gjer në mbrëmje. Trupat e të krishterëve **pastrohen** me ujë të kulluar nëpërmjet Pagëzimit të Shenjtë, me anë të të cilit marrim kurajë për të thirrur emrin e Zotit (Vep. Ap. 22:16).

**23 edhe, duke pasur trupin të larë me ujë të kulluar, le të mbajmë të patundur rrëfimin e shpresës; sepse ai që premtoi është besnik.**

**24 Edhe le të kujdesemi për njëri tjetrin, duke e nxitur në dashuri e në punë të mira.**

**25 Edhe le të mos lëmë mbledhjen tonë të përbashkët, siç e kanë zakon disa, po të nxisim njëri-tjetrin; edhe aq më tepër sa e shihni ditën që po afrohet.**

Duke gëzuar gjithë këto privilegje që përmendëm më lart, autori i fton të lexuesit **të mbajnë të patundur rrëfimin e shpresës**. Ata nuk duhet kurrësi të largoheshin nga besa e tyre në Krishtin, sepse në Të është **shpresa** e shpëtimit. Çfarëdo vështirësie që t'u dilte gjatë rrugës, duhet të qëndronin të patundur. Kjo qëndresë nuk do të mbeste pa shpërblyer, pasi **ai që premtoi është besnik** dhe do ta çojë premtimin deri në fund.

Ajo duhet të mos linin kurrë pas dore përkujdesjen për njëri-tjetrit, **duke e nxitur në dashuri e në punë të mira**. Fjala e përkthyer “nxitje” në greqisht është “*paroxismos*” që faktikisht përkthehet “*provokim*” dhe mbart konotacion negativ. Ndoshta autori e ka përdorur qëllimisht për t’i qortuar butësisht lexuesit e tij për mosmarrëveshjet mes njëri-tjetrit (në vijim do t’i nxitë gjithashtu për “të kërkuar paqe me të gjithë” - 12:14). Në këtë mënyrë, i inkurajon ta transformojnë frymën e tyre konkurruese, duke e drejtuar jo më kundrejt njëri-tjetrit, siç kishin vepruar deri në atë pikë, por duke iu bërë krah vëllezërve. Të inkurajonin njëri-tjetrin duke ecur përpara e duke u thelluar në **dashuri e në vepra të mira** shërbimi dhe bamirësie. Kjo porosi duhet të zbatohet sa më shpejt, sepse dita e fundit nuk do të vonojë dhe nuk ka më kohë për të shpërdoruar. Këto udhëzime presupozonin sigurisht se lexuesit nuk do t’i linin **mbledhjet e përbashkëta**, ku mblidheshin të gjithë si Trup i Krishtit. Nëse largoheshin nga kjo shoqëri, do t’i humbnin gjithçka. Siç kemi thënë dhe më parë, autori i dha këto këshilla në një kohë kur disa të krishterë hebrenj ishin gënjer dhe larguar nga mbledhjet, e vazhdonin të merrnin pjesë në adhurimin e Tempullit, me mendimin se kjo do të ishte më se e mjaftueshme.

**26 Sepse në mëkatofshim ne me dashje, pasi morëm njohjen e së vërtetës, nuk mbetet më theror për mëkate,**

**27 por një pritje gjyqi të frikshëm, edhe një afsh zjarri, i cili ka për të përpirë ata që janë kundër.**

**28 Në shkeltë ndonjë ligjin e Moisiut, vritet pa mëshirë përpara dy a tre dëshmitarëve.**

**29 Sa mundim më të keq ju duket juve se do të heqë ai që ka shkelur me këmbë të Birin e Perëndisë, edhe e ka numëruar si të ndyrë gjakun e dhiatës, me të cilin u shenjtërua, edhe ka fyer Frymën e hirit?**

**30 Sepse e dimë atë që ka thënë: "Shpagimi është imi, unë kam për të shpague, thotë Zoti." Edhe përsëri: "Zoti do të gjykojë popullin e tij".**

**31 Gjë e frikshme është të bjerë njeriu në duart e Perëndisë së gjallë.**

Por adhurimi në Tempull nuk ishte i mjaftueshëm. Në këtë pikë, autori përdor tone paralajmëruese ndaj tyre, duke u thënë se nëse do të vazhdonin të mëkatonin me dashje pasi kishin marrë **njohjen e së vërtetës, nuk do t’u mbetej më theror për mëkate**. Theroret e Tempullit nuk do të kenë asnjë vlerë në Ditën e Gjyqit. Përkundrazi, **një pritje gjyqi të frikshëm, edhe një afsh zjarri, ka për të përpirë ata që janë kundër**. Ky do të ishte shpagimi i braktisjes së Krishtit dhe Kishës së Tij.

Shprehja “**në mëkatofshim me dashje**” duhet kuptuar brenda kontekstit. Vërejmë se qëllimisht është vënë në kohën e tashme, që shpreh një veprim që kryhet vazhdimisht, të kthyer në zakon. Një përkthim alternativ do të ishte: “nëse vazhdojmë të mëkatojmë” apo “nëse mbetemi në mëkate”. Pra nuk bëhet fjalë për një mëkat rastësor që kërcënon rrjedhën e gjithë jetës shpirtërore, por për gjendjen e vazhdueshme të mëkatit të apostazisë, të zgjedhur me vullnet të lirë. Kjo dëshmohet qartë edhe nga fjala “me dashje”, pra “me qëllim” (gr. *ekousios*), të mohosh Perëndinë dhe besëlidhjen e Tij me vetëdije të plotë. Pas një apostazie të tillë, asnjë therore e Tempullit nuk do të kishte fuqi të shpëtonte, por mbetej vetëm **një pritje gjyqi të frikshëm**. Ky gjykim përshkruhet si një **afsh zjarri, i cili ka për të përpirë ata që janë kundër** (gr. *puros zilos*, që fjalë për fjalë përkthehet “*zjarr smire*”). I referohet Isaias 26:11 (LXX): “Smira do ta pushtojë popullin e pamësuar...zjarri do t’i përprijë kundërshtarët”. Në kontekstin origjinal, bëhet fjalë për gjykimin e Perëndisë xheloz (shiko Ligj. Përt. 5:9). Pra autori e përdor në kuptimin e gjykimit të Perëndisë për tradhtinë ndaj dashurisë së Tij, të shfaqur përmes mohimit të Krishtit. I njëjti gjykim do të priste edhe lexuesit, nëse do ta braktisnin besimin e tyre.

Gjykimi në këtë rast është më se i drejtë. **Nëse ndokush shkelte Ligjin e Moisiut**, pra mohonte besëlidhjen me Perëndinë dhe kthehej në idhujtari, **vritej pa mëshirë para dy a tre dëshmitarëve** (Ligj. Përt. 17:2-6). Ky fakt njihej nga i gjithë populli jude. Nëse ndodhte kështu me besëlidhjen e vjetër, **sa mundim më të keq do të heqë ai që ka shkelur me këmbë të Birin e Perëndisë** nëpërmjet mohimit të besës, **edhe e ka numëruar si të ndyrë gjakun e dhiatës së re**, (që dimë se qëndron shumë më lart se e vjetra), **me të cilin u shenjtërua, edhe ka fyer Frymën e hirit?** Një veprim i tillë do të nënkuptonte se mohuesit nuk besonin se Krishti derdhi gjakun dhe dha jetën e Tij si sakrificë hyjnore, por se vdiq thjesht si ndonjë kriminel i rëndomtë. Sa e tmerrshme! Kjo do të thoshte se e mbanin për të ndyrë edhe **gjakun e dhiatës, me të cilin u shenjtëruan** nëpërmjet Kungatës Hyjnore dhe Pagëzimit; dhe një fyerje e rëndë dhe blasfemi ndaj Frymës së Hirit të Perëndisë, gjë që i radhiste ndër armiqtë e Tij (Mark. 3:29-30).

Lexuesit që ndodheshin atëherë në prag apostazie nuk i kishin konceptuar asnjëherë gjërat në këtë formë. Madje në sytë e tyre as nuk quhej mohim besimi, por thjesht një tërheqje nga praktikat e Krishtera si pjesëmarrja në mbledhjet adhuruese dhe shfaqja haptazi e besimit të tyre. Për këtë arsye autori synon të hedhë dritë mbi kuptimin e vërtetë të veprimeve të tyre. Bëhej fjalë për një apostazi, dhe si e tillë do të gjykohej, prandaj duhej patjetër të reflektonin sa ishin ende në kohë.

Sepse e dimë atë që ka thënë në Shkrimet: "**Shpagimi është imi, unë kam për të shpague, thotë Zoti.**" Edhe përsëri (autori shton një tjetër citim të ngjashëm) : "**Zoti do të gjykojë popullin e tij**" (Ligj. Përt. 32:35-36).

Për ta ishte shumë e qartë se Perëndia do të gjykojë popullin e Tij. Kjo gjë është përmendur shumë herë në Shkrimet (Ps. 50:22; 51:4; Ezek. 18:30) dhe e dinin se sa e frikshme është të bjerë njeriu në duart e Perëndisë së gjallë. Nuk ekziston asnjë mënyrë për të justifikuar tradhtinë ndaj Perëndisë, asnjë lehtësim apo anësi. Zoti është Gjykatës i Drejtë, do të drejtësojë të drejtët dhe do të shkatërrojë të pabesët.

## DISKUTIM

### Mbi zemërimin e Perëndisë

Përgjatë gjithë Letrës drejtuar Hebrenjve, autori i nxit vazhdimisht lexuesit që të kujtojnë zemërimin e Perëndisë ndaj kryelartëve dhe të pabesëve. Ky është një koncept kaq i njohur biblik dhe haset përgjatë gjithë Shkrimit të Shenjtë, që në faqet e para e deri në përfundim të tij (shiko Gjen. 3:22-24; Zb.6:16; 22:18-19). Tek lexuesit bashkëkohorë ka filluar të tingëllojë si koncept i pakëndshëm, ndërkohë më parë nuk ekzistonte ky fenomen. Vetëm në ditët e sotme njerëzit kanë arritur ta shohin zemërimin e Perëndisë si diçka problematike, madje deri edhe skandalisëse. Sipas mendimit tim, kjo ndodh sepse brezi ynë po humbet ndjeshmërinë ndaj mëkatit.

Në vitin 1948, C.S. Lewis shkroi: "(Në kohërat moderne) mendjet e njerëzve nuk do ta perceptojnë më ndjenjën e mëkatit... në kohërat e hershme, njerëzit i afroreshin Perëndisë (madje edhe perëndive, në botën pagane) si një i akuzuar i afrohet gjykatësit. Tani duket sikur kanë ndryshuar rolet, njerëzit janë bërë gjykatës, ndërsa Perëndia i akuzuari.

Një mendim i tillë kishte nisur të shfaqej edhe në kohët kur u shkrua kjo letër, pasi është e mbushur me paralajmërime kundrejt pabesisë. Shikoni këto referime:

-“Si do të shpëtojmë ne, në e lëmë pas dore një shpëtim kaq të madh?” (2:3).

-“Prandaj, deri sa mbetet ndër ne një premtim për të hyrë në prehjen e atij, le të kemi pra frikë se mos ndonjë prej jush duket se mbeti jashtë.” (4:1)

-“Po në nxjerrtë driza e gjemba, është e pavlefshme dhe afër mallkimit, fundi i së cilës është të digjet.” (6:8)

-“ Sepse në mëkatofshim ne me dashje, pasi morëm njohjen e së vërtetës, nuk mbetet më thërror për mëkate, por një pritje gjyqi të frikshëm, edhe një afsh zjarri, i cili ka për të përpirë ata që janë kundër. Gjë e frikshme është të bjerë njeriu në duart e Perëndisë së gjallë.” (10:26-27, 31).

-“Shikoni se mos e hidhni poshtë atë që flet; sepse nëse nuk shpëtuan ata që e hodhën poshtë atë që u fliste *atyre* mbi dhé, shumë më tepër *nuk do të shpëtojmë* ne, në i kthefshim krahët atij që flet prej qiejve... Sepse "Perëndia ynë është zjarr që të përpin". (12:25, 29)

Pas të gjitha argumenteve, mësimëve, tipologjive dhe qortimeve të lartpërmendura fshihet rreziku i degradimit të lexuesve dhe tradhtisë së tyre ndaj Zotit, që do të shkaktonte zemërimin e Tij të drejtë.

Prandaj autori përdor kujtimin e Mbretërisë së Perëndisë për t'i nxitur lexuesit në përparim të mëtejshëm, dhe zemërimin dhe gjykimin e Tij për t'i mbajtur larg apostazisë. Siç thotë dhe apostulli Pavli: “duhet të shohim si mirësinë, ashtu dhe ashpërsinë e Perëndisë” (Rom. 11:22) dhe jo t'i shmangemi kësaj të fundit, vetëm sepse brezi ynë nuk e gëlltit dot.

Në të kundërt, nëse kultura jonë na verbon nga zemërimi i drejtë i Perëndisë si pasojë e mëkatit, si do të mundemi ta kuptojmë këtë koncept biblik? Nuk është aspak e lehtë të shkosh përtej kushtëzimeve kulturore. Megjithatë, ka gjithmonë një moment kur jemi të hapur ndaj konceptit të zemërimit të Perëndisë: kur na bren ndërgjegjja. Shumicën e kohës përqendrohemi në aktivitetet tona ditore pa i kushtuar vëmendje zërit të ndërgjegjes, por kur ndiejmë se kemi bërë diçka të gabuar është ndërgjegjja ajo që na qorton. Fillojmë dhe përjetojmë turp dhe bëhemi të ndërgjegjshëm ndaj padenjesisë tonë.

Mendoj se janë pikërisht këto çaste që hedhin dritë mbi gjendjen tonë të vërtetë shpirtërore, gjendjes në të cilën jemi përherë të ekspozuar ndaj Perëndisë dhe engjëjve. Në raste të tilla nuk e konceptojmë më zemërimin e Perëndisë si të padrejtë, por fillojmë ta kuptojmë: është thjesht përgjigja e mirësisë, kur përballet me ligësi. Nëse drejtësia nuk do ta shikonte një rënie të tillë si denigrim, do të pushonte së qeni drejtësi. Këtë të vërtetë arrijmë ta kuptojmë vetëm në këtë gjendje të brejtjes së ndërgjegjes, edhe pse ndoshta nuk e kuptojmë plotësisht. Por kjo mund të na ndihmojë në ndreqjen e ndërgjegjes sonë të pandjeshme ndaj mëkatit, të cilën shoqëria e sotme po përpiqet kaq fort të na e implementojë.

**32 Sillni ndërmend ditët e para, në të cilat, pasi u ndriçuat, duruat luftë të madhe mundimesh;**

**33 herë duke u bërë lojë nga bota me të shara e me shtrëngime; herë duke u bërë pjesëtarë të atyre që pësojnë të tilla.**

**34 Sepse treguat dhimbje për mua në vargonjtë e mi, edhe e pritët me gëzim rrëmbimin e kamjes suaj, duke ditur se keni për veten tuaj në qiejt një pasje më të mirë e të qëndrueshme.**

35 Mos e humbni pra guximin tuaj që do të ketë shpërblim të madh.

36 Sepse ju keni nevojë për durim, që të bëni vullnetin e Perëndisë edhe të merrni premtimin.

Autori nuk resht së inkurajuari lexuesit e tij, duke i nxitur të jenë të qëndrueshëm dhe duke u sjellë ndër mend shpërblimin e madh që u kishte sjellë durimi edhe në të kaluarën. Ishin duke ecur në një rrugë të mirë dhe nuk do të kishte vlerë të dorëzoheshin. Padyshim, nuk mund të mos i mbanin mend **ditët e para** pas Pagëzimit, **në të cilat, pasi u ndriçuan, duruan luftë të madhe mundimesh.** Togfjalëshi "luftë të madhe", në greqisht është shkruar "*athlesis*" (emër që vjen nga folja *athleo* - krahaso me përdorimin tek 2 Tim. 2:5). Ky është edhe burimi i fjalës "atlet" në shqip. Në kontekstin e dhënë, i referohet hebrenjve të krishterë, të cilët e shfaqën veten si atletë të vërtetë të garës shpirtërore, duke duruar plot vuajtje dhe persekutime.

Herë-herë madje u bënë edhe **lojë nga bota**, duke qenë shënjestra të **sharjeve e shtrëngimeve** publike (ndoshta nënkuptohen rrahje apo edhe burgosje). Kishte raste kur treguan dhimbje edhe për të tjerët që pësonin për hir të Krishtit, **duke u bërë pjesëtarë të atyre që pësojnë të tilla.** Kur besimi në Krishtin u bë shkak për **rrëmbimin e kamjes së tyre** (ndoshta pas burgosjes, i rrëmbyen gjithçka që zotëronin), ata e pritën këtë **me gëzim.** Ishin të lumtur që po privoheshin nga çdo gjë materiale, duke ditur se kishin **një pasje më të mirë e të qëndrueshme në qiejt,** të cilën askush nuk mund t'ia rrëmbente dot.

**Guximi** i shpalljes së besimit më Krishtin do t'u siguronte një **shpërblim të madh,** prandaj nuk duhej kurrsesi ta humbnin një thesar të tillë. Në rrugëtimin e mbarë që kishin nisur, u nevojitej **durim** që të vazhdonin të bënin **vullnetin e Perëndisë,** për të marrë **premtimin** (krahaso me 6:12).

37 "Sepse edhe fort pak kohë, edhe do të vijë ai që vjen, edhe nuk do të vonojë".

38 "Edhe i drejti do të rrojë prej besimit"; edhe "në u tërheqtë *ndonjë* prapa, shpirti im nuk do ta pëlqejë atë".

39 Po ne nuk jemi nga ata që tërhiqen prapa për humbje, por nga ata që besojnë për shpëtimin e shpirtit.

Këshillat e autorit shoqërohen si përherë me citime nga Shkrimet. Në versionin grek të librit të Habaukukut 2:3-4 (që ndryshon disi nga versioni hebraik), Perëndia thotë: "Sepse edhe fort pak kohë, edhe do të vijë ai që vjen, edhe nuk do të vonojë. Edhe

**i drejti do të rrojë prej besimit; edhe në u tërheqtë ndonjë prapa, shpirti im nuk do ta pëlqejë atë". "Ai që vjen" është Mesia (shiko Mt. 11:3; Jn. 11:27). Ardhja e Tij e Dytë nuk do të vonojë të vijë, dhe bashkë me të edhe Gjyqi i Fundit. Ndërkohë, i drejti, kushdo që shpreson në Të, do të rrojë prej besimit, duke qëndruar i patundur dhe duke iu përkushtuar me gjithë shpirt Mesisë së Tij. Sepse në u tërheqtë prapa i drejti, shpirti i Zotit nuk do ta pëlqejë atë. Në Ardhjen e Tij të Dytë, apostazia nuk do të mbesë pa u dënuar.**

Sigurisht, autori nuk heziton të qartësojë lexuesit se këto fjalë nuk janë thënë për të treguar se kështu do ta pësonin edhe ata. Toni i fjalëve të tij nuk është aspak kërcënues, përkundrazi, për hebrenjtë e krishterë ishte bërë gati një shpërblim i madh (v.35). Pra nuk ishin nga ata që tërhiqen prapa për humbje, me zemër të kapluar nga pabesia. Përkundrazi, zemrat e tyre qenë të vërteta (10:22). Këta të drejtë besojnë dhe presin shpëtimin e shpirtit. Tek Libri i Habaukukut (2) Perëndia premtoi se **i drejti do të rrojë prej besimit**, dhe është pikërisht ky besim në Krishtin Jisu, që hap dyert e jetës së përjetshme.

#### **4.2. Qëndroni të patundur në besim, sikurse Etërit (11:1- 12:2)**

**1 Edhe besimi është të qenit e gjërave që shpresohen, dëftimi i punëve që nuk shihen.**

**2 Sepse me anë të këtij morën dëshmi të mirë të moçmit.**

**3 Me anë të besimit kuptojmë se jetët u ndërtuan me fjalën e Perëndisë, aq sa ato që shihen nuk u bënë prej gjërave që duken.**

Pasi në fragmentin e mëparshëm (10:38-39) autori i nxit lexuesit të ngulmojnë në besim, si komponenti kryesor që mundëson shpëtimin, tashmë analizon dhe rolin e besimit përgjatë historisë së popullit të Izraelit. Në këtë mënyrë, synon t'i nxitë ata të imitojnë shembullin e të drejtëve të cilët trashëguan premtimin me anë të besimit e të durimit (6:12). Nëse do të qëndronin në besim, atëherë do të mund të quheshin izraelitë të vërtetë, që ecnin në hapat e etërve të tyre. Këta të fundit jetuan gjithë vitet e tyre duke u mbështetur vetëm në premtimin dhe fjalën e Perëndisë, prandaj përbëjnë shembuj të denjë për të gjithë të krishterët. Tani është koha për të dëshmuar besimin - shpërblimi do të vijë më vonë.

Besimi në vetvete nuk nënkupton diçka të prekshme apo që arrihet të shihet, por një shpërblim që pritët në të ardhmen. Ai është **të qenit e gjërave që shpresohen, dëftimi i punëve që nuk shihen**. Për të qëndruar në këto fjalë, siç dëshmohet edhe

tek Habaukuku 2:4, nevojitet besim i fortë në të vërtetat që janë të paperceptueshme nga shqisat. **Sepse me anë të këtij morën dëshmi të mirë të moçmit** e popullit të Izraelit, dhe u pranuan nga Perëndia.

Ata për të cilët u shkrua letra, kishin një bazë të fortë besimi vetëm falë prejardhjes së tyre judaike, sepse si të tillë besonin se Perëndia e krijoi të gjithë botën nga e mosqena. Kjo dogmë i dallonte judenjtë nga të gjithë të tjerët. Besimi i tyre mbështetej fort në gjërat që nuk shihen dhe që nuk mund të perceptohen nëpërmjet shqisave - që ishin fjalët e Perëndisë. I gjithë kozmosi u krijua vetëm me anë të fjalës së Tij. Mjaftoi që Ai të thoshte: "U bëftë dritë", dhe u bë. Prandaj themi se **jetët u ndërtuan me fjalën e Perëndisë**. Një gjë e tillë do të tingëllonte e pamundur për çdokënd që nuk beson, por ne na u bë e njohur nëpërmjet besimit. Ndryshe nuk do të arrinim dot të kuptonim se **ato që shihen nuk u bënë prej gjërave që duken. Si do të mund të perceptojë dikush që nuk beson se gjithçka që ekziston, u ngrit prej hiçit?** Vetëm besimi mund të hapë sytë ndaj një realiteti të tillë.

**4 Me anë të besimit Abeli i ofroi Perëndisë therore më të mirë se Kaini, me anë të së cilës mori dëshmi se është i drejtë, sepse Perëndia dëshmoi për dhuratat e tij; edhe me anë të saj, ndonëse vdiq, ende flet.**

**5 Me anë të besimit Enoku u zhvendos, që të mos shohë vdekje, "edhe nuk gjendej, sepse Perëndia e zhvendosi"; sepse më parë se të zhvendosej kishte dëshmi se i kishte pëlqyer Perëndisë.**

**6 Edhe pa besim është e pamundur t'i pëlqejë njeriu atij; sepse ai që afrohet tek Perëndia duhet të besojë, se është edhe se bëhet shpërblyes për ata që e kërkojnë atë.**

Për të përforcuar më tej argumentin e tij, autori i rikthehet historisë së popullit të Izraelit, duke nisur që nga **Abeli**, i cili i ofroi Perëndisë therore më të mirë se i vëllai, **Kaini** (Gjen. 4:1-5). Therorja e Abelit u bë e pëlqyeshme në sytë e Perëndisë falë **besimit** që ai kishte. Nga ana tjetër, Kaini ishte i padrejtë dhe mëkatoi edhe në ofrimin e tij. Mëkati që e kishte pushtuar triumfoi mbi të, duke sjellë mëkatin tjetër, atë të zilisë për vëllanë. Prej zilisë, Kaini u errësua aq shumë sa që e vrau Abelin (Gjen. 4:6 e në vazhdim). Pra, ky i fundit u lartësua përmbi të vëllanë vetëm për shkak të besimit. Ai iu afrua Perëndisë me një zemër të qashtë, duke i dhënë më të mirën që kishte, sipas përkushtimit të tij të thellë, duke besuar se Zoti do t'ia pranonte ofrimin, por pa pasur asnjë lloj sigurie për këtë gjë. Edhe me të vërtetë **mori dëshmi se është i drejtë, sepse Perëndia dëshmoi për dhuratat e tij**



(supozojmë se kjo nënkupton ndoshta se Perëndia dërgoi zjarr nga qielli për altarin ku do të ofrohej therorja, ashtu siç veproi edhe me profetin Ilia - 1 Mb. 18:38).

Siç përmendëm dhe më lart, Kaini reagoi ndaj kësaj ngjarjeje duke e vrarë të vëllanë, dhe zëri gjaku i Abelit vëngonte që nga toka për drejtësi (Gjen. 4:10). Prandaj edhe në këtë fragment autori shkruan se, ndonëse vdiq, gjaku i pastër i Abelit ende flet nga thellësitë e tokës, duke dëshmuar edhe sot për drejtësinë dhe besimin e tij, vlera të cilat vdekja nuk mundet dot t'i shuajë.

Një tjetër shërbëtor i drejtë që jetoi para përmbytjes ishte dhe Enoku (Gjen. 5:24). Ky ishte gjithashtu i pëlqyer para Perëndisë (Gjen. 5:24 LXX), dhe prandaj **u zhvendos, që të mos shohë vdekje, edhe nuk gjendej, sepse Perëndia e zhvendosi**. Kuptimi i këtyre fjalëve është se Perëndia e mori Enokun trupërisht dhe e shpuri në qiejt, ashtu si Ilian (2 Mb. 2:11). Një interpretim i tillë i këtij fragmenti të Gjenezës mund të shihet qartë edhe tek Urtësia e Sirakut 44:16. Për autorin tonë, ky fakt dëshmon veçanërisht për besimin e madh të profetit, **sepse më parë se të zhvendosej kishte dëshmi se i kishte pëlqyer Perëndisë**. Si Abeli, ashtu edhe Enoku kishin një shpresëtar të thellë dhe jeta e tyre ishte e pëlqyeshme nga Perëndia, megjithëse ata nuk ishin të vetëdijshëm për këtë gjë derisa iu tregua: Abelit - kur iu pranua oferta e tij ndërsa Enokut - kur u lartësua trupërisht, pa parë vdekje. Të dy ushtroheshin dhe qëndronin të patundur në besim, pa pasur asnjë siguri apo provë se Zoti do t'i shpërblente.

Çfarë tregojnë këta dy shembuj? Pa besim (gr. *pistis*) është e pamundur t'i pëlqejë njeriu Perëndisë (gr. *euxaristio* - krahaso me përdorimin tek Gjen. 5:24 LXX ku kjo fjalë përdoret për të përshkruar Enokun). Me të vërtetë, **ai që afrohet tek Perëndia duhet të besojë, se është edhe se bëhet shpërblyes për ata që e kërkojnë atë**. Nuk mjafton thjesht të besojë dikush se ka Perëndi, duhet gjithashtu të besojë se Zoti do t'i shpërblejë të gjithë ata që e kërkojnë. Si Abeli, ashtu edhe Enoku qëndruan gjatë gjithë jetës besnikë në atë që besonin, dhe vetëm në fund morën shpërblimin. I njëjti rrugëtim na pret edhe ne dhe të gjithë ata që besojnë: e tregojmë veten shërbëtorë të denjë të Perëndisë dhe shpresojmë për shpëtimin. Për t'iu afruar të Shumëlartit nevojitet besim i patundur në shpërblimin që ende nuk na është bërë i njohur. Nuk ka asnjë rrugë tjetër. Ata që e braktisin këtë besim nuk do mund të gjejnë asnjë justifikim në Ditën e Gjyqit.

**7 Me anë të besimit iu tregua Noes nga Perëndia për ato që ende nuk shiheshin, edhe si pati frikë Perëndie, ndërtoi një arkë për shpëtim të shtëpisë së tij; me anë të së cilës dënoi botën, edhe u bë trashëgimtar i drejtësisë që është me anë të besimit.**

**Parimin e besimit me shpresën** për shpërblim e shohim të mishëruar edhe në jetën e Noes (Gjen. 6-9). Këtij të fundit **iu tregua nga Perëndia për ato gjëra që ende nuk shiheshin**, më saktë për përmbytjen që do të përfshinte mbarë dheun. Noa ishte një njeri shpresëtar (gr. *evlavitheis* - shiko përdorimin e kësaj fjale si gjymtyrë emërore - *evlavia* - tek Heb. 5:7 dhe 12:28) dhe me frikë Perëndie. Pra, kishte arritur një shpresëtar dhe besim të tillë, si një dritë vezulluese në atë epokë të errët. Duke e nënshtruar veten vullnetarisht tek Perëndia, iu bind dhe **ndërtoi një arkë për shpëtimin e shtëpisë së tij**. Kjo zgjedhje e tij shërbeu si dënim për të gjithë botën, duke dëshmuar se sa rëndë kishin gabuar me talljet e tyre dhe me refuzimin ndaj Perëndisë. Për më tepër, Noe u bë trashëgimtar i drejtësisë dhe triumfit, që është me anë të besimit. Perëndia e drejtësoi në kohën e vërshimit të ujërave që mbuluan të gjithë sipërfaqen e tokës. Ndërkohë, më parë, Noe u kishte bërë vazhdimisht njerëzve thirrje për pendim, por pa rezultat. Në fund, vetëm ai dhe familja e tij dolën të drejtësuar, duke i shpëtuar kështu përmbytjes dhe duke bërë trashëgimtarë të një bote të ripërtërirë.

E gjitha kjo u bë përsëri nëpërmjet **besimit**, ashtu siç pamë edhe në rastet e Enokut dhe të Abelit. Noes gjithashtu iu desh të qëndronte i fortë në besë, për një shpërblim që e mori vetëm më vonë, pas përmbytjes. Deri sa të përmbushej koha, iu desh të ecë para vetëm duke shpresuar në “gjërat që nuk shihen” (11:1).

**8 Me anë të besimit u bind Abrahami, kur u thirr të dalë në vendin që do të merrte për trashëgim, edhe doli pa ditur se ku shkon.**

**9 Me anë të besimit shkoi e banoi në tokën e premtuar si në tokë të huaj, edhe banoi në tenda, bashkë me Isakun e me Jakovin, bashkëtrashëgimtarët e po atij premtimi;**

**10 sepse priste qytetin që kishte themele, mjeshtër edhe krijues i të cilit është Perëndia.**

**11 Me anë të besimit edhe ajo, Sara, mori fuqi të bëhet me barrë, dhe, ndonëse i kishte shkuar koha e moshës, lindi, sepse e quajti të besës atë që i premtoi.**

**12 Prandaj edhe prej një njeriu, edhe ky gati për të vdekur, lindën me shumicë njerëz si yjet e qiellit, edhe si rëra e panumërueshme buzë detit.**

Pas tre shembujve të lartpërmendur, autori kthehet tek arkitektët e mëdhenj të judaizmit: Abrahami, Isaaku, Jakovi dhe Moisiu, jetët e të cilëve përbëjnë shembuj të denjë të besimit.

Kur Abrahami **u thirr** nga Perëndia, u bind dhe doli nga Ur i kaldeasve për të shkuar **në vendin që do të merrte për trashëgim** (Gjen. 12:1 e në vazhdim). Kaq i madh ishte besimi i tij, saqë **u nis pa e ditur se ku shkon**. Udhëzimi i vetëm që kishte marrë prej Zotit ishte të nisej e të ecte nga ta drejtonte Ai, pa pasur as idenë më të vogël për destinacionin e tij. Kështu, ai shkoi dhe banoi në tendën e premtuar, duke jetuar si i huaj **në tokë të huaj**. Megjithëse Perëndia ia kishte caktuar atë tokë për trashëgim, ai u vendos në të sikur të mos e kishte marrë premtimin, madje nuk ndërtoi as shtëpi, duke mos e llogaritur veten si banor të përhershëm të atij vendi. Përkundrazi, vazhdoi jetën si nomad, dhe **banoi në tenda, bashkë me Isaakun e me Jakovin, bashkëtrashëgimtarët e po atij premtimi**.

Abrahami dhe pasardhësit e tij nuk janë thjesht endacakë. Qëllimi i tij nuk ishte të gjente ndonjë vend të përshtatshëm për të qëndruar, ai thjesht po ndiqte Perëndinë plot etje shpirtërore, të cilën bota nuk ia shuante dot. **Priste qytetin që kishte themele, mjeshtër dhe krijues i të cilit është Perëndia**. Të gjitha qytetet e botës janë ndërtuar nga njerëzit, por Abrahami kërkonte një vendbanim më të lartë se ky, sytë e tij ishin të fokusuar përtej horizonteve dhe zemra e tij nuk gjente prehje në këtë botë. Njerëzit e rëndomtë të kohërave tona do ta quanin ëndërrimtar, të zgjuarit do ta shihnin si vizionar, ndërsa çdo i krishterë e ka të qartë se ajo çka ai kërkonte ishte Mbretëria e Perëndisë. **Abrahami** u thirr për të gjetur shtëpinë e tij të vërtetë ne qiejt, ku do të prehej bashkë me të gjithë ata, për të cilët bota nuk ishte e denjë.

Një thirrje e tillë që lartazi iu drejtua edhe **Sarës**, që ishte shterpë, vetëm se në rastin e saj nuk ishte ajo që mori premtimin, por i shoqi. Ajo **mori fuqinë të bëhet me barrë**, ndonëse i kishte shkuar mosha (Gjen. 17:15 e më tej; 21:1 e më tej etj.). Kjo u bë prej besimit të saj, nëpërmjet fuqisë së pamatshme të Perëndisë, **sepse e quajti të besës atë që i premtoi**. I besoi Zotit edhe pse e dinte mirë se ishte e pamundur që një grua në moshën e saj të mbetej shtatzënë. **Prandaj edhe prej një njeriu, edhe ky gati për të vdekur për sa i takon mundësisë për të ngjizur e rritur fëmijë , lindën me shumicë njerëz si yjet e qiellit** (Gjen. 22:17). Kështu, përmes fuqisë së besimit lindi një komb i tërë.

**13** Këta të gjithë vdiqën me besim, pa marrë premtimet, po për së largu i panë dhe i përshëndetën ato, edhe rrëfyen se janë të huaj e të ardhur mbi dhé.

**14** Sepse ata që flasin të këtilla, tregojnë se kërkojnë atdhe.

**15** Edhe po ta mbanin mend atë *atdhe*, prej të cilit patën dalë, do të gjenin kohë të ktheheshin *atje*.

**16** Po tani dëshirojnë *një atdhe* më të mirë, domethënë qiellor, prandaj Perëndisë nuk i vjen turp të quhet Perëndi i tyre; sepse bëri gati një qytet për ta.

Për çfarë u përmendën të gjithë këta shembuj? Besimi i tyre ishte shembulli i qëndrueshmërisë në këtë botë, për një premtim që realizohet përtej saj. Të gjithë këta etër **vdiqën me besim, pa marrë premtimet** që u kishte bërë Perëndia. Megjithatë, **i panë dhe i përshëndetën ato prej së largu**. Nëpërmjet jetës së tyre, rrëfyan se ishin **të huaj e të ardhur mbi dhé**, dhe nuk i takonin një atdheu tokësor. Për të qartësuar më tepër lexuesit, autori shton se **ata që flasin të këtilla**, pra që flasin për të qenët të huaj, **tregojnë se kërkojnë atdhe**. Kur dikush ka mall për atdheun e tij, çdo vend i duket si qëndrim i përkohshëm dhe e pranojnë se janë në mërgim. Mërgimtarët tokësorë i përkasin një atdheu tokësor, prej të cilit u shpëputën e larguan për shkak të luftërave apo katastrofave natyrore. Sapo t'u krijohet mundësia, ata kthehen në vendin e vet pa asnjë hezitim.

Por nuk ndodh kështu me etërit. Nëse ata do **ta mbanin mend atë atdhe, prej të cilit patën dalë** (si p.sh. Uri i kaldeasve), **do të gjenin kohë të ktheheshin atje**. Por duke dëshmuar se **dëshironin një atdhe më të mirë** se Uri apo cilido vend tjetër, tregon se e konsideronin veten si mërgimtarë, në kërkim të një atdheu **qiellor**. Duke parë ndër ta një dëshirë kaq të flaktë për të gjetur strehë pranë Tij, **Perëndisë nuk i erdhi turp të quhet Perëndi i tyre**, prandaj në të gjitha brezat që pasuan Ai u quajt Perëndia i Abrahamit, Isaakut dhe Jakovit. Për më tepër, **bëri gati edhe një qytet për ta**, qytetin e përjetshëm e të përmëdheshëm. Dëshira e këtyre etërve nuk u përmbush gjatë jetës së tyre tokësore, por Perëndia besnik do t'ia përmbushte këtë premtim në Mbretërinë që do të vinte. Prandaj ata mbesin shembuj të denjë të besimit dhe të shpresës për shpërblim.

17 Me anë të besimit Abrahami, kur provohej, pruri Isaakun *për theror*; dhe ai që pati pritur premtimet pruri për *theror birin* e tij të vetëmlindur,

18 për të cilin qe folur: "Se në Isaakun do të quhet fara jote";

19 duke menduar se Perëndia mund të ngjallë edhe prej së vdekurish, prej të cilëve edhe e mori atë prapë simbolikisht.

20 Me anë të besimit Isaaku bekoj Jakovin dhe Esaun për *punët* që do të vinin.

21 Me anë të besimit, Jakovi, duke vdekur, bekoj secilin prej bijve të Josifit, "edhe u fal *duke u mbështetur* mbi majën e shkopit të tij".

22 Me anë të besimit, Josifi, duke vdekur, përmendi për daljen e bijve të Izraelit *nga Egjipti*, edhe porositi për eshtrat e tij.

Besimi i madh i etërve nuk shihet vetëm në endjet e tyre, siç trajtuam në fragmentin paraardhës, por fshihet edhe pas veprave të tjera që kryen. **Abrahami** jo vetëm u nis

si mërgimtar drejt Tokës së Premtuar, duke pritur përmbushjen e premtimit të Perëndisë, por edhe u sprovua prej Tij, kur **pruri Isaakun për theror**. Këtë histori mund ta lexojmë të plotë tek Gjen. 22. Për të sprovuar besnikërinë e Abrahamit dhe për të parë gatishmërinë e tij për t'iu bindur, Perëndia e urdhëroi të sakrifikonte birin e tij të vetëmlindur, Isaakun e dashur, **për të cilin qe folur: "Se në Isaakun do të quhet fara jote"** (Gjen. 21:12). (Isaaku ishte ai që gëzonte statusin e veçantë të të parëlindurit, gjë që nuk e kishte i vëllai, Ishmaeli). Pra Isaaku ishte ai përmes të cilit do të vinin pasardhësit e Abrahamit, duke përmbushur kështu edhe premtimin. Kësisoj, sakrifikimi i të birit do të shënonte humbjen e të gjitha shpresave të tij.

Megjithatë Abrahami e pruri Isaakun në mal, e lidhi dhe ngriti lart thikën me të cilën do ta therorizonte, duke dëftuar kështu një shembull të shkëlqyer të besnikërisë ndaj Zotit. Kjo u bë **me anë të besimit**, dhe Abrahami mendoi se Perëndia **mund ta ngjallte të birin edhe prej së vdekurish**, për të përmbushur premtimin e dhënë. Prandaj kur arritën në rrëzë të malit, u tha shërbëtorëve se do të ngjitej të adhuronte bashkë me të birin, e më pas do të ktheheshin përsëri (Gjen. 22:5), plotësisht i bindur se Perëndia do ta përmbushte premtimin që i dha, qoftë edhe duke sfiduar vdekjen.

Në vazhdim, zëri i Zotit kumboi prej qiellit duke e ndaluar Abrahamin, në momentin që po bëhej gati të flijonte. Kjo histori përbën një simbol apo imazh (gr. *paravoli*) të Ngjalljes së Krishtit, Birit të Vetëmlindur të Perëndisë.

Megjithatë, autori nuk fokusohet më shumë tek kjo e fundit se sa në faktin se Abrahami e pruri Isaakun theror prej **besimit**, duke pritur me bindje të plotë përmbushjen e fjalës së Perëndisë, qoftë kjo edhe duke sfiduar vdekjen.

I njëjti besim i thellë i karakterizoi edhe pasardhësit e shtëpisë së tij. **Me anë të besimit Isaaku bekoi Jakovin dhe Esaun** ndërsa ishte i shkuar në moshë (Gjen. 27:27 e në vazhdim; 39). Kështu, vepra e tij e fundit ishte t'iu sillte të bijve bekimet e Perëndisë. Nuk u foli atyre vetëm për të tashmet, si ndarje pronash apo të ngjashme që përmenden nëpër testamente, por u foli **për punët që do të vinin**, bekimet e ardhshme të Perëndisë dhe besimin se ato do të përmbusheshin edhe pas vdekjes së tij.

**Me anë të besimit**, edhe **Jakovi**, teksa ishte **duke vdekur, bekoi secilin prej bijve të Josifit**, Efraimin dhe Manaseun (Gjen. 48). Nëpërmjet këtij bekimi u shfaq dhe vullneti i Zotit për të dy djemtë, duke i dhënë epërsi më të voglit, Efraimit (Gjen. 48). Një praktikë e tillë binte në kundërshtim me traditën e atëhershme, ku epërsia i takonte djalit më të madh. Mirëpo Jakovi insistoi në fjalën e tij, duke profetizuar kështu një bekim më të madh për të voglin, me sigurinë e plotë se Perëndia do t'ia përmbushte premtimin, sipas fjalëve të tij. Edhe teksa ndodhej në shtratin e vdekjes, iu fal Perëndisë **duke u mbështetur mbi majën e shkopit të tij** (Gjen. 47:31 LXX -

sipas versionit hebraik, u mbështet tek koka e shtratit) gjë që tregon se nuk reshti së qeni pelegrin në këtë botë, prandaj edhe mbështetej në shkopin me të cilin ishte endur gjatë gjithë jetës.

**Me anë të besimit, edhe Josifi, duke vdekur, u kujtoi të bijve për daljen e bijve të Izraelit nga Egjipti** (Gjen. 50:24-25). Nga historitë e paraardhësve të tij, Josifi e dinte mirë se Perëndia u kishte premtuar pasardhësve të tij tokën e Palestinës, mbi të cilën ishte endur ati i tyre Abrahami. Duke qenë plotësisht i sigurt për realizimin e premtimit, porositi të bijtë për eshtrat e tij, dhe u tha t'i mblidhnin e t'i merrnin me vete në Palestinë kur të vinte koha që do të largoheshin nga Egjipti.

**23 Me anë të besimit Moisiu, si lindi, u fsheh tre muaj prej prindërve të tij, sepse panë se djali ishte i bukur; edhe nuk u trembën nga urdhri i mbretit.**

**24 Me anë të besimit Moisiu, si u bë i madh, mohoi të quhej i biri i së bijës së Faraonit;**

**25 sepse zgjodhi më tepër të heqë keq bashkë me popullin e Perëndisë, se të ketë kënaqësi mëkati për pak kohë;**

**26 duke numëruar poshtërimin e Krishtit për pasuri më të madhe se thesaret në Egjipt; sepse shikonte në shpërblimin.**

**27 Me anë të besimit la Egjiptin pa pasur frikë për zemërimin e mbretit; sepse qëndroi si duke parë atë që është i padukshëm.**

**28 Me anë të besimit bëri pashkën dhe spërkatjen e gjakut, që të mos i prekte ata ai që vriste të parëlindurit.**

**29 Me anë të besimit shkuan nëpër Detin e Kuq si nëpër tokë, veprim të cilin kur e provuan Egjiptianët, u mbytën.**

Jo vetëm etërit e lartpërmendur ecën me besim, por edhe vetë Moisiu. Madje, në rastin e këtij të fundit, elementi i besimit iu bë pjesë e pandarë që kur lindi, si **u fsheh tre muaj prej prindërve të tij**, me qëllim për t'u mbrojtur nga Faraoni, i cili kishte urdhëruar vrasjen e të gjithë foshnjave meshkuj (Eks. 1:15 e në vazhdim). Prindërit e Moisiut **panë se djali ishte i bukur**, dhe **nuk u trembën nga urdhri i mbretit**. Bukurinë e tij e morën si shenjë të një bekimi nga Perëndia, që do ta shoqëronte përgjatë gjithë jetës, prandaj e ruajtën të fshehur. Sigurisht, nuk është aspak e lehtë të mbash të fshehur një foshnjë që qan, prandaj pas tre muajsh vendosën t'ia besonin Perëndisë. Përgatitën për të një kanistër prej xunkthi, e vunë brenda dhe e lëshuan në ujërat e lumit Nil. Më pas, sipas vullnetit të Zotit, atë e gjeti një nga bijat e faraonit, e cila e mori dhe e rriti në pallatin mbretëror.

Dora e Zotit ishte gjithmonë mbi të, dhe **si u bë i madh, mohoi të quhej i biri i së bijës së Faraonit, sepse zgjodhi më tepër të heqë keq bashkë me popullin e Perëndisë, se të ketë kënaqësi mëkati për pak kohë.** Ai mund të kishte zgjedhur alternativën më të lehtë: të qëndronte në pallatin mbretëror duke shijuar jetën e tij tokësore. Në këtë mënyrë nuk do të shpëtonte dot pa **mëkat**, sepse zgjedhja e kësaj jete do të thoshte braktisje e Perëndisë dhe popullit të Tij. Por Moisiu nuk ishte i tillë. Ai u bashkua me vuajtjet e popullit të vet, madje shkoi deri aty sa vrau një egjiptian që po rrihte një burrë hebre (Eks. 2:11 e në vazhdim). Me këtë veprim, e numëroi veten me ata që do të hiqnin keq. Këtë e bëri me ndërgjegje të plotë, duke mohuar **thesaret e Egjiptit**, të cilat i takonin si bir i të bijës së faraonit, **sepse shikonte në shpërblimin.**

Poshtërimi me të cilin u përball Moisiu dhe populli i Izraelit cilësohet nga autori si **poshtërimi i Krishtit**, pasi edhe Atij iu desh të duronte vuajtjet dhe torturat e judenjve, ashtu siç ishin thirrur të duronin edhe lexuesit e kësaj letre. Këta të fundit duhet të qëndronin besnikë ndaj Zotit, edhe sikur kjo t'i armiqësonte me popullin e vet. Ashtu sikurse Moisiu la familjen e tij (egjiptiane) për hir të Perëndisë, edhe ata duhej të ishin gati të linin pas familjet e tyre (judease) nëse do të ishte nevoja. Kur **me anë të besimit Moisiu la Egjiptin**, ai gjithashtu la pas të gjithë jetën që kishte jetuar deri në atë moment. Tek Eksodi përshkruhet hollësisht zemërimi i Faraonit dhe dëshira e tij e zjarrtë për të vrarë Moisiun (Eks. 2:15). Megjithatë, ky i fundit nuk u trondit aspak, përkundrazi, i duroi të gjitha sprovat **pa pasur frikë për zemërimin e mbretit**, gjeti strehë në Midian, pa Perëndinë në shkurren që flakë nxirrte dhe nuk digjej dhe së fundmi u kthye përsëri për t'u përballur me Faraonin (Eks. 2:15; 3:1 e më tej, 5:1). Gjithë kjo qëndresë i atribuohet besimit në atë **që është i padukshëm**, i Cili Moisiut i qe bërë i dukshëm me sytë e shpirtit.

Përsëri **me anë të besimit bëri pashkën dhe spërkatjen e gjakut, që** bijtë e shtëpisë së Izraelit **të mos i prekte** engjëlli i vdekjes, **që vriste të parëlindurit** (Eks. 12). Pas të gjitha këtyre, Faraoni u bind dhe i liroi hebrenjtë, por nuk kaloi shumë kohë dhe zemra e tij u ngurtësua përsëri dhe dërgoi ushtrinë e tij për t'i kthyer mbrapsht. Edhe përballë një vështirësie të tillë, Moisiun nuk e lëshoi zemra. **Me anë të besimit**, Izraeli **shkoi nëpër Detin e Kuq si nëpër tokë.** Fakti se bëhet fjalë për një mrekulli për hir të besimit dëshmohet nga ajo që u ndodhi egjiptianëve kur u përpoqën të kalonin detin, dhe **u mbytën** (Eks. 14).

Si përfundim, mund të themi pa ngurrim se e gjithë jeta e Moisiut ishte ndërtuar mbi besim në providencën e Perëndisë. Prindërit ia dorëzuan ujërave të lumit Nil, duke shpresuar se Zoti do të kujdesej për të. Më pas, kur u rrit, mohoi trashëgiminë e tij egjiptiane duke besuar se Perëndia do ta udhëhiqte. Kremtoi Pashkën duke

spërkatur dyert e izraelitëve me gjakun e therores, duke qenë i bindur se në këtë mënyrë nuk do t'i prekte engjëlli i vdekjes. Në orën më të vështirë, goditi ujërat e Detit të Kuq me shkopin e tij, i bindur se ato do të tërhiqeshin duke hapur një shteg kalimi për popullin e Perëndisë, e më pas do të ktheheshin në gjendjen e tyre të mëparshme, duke mbytur ushtrinë e Faraonit. E gjithë jeta e tij karakterizohet nga urtësia me të cilën përballoi çdo sfidë, me shpresë në shpërblimin e Perëndisë.

**30 Me anë të besimit ranë muret e Jerikosë, si u rrethuan shtatë ditë.**

**31 Me anë të besimit lavirja Rahab nuk humbi bashkë me ata që s'bindeshin, pasi priti zbuluesit me paqe.**

E gjithë historia e popullit të Izraelit është mbushur me shembuj të besimit, si parimi kryesor i jetës së tyre, që do t'u sillte shpëtimin. Edhe pas çlirimit nga robëria e Egjiptit, ata patën shumë fitore për hir të besës që kishin. Kur hynë në Tokën e Premtuar dhe Jisui i Naviut pushtoi Jerikonë, muret e qytetit ranë përpara fuqisë së paepur të Perëndisë, pasi i kishin mbajtur të **rrethuar për shtatë ditë** (Jis. Nav. 6). Në këto ditë, Izraeli marshonte rreth qytetit duke i rënë trumbetave, me besimin se Zoti do t'i rrëzonte muret rrethuese, duke e ekspozuar Jerikonë ndaj tyre. Me të vërtetë u bë ashtu siç kishin shpresuar, megjithëse gjatë atyre ditëve nuk kishin asnjë provë se Perëndia po vepronte në favor të tyre. Ata udhëhiqeshin vetëm nga besimi, i cili në fund u solli fitoren.

Pas rënies së qytetit, shumë vetë besuan dhe u shpëtuan, jo vetëm populli i Izraelit por edhe paganë si lavirja Rahab, e cila pranoi Perëndinë dhe priti zbuluesit me paqe, kur këta erdhën për të vëzhguar vendin (Jis. Nav. 2:1 e më tej; 6:22 e më tej). Kështu, duke u varur tek Perëndia i Izraelit, nuk humbi bashkë me ata që s'bindeshin. Duke qenë e ardhur nga familje paganësh, të pabindur ndaj Perëndisë dhe të zhytur në idhujtari, edhe asaj i takonte i njëjti fund si ata. Por duke ia hapur zemrën Perëndisë së Izraelit, ajo u rendit ndër ata që besuan. Kur muret e Jerikosë u shembën, ajo mbeti e pacenuar në shtëpi të saj, së bashku me familjen. Besimi në Zotin i dha jetë dhe shpëtim.

**32 Edhe ç'të them më? Sepse nuk do të më arrijë koha të tregoj për Gedeonin, për Barakun e Samsonin, edhe Jeftanë, për Davidin e Samuilin dhe profetët,**

**33 të cilët me anë të besimit mundën mbretëri, punuan drejtësi, fituan premtime, mbyllën gojë luanësh,**



34 shuan fuqinë e zjarrit, shpëtuan nga tehu i thikës, morën fuqi nga dobësitë, u bënë të fortë në luftë, thyen ushtritë e të huajve.

35 Gra morën të vdekurit e tyre të ngjallur; edhe të tjerë u munduan, sepse nuk pranuan shpëtimin, që të fitonin një ngjallje më të mirë.

36 Edhe të tjerë u provuan me të përqeshura e me të rrahura, po edhe me të lidhura e me burgime.

37 U vranë me gurë, u sharruan më dysh, u nganë, vdiqën të vrarë prej shpate; endeshin lart e poshtë *veshur* me lëkurë dhensh, e me lëkurë dhish, në nevojë, në shtrëngime, në keqtrajtme, -

38 *ata* për të cilët bota nuk ishte e denjë; - duke u endur nëpër shkretëtira e nëpër male e nëpër shpella e nëpër vrimat e dheut.

39 Edhe këta të gjithë, ndonëse morën dëshmi të mirë me anë të besimit, nuk morën premtimin,

40 sepse Perëndia pati urdhëruar që parë një gjë më të mirë për ne, që të mos bëhen të përsosur pa ne.

Autori nuk zgjatet që të përmendë historitë e të gjithë bijve të Izraelit, të cilët u shpëtuan përmes besimit, sepse **nuk do t'i arrinte koha** t'i trajtonte të gjithë, aq të shumtë sa ishin. Për këtë arsye përmend kalimthi vetëm emrat e tyre dhe ngjarjet, për të dëshmuar edhe më tepër për rëndësinë e madhe të besimit.

Ndër të tjerë përmend **Gedeonin** (Gjyq. 6-8), i cili e çliroi Izraelin nga midianët, këta armiq të tmerrshëm, duke shpresuar vetëm në ndihmën hyjnore. Vazhdon më tej me **Barakun** (Gjyq. 4-5) i cili gjithashtu korri një fitore triumfuese kundër kananeasve. (Mesa duket, autori përmendi Gideonin para Barakut sepse ai ishte më i njohuri, pavarësisht se nga ana kronologjike vjen pas Barakut.) Nuk le pa përmendur edhe **Samsonin** (Gjyq. 13-16) i cili mbështetej në fuqinë e Perëndisë ndaj çdo sulmi të filistinëve. Tregon gjithashtu për **Jeftanë** (Gjyq. 11-12) i cili besoi se Perëndia do t'u siguronte fitoren kundër amonitëve, pasi i kishte premtuar Zotit se do të flijonte këdo që të dilte ta priste nga shtëpia e tij nëse kthehej fitimtar. Së fundmi flet dhe për **Davidin dhe Samuelin dhe profetët**, duke përfshirë këtu të gjithë heronjtë përgjatë historisë së popullit të Izraelit, të përshkruar në Dhiatën e Vjetër (përsëri përmendet Davidi i pari, si më i spikaturi ndër ta). Të gjithë këta që përmendëm më lart janë bërë heronj vetëm nëpërmjet besimit të patundur tek Perëndia, nga i Cili morën edhe shpërblimin.

Pasi përmendi emrat, autori rendit edhe një sërë ngjarjesh të jashtëzakonshme, të realizuara përmes besimit. Disa njerëz, si p.sh. Moisiu **mundën mbretëri** (atë të Sionit dhe të Ogut - Num. 21:21 e më tej). Të tjerë **punuan drejtësi**, si në rastin e Danielit kur mbrojti pafajësinë e Suzanës (Suz. 44). Disa **fituan premtime**, si Davidi, të cilit Perëndia i premtoi se mbretëria e tij do të rronte përjetë (2 Sam. 7). Danieli mbylli gojë luanësh (Dan. 6); miqtë e tij Shadraku, Meshaku dhe Abednego **shuan fuqinë e zjarrit** (Dan. 3). Të tjerë, si Ilia dhe Eliseu u arratisën dhe **shpëtuan nga tehu i thikës**, kur Perëndia i ruajti nga ata që kërkonin t'i merrnin jetën (1 Mb. 19:2 e në vazhdim; 2 Mb. 6:31 e në vazhdim).

Gideoni dhe Samsoni **morën fuqi nga dobësitë**, pasi Perëndia i denjësoi të dilnin triumfues ndaj armiqve të tyre (Gjyq. 6, 16). Davidi **u bë i fortë në luftë** (2 Sam. 8), ndërsa të tjerë si Judita **thyen ushtritë e të huajve** (Jud. 13). **Gratë morën të vdekurit e tyre të ngjallur**, nëpërmjet profetëve Ilia dhe Elise (1 Mb. 7; 2 Mb. 4). **Edhe të tjerë**, si Eleazari dhe shtatë martirët makabenj, **u munduan, sepse nuk pranuan shpëtimin** që do t'i jepej në rast se mohonin besimin, por qëndruan të fortë që të **fitonin një ngjallje më të mirë** (4 Makabejve). **Edhe të tjerë**, si Jeremia, **u provuan me të përqeshura e me të rrahura** për shkak të besnikërisë ndaj Zotit (Jer. 20), **po edhe me të lidhura e me burgime**. Madje kishte raste që edhe **u vranë me gurë**, si në rastin e Zaharisë, të birit të Jehoadës (2 Kr. 24:20-21). Sipas traditës, Isaia **u sharrua më dysh**. Ndërkohë, shumë të tjerë, bashkëkohës të Ilias, **vdiqën të vrarë prej shpate** (1 Mb. 19:10). Makabejtë **endeshin lart e poshtë veshur me lëkurë dhensh, e me lëkurë dhish nëpër shkretëtira e nëpër male e nëpër shpella e nëpër vrimat e dheut** (2 Mak. 5:27; 10:6), duke hequr persekutime e **keqtrajtme**. Këta ishin njerëz për të cilët **bota nuk ishte e denjë**, prandaj nuk ishin të botës, por i përkisnin Mbretërisë që do të vinte.

Të gjithë këta, që nga Abeli e deri te ata më të vonshmit, **ndonëse morën dëshmi të mirë me anë të besimit, nuk morën premtimin**. Perëndia u kishte dëshmuar se ishin bërë të denjë për të parë lavdinë e Tij, dhe ndonëse iu dha ky si premtim, nuk e morën atë. Por përse vallë? Pikërisht **sepse Perëndia pati urdhëruar që parë një gjë më të mirë për të krishterët, që etërit dhe profetët të mos bëheshin të përsosur pa ne**. Të krishterëve iu dha i njëjti premtim si dhe etërve. Ishte vullneti i Perëndisë që shpërblimi t'u jepet të gjithëve në të njëjtën kohë, në botën që do të vijë. Prandaj lexuesit e kësaj letre u thirrën të qëndrojnë të fortë në besim. Me të vërtetë atyre iu ishte premtuar një shpëtim i lavdishëm, për të cilin ia vlen të pritët.

**1 Prandaj dhe ne, të rrethuar prej një reje kaq të madhe dëshmitarësh, le të hedhim tej çdo barrë dhe mëkatin që na pushton lehtë, edhe me durim le të vrapojmë në rrugën që është përpara nesh,**

**2 duke shikuar tek Jisui që është kryet dhe fundi i besimit, i cili për gëzimin që ishte përpara tij duroi kryqin, duke përbuzur turpin, edhe ndenji në të djathtë të fronit të Perëndisë.**

Në këtë fragment, autori i përmbledh edhe një herë të gjithë ata që morën dëshmi të mirë me anë të besimit (11:39). Perëndia dëshmoi për ta, duke u dhënë pëlqimin e Tij, dhe tani, vetë ata qëndrojnë si një **re dëshmitarësh** (gr. *martus*) për të krishterët e tjerë që sprovohen. Ata e kanë luftuar luftën e tyre deri në fund, dhe tani presin shpërblimin. Kështu, tani u japin kurajë të krishterëve të cilët janë ende në fushëbetejë, për të arritur qëllimin e tyre të përbashkët.

Imazhi që jepet këtu është ai i garave atletike. Të krishterët të cilëve u drejtohet letra, u ngjajnë vrapuesve të garave. **Reja e dëshmitarëve** triumfues i përngjan spektatorëve që qëndrojnë në tribuna, rreth e qark vrapuesve. Tani është koha e këtyre të fundit **për të vrapuar në rrugën që është përpara** tyre. Ashtu si atletët nuk mund të ndalojnë dot pa arritur tek vija e përfundimit, kështu edhe të krishterët nuk mund të ndalojnë përpjekjet e tyre për t'i shërbyer Krishtit. Dimë se përpara garave, vrapuesit **hedhin tej çdo barrë**, çdo rrobë apo aksesori që i rëndon dhe i pengon të vrapojnë drejt fitores. Në të njëjtën mënyrë, dhe i krishteri thirret të hedhë tej barrën e **mëkatit që e pushton lehtë**, duke intensifikuar përpjekjet shpirtërore. Kjo nënkupton largimin nga çdo lloj imoraliteti a mëkati trupor (v.16), duke rendur drejt shenjtërimin (v.14). Vrapuesit tokësorë e mbajnë shikimin e tyre të përqendruar vetëm tek vija e përfundimit, ndërsa të krishterët shikojnë tek **Jisui**, që është **kryet dhe fundi**, Ai që bëri gati udhën për ta (krahaso me 2:10) dhe që do t'i bëjë pjesëtarë të lavdisë së Tij, kur të përmbushet koha (jo vetëm të shenjtët e besëlidhjes së re, por edhe të vjetrës - 11:40).

Vetë jeta tokësore e Jisuit shërbente si shembull i kësaj gare. Ai **duroi kryqin, duke përbuzur turpin** dhe duke mos e lënë poshtërimin të bëhej barrierë për arritjen e qëllimit të Tij. Teksa lutej në kopshtin e Gjethsemanisë, hija e errët e kryqit kishte pllakosur mbi të, duke sjellë me vete gjithë turpin, e megjithatë as kjo nuk e ndaloi që të përmbushte vullnetin e Atit. Perëndia i dha Atij çdo pushtet dhe lavdi, dhe **ndenji në të djathtë të fronit** të Atit. Për hir të këtij gëzimi që do të vinte, Jisui duroi kryqin. Tani edhe dishepujve u duhet të ecin sipas gjurmëve të Tij. Përpara tyre gjendet e njëjta garë, në të cilën duhet edhe ata të vrapojnë me durim. Në vijën

përfundimtare i pret vetë Krishti (bashkë me shenjtët e tjerë të Izraelit që kanë dalë triumfues), për t'i dhënë kurorën e lavdisë. Të gjithë ata duhet t'i mbajnë sytë tek ai dhe të ecin me besë.

#### 4.3. Pranoni vuajtjet si Bij të Perëndisë (12:3-29).

**3 Sepse kujtoni atë që duroi prej mëkatarëve një kundërshtim të tillë mbi veten e tij, që të mos lodheni duke u ligështuar në shpirtrat tuaj.**

**4 Ju ende s'keni rezistuar deri në gjak, duke luftuar kundër mëkatit.**

Përgjatë garës do të hasnin tundime të tilla që do t'i **ligështonin shpirtrat** e tyre, si pasojë e përballjes me bashkëkombësit e tyre judenj, madje deri aty sa të lodheshin e të braktisnin garën. Gjatë këtyre sprovave të tilla, duhet të kujtonin atë që **duroi prej mëkatarëve një kundërshtim të tillë mbi veten**. Duke përjetuar të njëjtat vuajtje e mundime, Jisui e dinte shumë mirë çfarë do të thotë të mos të të kuptojnë, të shpifin pa arsye, madje edhe të fshikullojnë e të vrasin. Duhet të mos i harronin vuajtjet e Tij për asnjë moment, dhe të kujtonin se atyre nuk u ishte dashur të duronin kaq shumë sa Ai. **Ende nuk kishin rezistuar deri në gjak, duke luftuar kundër mëkatit**. Vërtet, edhe ata ishin munduar, por jo deri aty sa të pësonin vuajtje martirike dhe vdekje.

**5 Edhe keni harruar këshillën, që posi bijve u flet juve: "Biri im, mos e shpërfill ndëshkimin e Zotit; mos e humb zemrën, kur qortoresh prej atij.**

**6 Sepse atë që do Zoti e ndëshkon, edhe rreh çdo bir që pret pranë vetes".**

**7 Në durofshi ndëshkimin, Perëndia sillet me ju si me bij; sepse cili është ai bir që s'e ndëshkon i ati?**

**8 Po të jeni pa ndëshkim, në të cilin u bënë pjesëtarë të gjithë, atëherë jeni fëmijë të paligjshëm dhe jo bij.**

**9 Për më tepër ne kemi pasur etërit tanë sipas mishit që na ndëshkonin edhe ne i nderonim ata; a nuk do t'i ulim kryet shumë më tepër Atit të shpirtrave, edhe të rrojmë?**

**10 Sepse ata na ndëshkonin për pak ditë, siç e mendonin ata; ndërsa ai për të mirën tonë, që të bëhemi pjesëtarë të shenjtërisë së tij.**

**11 Edhe çdo ndëshkim tani nuk duket se sjell gëzim, po hidhërim; por pastaj u jep fryte paqeje prej drejtësie atyre që janë stërvitur me anë të atij.**

Nga lëkundja e besimit të tyre dallohej qartë se e kishin anashkaluar e harruar këshillën që thuhet në Shkrimet, ku atyre iu adresohet si bij të Perëndisë. Në versionin grek të Septuagintës të Fjalëve të Urta 3:11-12 thuhet: "**Biri im, mos e shpërfill ndëshkimin e Zotit; mos e humb zemrën, kur qortohesh prej atij. Sepse atë që do Zoti e ndëshkon, edhe rreh çdo bir që pret pranë vetes**". Këto fjalë e shpjegojnë shumë qartë mënyrën se si Perëndia vepron me ata që i do si bijtë e Tij.

Ashtu si etërit e asaj kohe, të cilët preokupoheshin për formimin e karakterit të bijve dhe trashëgimtarëve të tyre, dhe i qortonin e i ndëshkonin për t'i disiplinuar (krahaso me Fj. Urta 13:24; 19:18), edhe Perëndia i lejonte të përjetonin vuajtje e persekutime. Sado që të kenë ndryshuar kohërat, që nga periudha e Solomonit e deri më sot, përsëri nuk ndryshon fakti se prindërit duan që bijtë e tyre të rriten me moral dhe integritet, edhe nëse kjo do të thotë të kalojnë përmes vështirësive e mundimeve. E njëjta gjë vlen edhe për Perëndinë. Edhe Ai do që bijtë e Tij të radhiten ndër shenjtorët, pavarësisht kostove që mund të sjellë kjo gjë, ku ndër të tjera përfshihen edhe persekutimet nga të pabesët, të cilat Ai i lejon.

Për këtë arsye, autori i këshillon lexuesit të **mos e humbin zemrën**, e as të dyshojnë për mirësinë e Tij kur të **qortohen**, e as kur zjarri i persekutimit t'u tronditë guximin. Fakti që Perëndia i lejon këto gjëra të ndodhin dëshmon se Ai kërkon të pastrojë zemrat e gjithsecilit përmes mundimeve.

Perëndia **sillet** me ta **si bij**, duke i ndëshkuar ashtu si çdo atë do të ndëshkonte birin dhe trashëgimtarin e tij. Madje nëse nuk do të ndëshkoheshin, atëherë do të mund t'u lindte pyetja nëse Perëndia preokupohej vërtet për shenjtërimin e tyre apo jo. Nga përvoja jonë tokësore e dimë se ata fëmijë që rriten të përkëdhelur e pa disiplinë janë për të ardhur keq. Askush nuk i quan prindërit e tyre të mirë, përkundrazi, cilësohen si tepër tolerantë. Në kohërat e lashta, një tolerancë e tillë i jepej vetëm **fëmijëve të paligjshëm, jo bijve**.

Nuk kishte asnjë arsye që të krishterët hebrej, të cilëve u drejtohet letra, ta bënin Perëndinë fajtor për pësimet e tyre. Ata kishin etërit e vet sipas mishit (pra etërit biologjikë) **që i ndëshkonin, dhe i nderonin ata**, duke mos e çuar aspak nëpër mend se po tregoheshin të padrejtë. **A nuk do të duhej t'i ulnin kryet shumë më tepër Atit të shpirtrave, edhe të rronin?** Pasi etërit tokësorë i **ndëshkonin për pak ditë** (pra, brenda një hapësire të caktuar kohore, gjatë fëmijërisë së tyre) madje duke mos pasur ndonjë urtësi të lartë, por **për të mirën** e tyre, **siç e mendonin ata**. Madje, në disa raste edhe mund ta kishin tepruar me dënimin. Ndërsa Ati Qiellor disiplinon me urtësi absolute, **për të mirën** e tyre, që të bëhen **pjesëtarë të shenjtërisë së Tij**.

Padyshim që nuk ishte aspak e lehtë për të krishterët hebrej të kuptonin se persekutimi që po vuanin, ishte **për të mirën** e tyre. Natyra njerëzore priret t'i

shmanget sa më shumë vuajtjeve dhe sapo përballet me to, dyshon në mirësinë e Perëndisë. E njëjta situatë haset edhe në rastin e etërve dhe bijve, ku çdo ndëshkim i tyre nuk duket se sjell gëzim dhe momentalisht nuk ka kurrfarë vlerësimi për të mirën që do të sjellë ky ndëshkim. Asnjë fëmijë nuk e do disiplinën, përkundrazi, ajo shoqërohet me shumë **hidhërim** e zemëratë, **por pastaj**, teksa rriten, kuptojnë se **u jep fryte paqeje prej drejtësie atyre që janë stërvitur me anë të atij**. Atëherë i vlerësojnë me të vërtetë etërit e tyre. Në të njëjtën mënyrë edhe ne, pasi të ketë përfunduar koha e vuajtjeve dhe mundimeve, do t'i jemi mirënjohës Perëndisë për përpjekjet shpirtërore shenjtëruese që kanë mbartur me vete gjithë sprovat e jetës. (shiko 1 Petr. 4:1, 14).

**12 “Prandaj forconi duart e dobësuara dhe gjunjët e këputur”,**

**13 Edhe “bëjuni këmbëve tuaja udhë të drejta”, që të mos dalë jashtë udhës ajo që është e çalë, por më tepër të shërohet.**

**14 Kërkoni paqe me të gjithë, edhe shenjtërimin, pa të cilin asnjë nuk ka për të parë Zotin;**

**15 duke vënë re se mos mbetet ndonjë mangët nga hiri i Perëndisë “se mos mbijë ndonjë rrënjë e hidhur, e ju turbullon”, edhe me anë të saj ndyhen shumë veta;**

**16 Se mos ndodhet ndonjë i përdalë e përdhosës si Esau, që shiti të drejtat e parëlindjes së tij për një pjatë gjellë.**

**17 Sepse e dini, se edhe pastaj, kur deshi të trashëgojë bekimin, u hodh tej; sepse nuk gjeti vend për pendim, ndonëse e kërkoi me lot.**

Prandaj, veçanërisht të krishterëve hebrej iu bë thirrje të ishin të qëndrueshëm në garën shpirtërore, të ndalonin lëkundjet e besnikërisë së tyre ndaj Krishtit, pavarësisht të gjitha vuajtjeve që priteshin, si rezultat i këtij besimi. Në momentin që autori shkroi këto vargje, gjendja e tyre ishte si ajo e një atleti të lodhur, me krahë të drobitur dhe gjunjë të squllur. Nëse vazhdonin ashtu, nuk do të arrinin dot deri në vijën përfundimtare, prandaj nevojitej sa më shpejt të mblidhnin veten e të merrnin zemër, të forconin **duart e dobësuara dhe gjunjët e këputur**. T'u bënin **këmbëve të tyre udhë të drejta, që të mos dilte jashtë udhës ajo që është e çalë, por më tepër të shërohej**. Nëse largoheshin nga rruga e drejtë e Krishterimit për t'u endur nëpër rrëpirat e thepisura të kompromisit, aq më tepër do t'u përkeqësohej pjesa e **çalë** e trupit, saqë do të dilte **jashtë udhës** e do të këputej fare.

Mënyra e zbatimit të kësaj porosie në jetën komunitare, nënkuptonte të bënin paqe me të gjithë, edhe shenjtërimin, pa të cilin asnjë nuk ka për ta parë Zotin. Plogështia shpirtërore kishte rezultuar për ta edhe në plogështi morale. Duke ecur sipas botës,

kishin filluar grindjet me të afërmit e tyre, imoralitetet, zemërashpërsia etj. të cilat qëndronin si barriera në rrugën për në Mbretërinë e Perëndisë. Prandaj autori thekson se pa arritur shenjtërinë, nuk do të mund të shohin Zotin në Ditën e Fundit (krahaso me 1 Kor. 6:9-10).

Asnjë **i përdalë** nuk mund të lejohej të qëndronte në mes tyre (gr.  *pornos*, mbiemër i prejardhur nga emri  *pornia* - kurvëri), asnjë **përdhosës**, qoftë i papastër, i ligë apo i ndyrë me gjërat e botës. Të krishterët duhej patjetër t'i vinin re këto gjëra (gr.  *episkopeo*, krahaso me përdorimin tek 1 Pet. 5:2) dhe të siguroheshin mos të mbetej ndonjë mangët nga hiri i Perëndisë. Nëse individë të tillë nuk vinin në vete e nuk tregonin shenja pendese, duheshin përjashtuar nga mesi i tyre, në mënyrë që **mos të mbinte ndonjë rrënjë të hidhur, e me anë të saj të ndyheshin shumë veta**.

Ky imazh i rrënjës së hidhur është marrë nga Ligji i Përtërirë (29:18 LXX), ku flitet për domosdoshmërinë për të larguar çdo mohues të besës nga mesi i Izraelit, sepse secili prej tyre rrezikon të kthehet në një "rrënjë të hidhur" që shpërndan idhujtarinë dhe infekton të tjerët. Në të njëjtën mënyrë, as në komunitetin e krishterë nuk mund të lejohet një mëkatar i cili nuk shfaq kurrfarë pendese, por përkundrazi, rrezikon të turbullojë e të ndyjë shpirtrat e të tjerëve. Kisha nuk mund të shfaqet tolerante ndaj degradimit moral.

Individët problematikë identifikohen në këtë rast me **Esaun, që shiti të drejtat e parëlindjes së tij për një pjatë gjellë** (Gjen. 25:27 e më tej). Në kohërat kur u shkrua kjo letër, në botëkuptimin judaik Esau konsiderohej si një njeri imoral, që jepej pas kënaqësive. Edhe gratë e tij, të cilat ia vështirësuan shumë jetën prindërve (Gjen. 26:34-35) bënë një jetë imorale, siç ishte e zakonshme për idhujtarët. Në një libër hebraik (*Book of Jubilees*) shkruhet për to se ishin të zhytura në epush dhe kurvëri, ndërsa në "*Targum*" ose parafrazën liturgjikale thuhet se, atë ditë që shiti të drejtat e parëlindjes, Esau kreu pesë mëkate të rënda, ndër të cilat edhe imoraliteti. Prandaj imazhi i tij lidhet fort me mëkatin mishor dhe mungesën e vetëpërmbytjes.

Duke përdorur këtë imazh, autori kërkon t'i paralajmërojë lexuesit t'i qëndrojnë larg një shembulli të tillë, veprimet e të cilit mbartin pasoja të përjetshme. Të gjithë lexuesit e letrës e dinin se **edhe pastaj, kur Esau deshi të trashëgojë bekimin e të atit, Isaakut, u hodh tej; sepse nuk gjeti vend për pendim** a një mënyrë për të ndryshuar mendjen e tij, **ndonëse e kërkoi me lot**.

I njëjti përfundim pret edhe gjithsecilin që braktis Kishën dhe besën e Krishterë. Nëse dikush mbetet në llumin e mëkateve e të imoralitetit deri në fund, do të vijë koha që do t'i kërkohet shpagim. Në atë ditë nuk do të ketë më asnjë mënyrë për të ndryshuar mendjen, dhe nuk do të vlejë më asnjë lot apo thirrje për ndihmë, por do të vijë Gjehena e zjarrit, ku do të ketë qarje dhe kërcëllitje dhëmbësh (Mt. 8:12).

Prandaj autori paralajmëroi të krishterët hebrenj të vinin re shembullin famëkeq të Esaut, e të ndiqnin udhën e drejtë që shpien në shenjtërim.

**18 Sepse nuk jeni afruar në mal që preket me dorë, e që digjet me zjarr, edhe në vranësirë, e në errësirë, e në shtrëngatë,**

**19 e në zë trumbete, e në zë fjalësh, të cilin ata që e dëgjuan u lutën të mos u flitej më fjala atyre;**

**20 sepse nuk mundeshin të duronin urdhrin, që “Edhe shtazë në e prektë malin, do të vritet me gurë ose do goditet me shigjetë”.**

**21 Edhe kaq e frikshme ishte pamja, sa Moisiu tha: Jam fort i frikësuar dhe i tmerruar.**

**22 Por ju u afruat në malin Sion, edhe në qytetin e Perëndisë së gjallë, në Jerusalemin qiellor, edhe në mijëra engjëj,**

**23 në mbledhjen festive e në kishën e të parëlindurve, të cilët janë shkruar në qiejt, edhe tek Perëndia, gjykatësi i të gjithëve, edhe tek shpirtrat e të drejtëve që janë bërë të përsosur,**

**24 edhe te ndërmjetësi i dhiatës së re Jisu, edhe në gjakun e spërkatjes, që flet më mirë se ai i Abelit.**

Autori vendos ta përfundojë predikimin e tij me një krahasim të dhiatës së vjetër me të renë, të simbolizuara nga dy malet: Sinai dhe mali Sion. Mali Sina është simbol i besimit të stëretërve, judaizmit. Dhiata e vjetër ka në thelb shumë kufizime dhe rregulla dhe synon të frymëzojë frikën hyjnore, duke i mbajtur njerëzit nën kontroll. Ata që i përkisnin kësaj dhiate u ishin afruar një mali që preket me dorë, një copë toke në gadishullin arabik, pra një territor tokësor. Kur në atë vend u shfaq Perëndia, populli i Izraelit pa zjarrin, errësirën, vranësirën, shtrëngatën dhe zë trumbete e zë fjalësh (Eks. 19:16 e në vazhdim). Të gjitha elementet e lartpërmendura përbëjnë fenomene të kësaj bote.

Urdhri që u dha nëpërmjet zërit Hyjnor synonte distancimin e njerëzores me hyjnoren, prandaj ata që e dëgjuan u lutën që të mos u flitej më fjala atyre, kaq e tmerrshme ishte fjala e Tij (Eks. 20:18-19).

Për më tepër, kaq kërcënuese dhe distancuese ishte prezenca hyjnore, sa që u tha: **“Edhe shtazë në e prektë malin, do të vritet me gurë ose do goditet me shigjetë”** (Eks. 19:12). Njerëzit nuk mundeshin ta duronin dot këtë gjë, madje edhe Moisiu tha: **“Jam fort i frikësuar dhe i tmerruar”** (Ligj. Përt. 9:19). Në greqisht, fjala “i frikësuar” nuk është thjesht frika e zakonshme *φοβος*, por tmerr e llahtar - *ekfovos*. Shenjtëria e dhiatës së vjetër shërbente për të caktuar hendekun midis Perëndisë dhe njeriut, jo



për të krijuar afërsi. Lexuesit e kësaj letre, nëpërmjet besimit më Krishtin kishin njohur një realitet tjetër, u ishin afruar një mali tjetër, atij të Sionit, në qytetin e Perëndisë së gjallë, Jerusalemin qiellor. Sioni tokësor shërbente si simbol i banesës qiellore të Perëndisë. Të qenit pranë këtij realiteti transhendent u bë i mundur për të krishterët vetëm nëpërmjet Kryepriфтërisë së lartë të Krishtit. Të gjitha fiset e Izraelit do të ngjiten në Jerusalem (Ps. 122:4) , ndërsa dishepujt e Zotit Krisht denjësohen t'i afrohen **Perëndisë së gjallë në qytetin** e Tij hyjnor. Prania e Krishtit bëri që Shenjtëria e Perëndisë të mos ishte më barrierë për të mbajtur të distancuar njeriun. Më parë as nuk mendohej që një person mëkatar të ngrinte sytë drejt lavdisë së Perëndisë (Eks. 33:20).

Në adhurimin e përbashkët kishtar, të Krishterët u afrohen realiteteve qiellore më të larta e më të hyjshme. Ata i bashkohen lavdërimit të **mijëra engjëjve** në mbledhjen festive të përmbibotshme. Termi "mbledhje festive" në greqisht është shkruar *panigiris*, që përdorej edhe në kohërat e lashta për t'iu referuar festave publike që bëheshin për nder të zotëve, dhe konsistonin në bankete të madha, këngë, verë dhe hare. Engjëjt janë vazhdimisht duke i kënduar Perëndisë himne lavdie në Banketin e Përrjetshëm qiellor, në të cilin bashkohet edhe Kisha gjatë Liturgjisë Hyjnore, në Misterin e Eukaristisë.

Ky realitet qiellor përshkruhet më tej si **kisha e të parëlindurve, të cilët janë shkruar në qiejt**. Në këtë kishë bëjnë pjesë të gjithë të Krishterët, si ata që ende përpiqen për shenjtërim këtu mbi dhé, ashtu edhe ata që janë lavdëruar në qiejt. Kisha jonë tokësore është një reflektim i këtij realiteti transhendent, pra ajo qëndron shpirtërisht në vendet qiellore (Efes. 2:6) ku përqendrohet Thërrorja e Pagjakshme.

Kjo mbledhje quhet "kisha e të parëlindurve" sepse të gjithë të krishterët gëzojnë privilegjet që kanë pasur dikur të parëlindurit. Në kohërat e hershme, këta të fundit ishin krerët e familjes dhe atyre u takonte dyfishi i trashëgimisë krahasuar me fëmijët e tjerë. Edhe të krishterët tashmë gëzojnë të njëjtin status, si bij të parëlindur të Atit Qiellor (Kol. 1:15, 18; Rom. 8:17). Si pjesëtarë të kësaj thirrjeje, emrat tanë **janë shkruar në qiejt**, në "regjistrin" e të Shumëlartit. Mbretërit mbanin dikur një regjistër ku shkruanin emrat e të gjithë atyre që donin të nderonin, të cilët i konsideronin miq (krahaso me Esterin 6:1). Një analogji e tillë ekziston edhe me Perëndinë Jahveh (Eks. 32:32; Mal. 3:16), ide e cila u përcoll edhe në Dhiatën e Re (krahaso me Lk. 10:20; Zb. 20:12). Të gjithë dishepujt e Krishtit gëzojnë një privilegj të tillë.

Në adhurimin e përbashkët, të krishterët i afrohen **grykatësit të të gjithave**, Kreut të Mbledhjes Hyjnore, Atë që ka pushtetin mbi të gjitha. Perëndia gëzon bashkë me bijtë e Tij dhe **me shpirtat e të drejtëve** të Dhiatës së Vjetër, **që janë bërë të**

**përsosur.** Teksa këta të fundit rronin mbi dhé, nëpërmjet Ligjit nuk arritën dot në pastërtinë e zemrës. Pasi Krishti e blatoi Veten e Tij si theror të përjetshëm, duke shkatërruar pushtetin e vdekjes, shpirtrat e shenjtëve e Dhiatës së Vjetër mund të pastrohen e të përsosen, duke gjetur kështu prehje të përjetshme pranë Perëndisë.

Kjo sepse Jisui, ndërmjetësi i Dhiatës së Re, qëndron gjithnjë në Qiej si theror i përjetshëm, që ndërmjeton pareshtur tek Ati me anë të **gjakut** të Tij të **spërkatur**. Sipas Ligjit, kryepriiftit i duhej të spërkaste gjakun e një kafshe në altar, që lutja e tij të bëhej e dëgjueshme përpara fronti të Perëndisë. Tashmë marrim guxim përpara Atit nëpërmjet gjakut të Jisuit të derdhur për ne, i cili **flet më mirë sesa gjaku i Abelit**. Ndërsa gjaku i këtij të fundit ushtonte si thirrje për drejtësi përpara pabesisë së Kainit, gjaku i Krishtit ushton si thirrje mëshire për mëkatarët e papënduar.

Nëpërmjet Krishtit, të krishterëve hebrenj iu hap rruga drejt realiteteve hyjnore. Oh, sa më shumë e lavdishme dhe e lartë është kjo Dhiatë e Re! Si mundet dikush të dojë të kthehet përsëri nga hyjnorja në tokësoren, nga Sioni në Sina, nga Krishterimi në Judaizëm?

**25 Shikoni se mos e hidhni poshtë atë që flet; sepse nëse nuk shpëtuan ata që e hodhën poshtë atë që u fliste atyre mbi dhé, shumë më tepër nuk do të shpëtojmë ne, në i kthefshim krahët atij që flet prej qiejve;**

**26 zëri i të cilit atëherë tundi dhenë; po tani premtoi, duke thënë: "Unë edhe një herë do të tund jo vetëm dhenë, po edhe qiellin".**

**27 Edhe kjo fjalë "Edhe një herë" tregon vendndërrimin e atyre që tunden, si të bëra me dorë, që të mbeten ato që nuk tunden.**

Pasi iu ishte dhënë kaq shumë, lexuesit e krishterë duhet të bënin kujdes të **mos e hidhnin poshtë** Zotin që u foli atyre përmes fjalëve të Perëndifrymëzuara të Ungjillit. Nëse nuk shpëtuan ata që ishin nën Ligj, të cilët **e hodhën poshtë atë që u fliste atyre mbi dhé, shumë më tepër nuk do të ketë shpëtim** as për të krishterët (në greqisht, përemri vector *ne* është i theksuar), **në i kthefshin krahët atij që flet prej qiejve**. E pamë se sa e llahtarshme ishte apostazia ndaj Perëndisë, në kohën kur iu shfaq popullit të Tij në malin Sina. Sa më e frikshme do të jetë apostazia ndaj Perëndisë tani që na flet nga fronti i Tij qiellor?

Më poshtë kemi edhe një fragment tjetër të shkëputur nga Shkrimet, në të cilin dëshmohet edhe një herë epërsia e Dhiatës së Re ndaj të Vjetrës, Sionit qiellor ndaj Sinit tokësor.

Tek Hagai 2:5, Perëndia premtoi **duke thënë: "Unë edhe një herë do të tund jo vetëm dhenë, po edhe qiellin"**. Duke cituar këtë pjesë, autori kërkon të theksojë

dallimin që Perëndia bën mes tronditjes së parë, ku zëri i Tij tundi dhenë në Malin Sina, e cila mbetej tronditje tokësore. Mirëpo ajo që do të vijë, tronditja përfundimtare dhe eskatologjike, do të ketë përmasa të pakrahasueshme me paraardhësen. Jo vetëm do të **tundë dhenë, po edhe qiellin**. Kjo **tregon vendndërrimin e atyre që tunden, si të bëra me dorë**, pra një transformim tërësor të të gjithë krijimit, me synimin që **të mbeten ato që nuk tunden**. Gjithçka e përkohshme e krijuar, do t'i lerë vendin të përjetshmes; të tundshmet do të zëvendësohen me të patundshmet, me Mbretërinë e përjetshme të Perëndisë.

Prandaj, profecia në fjalë tregon natyrën transhendente të kësaj besëlidhjeje të re. Mbretëria do të vijë kur qielloret e tokësoret të tronditen e të mos jenë më. Sa e tmerrshme do të ishte braktisja e Perëndisë, që na denjëson të hyjmë në lavdinë e Tij të përjetshme!

**28 Prandaj pasi marrim një mbretëri të patundur, le të mbajmë hirin, me anë të të cilit ne mund ti shërbejmë Perëndisë në mënyrë të pëlqyeshme, me nderim e shpresëtar.**

**29 Sepse "Perëndia ynë është zjarr që të përpin".**

Në këto vargje përmbledhet edhe një herë konkluzioni i të gjitha këshillave të sipërpërmendura të autorit: pasi marrim një mbretëri të patundur, më të lartë se çdo realitet tjetër i kësaj bote, që ndodhej nën Ligj, le të mbajmë hirin e të falënderojmë Perëndinë. Mënyra e vetme për t'iu përgjigjur dhuratës më të madhe që na është dhënë, shpëtimit, është mirënjohja.

Prandaj lexuesit për të cilët u shkrua kjo letër, në vend që të mendonin nëse do të largoheshin apo jo nga Krishterimi për të mbetur në Judaizëm, duhej të njihnin vlerën e paçmuar të dhuratës hyjnore që morën nëpërmjet vetëflijimit të Krishtit. Duke qenë të përkushtuar në besim dhe mirënjohës në zemër, mund t'i shërbenin Perëndisë në mënyrë të pëlqyeshme. Ky do të ishte ofrimi i duhur, jo ai i cjepve e demave, i ofruar jo më në Tempull, me anë të priftërinjve njerëzorë e të vdekshëm, por me anë të Krishtit, në Kishën e Tij.

Adhurimi i duhur është ai që ofrohet **me nderim e shpresëtar**. Nëse lexuesit do ta kuptonin dhe vlerësonin siç duhet veprën shpëtimtare të Krishtit, do të qëndronin përpara Tij të mrekulluar e me nderim të thellë. Perëndia, **zjarri që përpin** (Ligj. Përt. 4:24) që është xheloz dhe i frikshëm për ata që e mohojnë dhe që lavdërohet ndër rreshtat e engjëjve, i fton të bijtë të hyjnë në lavdinë e Tij të përjetshme. Çfarë mund të bënin ata tjetër, përveç se të gëzoheshin në praninë e Tij me drithërima (Ps. 2:11), e t'i jepnin lavdi?

## KONKLuzionet

(13:1-25)

## 5.1. Këshillat e fundit (13:1-19)

Në përfundim të letrës, pas parashtrimit të këshillave dhe mësimëve të tij, autori shton disa këshilla të tjera praktike drejtuar komunitetit të të krishterëve hebrej, të cilëve u adresohet kjo letër.

- 1 **Dashuria vëllazërore le të mbesë.**
- 2 **Mos harroni mikpritjen, sepse me anë të kësaj disa pa e ditur pritën engjëj.**
- 3 **Kujtoni të burgosurit, si të burgosur bashkë me ata; ata që heqin keq, si të jeni edhe vetë në trupin e tyre.**

E para dhe më e rëndësishmja vjen **dashuria vëllazërore** për njëri-tjetrin, elementi dallues i një komuniteti të krishterë (gr. *filadelfia*). Kjo dashuri duhet të **mbesë** gjithnjë e pacenuar.

Dashuria për të cilën flasim nuk është thjesht një emocion i zhveshur nga veprat që dëshmojnë për të. Nëse një dashuri e tillë do të vlonte në zemrat e të krishterëve hebrej, ajo do të rrëzonte çdo barrierë, duke sheshuar kufijtë që e mbanin këtë komunitet të izoluar nga të tjerët.

Prandaj autori i nxit gjithashtu që të **mos harrojnë** detyrimin moral të **mikpritjes** (gr. *filoksena*, që fjalë për fjalë përkthehet "*dashuria për të huajin*"). Në komunitetet e hershme të krishtera, mikpritja e udhëtarëve të huaj përbënte jo vetëm një detyrim të shenjtë, por edhe mënyrë jetese. Asokohe nuk kishte bujtina apo hotele (të vetmet bujtina që ekzistonin ishin famëkeqe dhe vende imoraliteti), prandaj të krishterët mbështeteshin tek njëri-tjetri gjatë kohës që udhëtonin. Fatkeqësisht pati edhe raste të tilla ku u abuzua me mikpritjen, dhe për këtë arsye u bë e domosdoshme të hartoheshin rregulla të caktuara, për të dalluar të udhëtarët e krishterë nga abuzuesit (Këto rregulla parashtrohen në kap. 12 të librit *Didacheia*: "nuk do të qëndrosh më shumë se dy apo tri ditë... në të kundërt përfiton në sajë të emrit të Krishtit.")

Me shumë gjasë, edhe lexuesit e letrës ishin ndeshur me të tilla raste, edhe nga përvojat negative ngurronin të mikprisnin këdo që u trokiste nëpër dyer. Kjo gjë ishte e gabuar. Nuk ishte e drejtë që disa abuzues t'i largonin nga kjo traditë e perëndishme, e cila shtrihej përgjatë gjithë historisë së Krishterimit dhe kishte sjellë shumë bekime. Madje, nëpërmjet mikpritjes **disa pa e ditur pritën engjëj**. Shembulli

që ka sjell ndër mend autori është ai i Abrahamit, i cili priti “tre burrat” në lisat e Mamresë, pa e ditur se kush ishin në të vërtetë (Gjen. 18) ose edhe prindërit e Samsonit, Manoah dhe e shoqja, të cilët priten një engjëll, duke menduar se ishte thjesht një “njeri i Perëndisë” (Gjyq. 13). Në të dy rastet, mikpritja u solli atyre bekimet e Zotit, prandaj edhe të krishterëve hebrenj iu kërkohet ta vazhdonin këtë traditë të virtytshme.

Dashuria e tyre duhet të shtrihej edhe më gjerë, edhe tek të burgosurit, të cilëve mund t’i shërbenin duke i çuar ushqim apo qoftë edhe me një fjalë të ngrohtë inkurajuese. Mirëpo jo vetëm kaq: të krishterët duhet **t’i kujtonin të burgosurit, si të ishin të burgosur bashkë me ata**. Gjendja e vështirë e këtyre të fundit nuk duhej kurrë të ishte larg mendjeve dhe lutjeve të tyre, edhe pasi largoheshin nga vizitat në burgje e i riktheheshin përditshmërisë. Kjo vlente jo vetëm për të burgosurit, por edhe për vëllezërit që hiqnin keq, si p.sh. ata që i rrihnin (krahaso me fjalët e Krishtit tek Mk. 13:9 ku flet për dishepujt që do t’i “rrihnin në sinagogat”). Të krishterët thirrreshin të ndanin të njëjtat vuajtje e mundime, **si të ishin edhe vetë në trupin e tyre**.

**4 Martesa le të jetë e ndershme për të gjithë, edhe shtrati i panjollosur, sepse të përdalët edhe kurorëshkelësit do t’i gjykojë Perëndia.**

**5 Sjelljet tuaja le të jenë pa lakmi argjendi; le t’u jenë mjaft ato që keni tani; sepse ai ka thënë: "Nuk kam për të të lënë, as nuk kam për të hequr dorë prej teje".**

**6 Prandaj ne me guxim le të themi: "Zoti është ndihmësi im, edhe nuk do të kem frikë; ç’do të më bëjë njeriu?".**

Pasojnë të tjera këshilla, kësaj here për martesën, e cila duhet **të jetë e ndershme për të gjithë**. Pra, ekskluziviteti i saj të mbrohet e të ruhet në mënyrë xheloze, dhe **shtrati** martesor të jetë **i panjollosur**. Në mënyrën se si është hartuar në origjinalin, kjo fjali mund të lexohet edhe në mënyrë dëftore: “Martesa është e nderuar nga të gjithë dhe shtrati martesor është i panjollosur”, megjithatë shkon më tepër në mënyrën lidhore, siç është paraqitur, sepse autori nuk synon të pohojë se shtrati është i papërlyer, por të këshillojë lexuesit e tij ta ruajnë të tillë, e të mos e ndyjnë me imoralitete, **sepse të përdalët dhe kurorëshkelësit do t’i gjykojë Perëndia**. Edhe nëse një mëkat i tillë i kobshëm nuk zbulohet nga partneri tjetër, nuk i shpëton dot syve të të Shumëlartit, dhe nuk mbetet e padënuar, qoftë në këtë jetë apo në tjetrën. Pra le të largohet nga mesi i tyre çdo **kurorëshkelës** si Esau (12:16).

Një tjetër këshillë, është që sjelljet të mos ndikohen nga lakmia e argjendit (parasë), përkundrazi, të mësoheshin të jetonin e të mjaftohen me aq sa u ishte dhënë. Kjo nuk

ishite aspak e lehtë, sidomos për ata të cilët ishin persekutimet i kishin varfëruar apo që u kishin grabitur pronat (10:34). Ekzistonte rreziku që, nga shqetësimi i madh, mendja t'u sillej vazhdimisht rreth parasë dhe kështu të harronin besimin në Perëndinë. Por nuk mund të lejonin të ndodhte kështu, pasi vetë Perëndia u kishte siguruar se do të kujdesej për ta. Në Shkrimet thuhet: **"Nuk kam për të të lënë, as nuk kam për të hequr dorë prej teje"** (Ligj. Përt. 31:6). Në kontekstin origjinal, ky premtim iu dha popullit të Izraelit teksa përgatiteshin për betejë, për të marrë Tokën e Premtuar.

Kjo situatë afrohet disi edhe me pozitën shpirtërore të të krishterëve të çdo kohe. Duhet të luftojnë luftën e mirë të besimit, për të hyrë në prehjen e Perëndisë (4:11). Duke pasur siguri në fjalën e Perëndisë, mund të marrin guxim e të thonë bashkë me psalmistin: **"Zoti është ndihmësi im, edhe nuk do të kem frikë; ç'do të më bëjë njeriu?"** (Ps. 118:6). Pavarësisht se njerëzit mund t'u grabisin gjithçka që zotërojnë, Perëndia do të sigurojë për ta.

**7 Kujtoni ata që ju drejtojnë, të cilët ju folën juve fjalën e Perëndisë; besimin e tyre ta keni për shembull, duke pasur përpara syve frytin e sjelljeve të tyre.**

**8 Krishti është po ai dje dhe sot dhe në jetë të jetëve.**

Përballë oqeanit të sfidave shpirtërore që i priste në rrugën e tyre, të krishterët duhet gjithnjë të kujtonin ata që i drejtuan, të parët të cilët u folën fjalën e Perëndisë, Ungjillin e përjetshëm. Këto fjalë i referohen brezit të parë të etërve e të klerikëve. Kur njohën dhe besuan në Krishtin, ata ishin në moshë të madhe dhe shumica prej tyre kishte ndërruar jetë në kohën që u shkrua kjo letër. Lexuesit mundeshin të bënin një analizë të thellë të të gjithë jetës së tyre, duke e vëzhguar atë imtësisht (në greqisht përdoret fjala *anatheoreo*, jo thjesht *theoreo* - "vëzhgoj", por me kuptim më përforcues "vëzhgoj në detaj"). Dallohej qartë se fryti i sjelljeve të tyre ishte një dashuria e pastër e një jetë të tërë të ofruar për shërbim, që rezultonte më pas edhe në një vdekje të paqtë e të lavdishme. Besimi i tyre duhej pasur për shembull dhe imituar, me bindjen e plotë se, nëse ecnin në të njëjtën rrugë, edhe ata do të shpërbleheshin po njësoj. Sepse Krishti, për të Cilin dëshmuar të gjithë këta mësues, është po ai dje dhe sot dhe në jetë të jetëve. Siç Ai nuk ndryshon kurrë, po ashtu nuk ndryshon as shpërblimi që jep për këdo që i përkushtohet denjësisht.

9 Mos u rrëmbeni prej mësimesh të ndryshme e të huaja; sepse është mirë të forcohet zemra juaj me hir, jo me të ngrëna, ndër të cilat ata që ecën nuk kanë dobi.

10 Kemi një therore, prej së cilës ata që shërbejnë në tendë s'kanë pushtet të hanë.

11 Sepse trupat e atyre kafshëve, gjaku i të cilave sillet brenda në shenjtërore prej kryepriftit për mëkat, digjen jashtë vendlindjes.

12 Prandaj edhe Jisui, që të shenjtërojnë popullin me anë të gjakut të tij, pësoi jashtë portës.

13 Le të dalim pra tek ai jashtë vendlindjes, duke mbajtur poshtërimin e tij.

14 Sepse nuk kemi këtu qytet që mbetet përherë, po kërkojmë atë që ka për të ardhur.

Pasi shkruan për Ungjillin e përjetshëm, të cilin mësuesit e besimit e dëshmuuan dhe me fjalët dhe me jetën e tyre, autori u drejtohet lexuesve të tij me nota paralajmëruese, duke i thënë të mos rrëmben prej mësimesh të ndryshme e të huaja. Për çfarë mësimesh bëhej fjalë?

Është e vështirë të themi një përgjigje të sigurt. Duke iu referuar kontekstit, autori hedh poshtë mendimin se zemra e besimtarit duhet të forcohet me të ngrëna. Sipas një praktike të dikurshme judaike, njerëzit mblidheshin dhe hanin së bashku (Këtu mund të përmendim vaktin e përbashkët të Pashkës dhe të Shabatit). Pra, ushqimet në fjalë përbënin një simbol të festës fetare me të cilën lidheshin.

Jam i mendimit se në kohën kur u shkrua letra, që përkon me vitet e fundit para shkatërrimit të Tempullit, rabinët kishin filluar të përhapnin mësimet të tilla, sipas të cilave këto vakte përbënin element kryesor për shpëtimin. Në atmosferën e vitit 70 ps. K., para katastrofës së shkatërrimit të Tempullit, i gjithë populli ishte përpirë nga ndjenjat nacionaliste, sipas të cilave të qenit jude ishte gjëja më e rëndësishme. Shumica e njerëzve besonin se popullit të Izraelit i ishte caktuar një vend në Mbretërinë që do të vinte, dhe përderisa pritej ardhja e Mesisë si udhëheqës luftarak, për të çliruar vendin nga pushtuesit romakë, prejardhja e tyre judaike do t'u siguronte "biletën" e shpëtimit.

Ngre hipotezën se këto vakte të përbashkëta mund të organizoheshin pikërisht për këtë qëllim. Mësimet ishin të ndryshme, ndoshta sepse i paraqisnin në formë të ndryshme (një rabi mësonte një variant të caktuar, p.sh. se vakti i Pashkës mjaftonte, ndërsa një tjetër këmbëngulte se nevojitej pjesëmarrja në të gjitha vaktet). Sido qofshin këto mësimet, autori i cilëson si **të huaja** në kuptimin që ishin jo vetëm të padëguara më parë, por edhe shumë larg themeleve të besimit.

**15 Me anë të atij pra le të sjellim gjithnjë tek Perëndia theror lavdie, domethënë fryt buzësh që rrëfejnë emrin e tij.**

**16 Edhe mos harroni të bëni mirë e të ndani gjithçka me të tjerët, sepse therore të tilla pëlqen Perëndia.**

Të Krishterët thirren të jenë me Krishtin në çdo moment, jo vetëm në lavdinë e Tij por edhe në poshtërimet dhe mundimet. Konkretisht, të krishterët hebrenj duhej patjetër të vazhdonin të mblidheshin si komunitet në mbledhjet adhuruese, për kremtimin e Falënderimit Hyjnor (10:25) për të përjetuar se i përkisnin Krishtit dhe njëri-tjetrit. **Me anë të atij**, duhej vazhdimisht, pra çdo javë të sillnin **theror lavdie tek Perëndia**. Ky është i vetmi theror i denjë për t'i sjellë lavdi, jo gjaku i dhenve e i cjepeve, por **fryt buzësh që rrëfejnë emrin e tij**. Gjatë këtij Misteri, Emri i Zotit madhërohet dhe lartësohet. Ashtu siç profetizoi edhe psalmisti: "Unë do ta kremtoj emrin e Perëndisë me këngë, e do ta madhësoj me lavde. Dhe kjo do t'i pëlqejë Zotit më tepër se një ka a një dem me brirë dhe thundra" (Ps. 69:30:31). Gjatë Falënderimit Hyjnor i ofrojmë Perëndisë himne lavdie dhe përkujtojmë dhe jetojmë pësimet e Kryqit, që përbën ofrimin më të lartë e më të denjë.

Pjesëmarrja në mbledhjet adhuruese shkon gjithmonë bashkë me veprat, prandaj autori i nxit të krishterët **të bëjnë mirë e të ndajnë gjithçka me të tjerët**. Dhënia e lëmoshës, vizitat tek të sëmurët, ndarja e ushqimit me më të varfrit etj. Përbëjnë atë që quajmë "Liturgjia pas Liturgjisë", pjesën praktike të adhurimit, që zë fill pas pjesëmarrjes në mbledhjet dhe është rezultat i saj. Adhurimi i vërtetë gjen shprehje në përditshmërinë e gjithsecilit, nëse kjo zbukurohet me vepra të mira dhe zemërbutësi. **Të tilla therore pëlqen Perëndia**, prandaj të krishterëve të asaj kohe nuk u nevojitej më të shkonin në Tempull për të ofruar therore të gjakshme.

**17 Bindjuni të parëve tuaj, edhe dëgjojini; sepse ata rrinë zgjuar për shpirtrat tuaj, sepse ata do të japin llogari; që ta bëjnë këtë me gëzim, e jo duke psherëtirë; sepse kjo nuk ju bën dobi juve.**

Në vazhdim, autori i nxit lexuesit të bëjnë bindje ndaj të parëve të tyre e t'i dëgjojnë, pasi kjo përbente një antidot të fortë ndaj apostazisë. Bindja ndaj etërve dhe mësuesve të tyre do t'i bashkonte përsëri të gjithë si komunitet i krishterë, nën udhëheqjen e perëndishme të klerikëve. Gjatë persekutimeve dhe periudhave stresuese, tundimi nuk qëndron vetëm në rënien dhe braktisjen e besimit, por edhe në grindjet me njëri-tjetrin (shiko tek 12:14 ku të krishterëve u këshillohet të kërkojnë paqe me të gjithë). Duket se kjo situatë e pakëndshme kishte nisur edhe në mesin e



tyre, ku të krishterët kishin mosmarrëveshje me udhëheqësit e tyre, gjë që nuk duhej ndaluar sa më shpejt.

Udhëheqësit shpirtërorë janë si “roje” të Perëndisë (krahaso me Ezek. 3:17), që Ai vetë i ka caktuar **të rrinë zgjuar për shpirtrat** e besimtarëve (gr. *agripneo* - krahaso me përdorimin tek Lk.21:36 dhe tek 2 Kor. 6:5, ku është përdorur si emër: *agripnia*). Ata janë thirrur të vigjilojnë pa pushim për shpirtrat e grigjës së tyre, duke këshilluar, inkurajuar, qortuar dhe lutur për shpëtimin e të gjithëve. Kjo është detyra e tyre, për të cilën një ditë **do të japin llogari**. Nëse ndodh që një shpirt të humbasë falë mosvigjilencës së tyre, Perëndia do t’i bëjë ata përgjegjës.

Ata, të cilët marrin përsipër këtë detyrë të shenjtë, duhet ta bëjnë atë me gëzim, e jo duke psherëtirë. Nëse lexuesit vazhdonin mosmarrëveshjet me klerikët, duke i shtyrë ata në hidhërim dhe dekurajim, **nuk do t’iu bënte aspak dobi**. Vetëm duke qenë të gjithë të bashkuar dhe të unifikuar si komunitet, mund të përfitonin shpirtërisht.

**18 Lutuni për ne, sepse jemi të bindur që kemi ndërgjegje të mirë, duke dashur të sillemi mirë në gjithçka.**

**19 Por më tepër ju lutem ta bëni këtë, që të kthehem tek ju më shpejt.**

Tashmë i afrohemi fundit të letrës, ku autori bën kërkesë për lutje (përdoret shumësi “ne” stilistikisht) pasi ishte i bindur se kishte një **ndërgjegje të mirë** dhe se dëshironte të sillet mirë në gjithçka. Pra ishte njeri dinjitoz, dhe lutjet e besimtarëve për të nuk do të shkonin më kot, (si të ishte p.sh. ndonjë hipokrit). Megjithatë, arsyeja kryesore që ai kërkonte lutje, ishte që të mund **të kthehej sa më shpejt** tek ata. Siç thamë edhe në fillim, ka shumë gjasë që autori ta ketë shkruar letrën ndërsa ndodhej në Romë. Kishte ankth dhe shqetësim për grigjën e tij dhe lutej që të shkonte sa **më shpejt** në Palestinë.

## **5.2. Bekimet përmyllëse (13:20-21)**

**20 Dhe Perëndia i paqes, i cili ngriti prej së vdekurish bariun e madh të dhenve me anë të gjakut të dhiatës së përjetshme, Zotin tonë Jisu Krisht,**

**21 ju bëftë të përsosur në çdo punë të mirë, që të bëni vullnetin e tij, duke punuar ndër ju atë që është e pëlqyeshme përpara tij, me anë të Jisu Krishtit; të cilit i qoftë lavdia në jetë të jetëve. Amin.**

Në këtë fragment, autori i bekon përzemërsisht lexuesit. Fakti që i referohet Perëndisë si **“Perëndia i paqes”** ndoshta lidhet dhe me mosmarrëveshjet që kishin ata ndërmjet njëri-tjetrit. Ky Zot, Zoti i Izraelit dhe i etërve të tyre është po Ai i **cili ngriti prej së vdekurish bariun e madh të dhenve me anë të gjakut të dhiatës së përjetshme, Zotin Jisu Krisht**. Vërejmë se Jisui krahasohet me një bari i cili drejton, mbron dhe ushqen grigjën e vet. Triumfi i ngjalljes së Tij të lavdishme u arrit vetëm nëpërmjet gjakut që derdhi, pasi u refuzua nga populli i Izraelit. Fakti që rruga e triumfit të Krishtit kaloi përmes kalvarit të vuajtjeve, dëshmon se e njëjta udhë i priste edhe dishepujt e nxënësit e Tij.

Në kohën që u shkrua kjo letër, gjendja e të krishterëve ishte e plogësht, dhe kishin filluar ta lëshonin veten. Por Perëndia nuk do t'i linte t'u mungonte asgjë, duke i bërë **të përsosur në çdo punë të mirë** dhe duke i plotësuar me dhurata shpirtërore, që të mund të vazhdonin të ecnin sipas vullnetit të Tij. Shërimi i shpirtave të tyre i atribuohet vetëm fuqisë së Perëndisë. Ai do të punonte ndër ta **atë që është e pëlqyeshme përpara Tij**, duke i ndihmuar të qëndronin fort në besim e t'i shërbenin me shenjtëri, të gjitha këto **me anë të Jisu Krishtit**. Atij **i qoftë lavdia në jetë të jetëve**.

(Nga ana gramatike, është e mundur që fjalia e fundit t'i referohet Krishtit, pra që autori t'ia japë Atij lavdinë. Megjithatë, sipas traditës hebraike, në mbyllje të urimeve shtohet gjithmonë një dhoksologji (lavdërim) ndaj Perëndisë Atë, dhe besoj se autori ka bërë të njëjtën gjë. Pra Ati lavdërohet nëpërmjet Birit - krahaso edhe me vargun 15.)

### 5.3. Përsëndetjet e fundit (13:22-25)

**22 Edhe ju lutem juve, o vëllezër, duroni fjalën e këshillës; sepse me pak fjalë ju shkrova juve.**

**23 E dini se vëllai Timothe u lëshua nga burgu, me të cilin, në ardhhtë më shpejt, do t'ju shoh juve.**

**24 Përsëndetni gjithë të parët tuaj dhe të gjithë shenjtorët. Ju përsëndesin ata që janë nga Italia.**

**25 Hiri qoftë me ju të gjithë. Amin.**

Kemi mbërritur tashmë në fragmentin përmbyllës. Këtu autori u **lutet** vëllezërve më Krishtin të **durojnë fjalën e këshillës**, që do të thotë të përpiqen ta kuptojnë atë në thelb. Për më tepër, ai **shkroi vetëm me pak fjalë**, prandaj nuk është e vështirë të analizohen e të kuptohen ato që shkruan.

Gjithashtu u bën me dije lexuesve se **vëllai Timothe** (shoqërues i apostull Pavlit) **ishte lëshuar nga burgu**. Nëse autori do të **mbërrinte shpejt në Palestinë**, do t'i takonte lexuesit. Ai e kishte vendosur tashmë që do të shkonte, qoftë me Timotheun apo i vetëm. Këtu na paraqitet një shembull i qartë i lidhjeve që krijonin të krishterët, ku lajmëronin njëri-tjetrin për sa ndodhte. Është tregues shumë i mirë i rëndësisë së lidhjeve që krijohen mes vëllazërive të krishtera. Pavarësisht distancës së madhe, edhe në Palestinë preokupoheshin për Timotheun dhe nuk qëndronin aspak indiferentë, sepse të gjithë jemi një në Krishtin.

Së fundmi, autori u lë porosi të përshëndetnin **gjithë të parët** e tyre dhe të gjithë **shenjtorët** (besimtarët e komunitetit të krishterë). Edhe ky varg dëshmon për preokupimin e autorit që ata të ishin të unifikuar. Më tej u përcjell edhe përshëndetjet e besimtarëve **që janë nga Italia**, dhe e mbyll me një urim, duke u lutur që **Hiri i Perëndisë** të ishte **bashkë me ta**.